

Jashtë, në oborrin e King's Grant Inn priste një burrë gjatosh, elegant, me flokë të bardhë, i veshur me një bluzë polo verore. Ishte e kundërta e figurës zyrtare, hijerëndë, të kontraktuar, pozante dhe distancëmbajtëse të shkrimtarëve që kisha njohur unë deri më atë kohë. Kishte sytë më të qeshur e më të butë ...

RUDOLF MARKU NJË TAKIM I PAHARRUAR ME SHKRIKTARIN JOHN UPDIKE

(fq. 2)



SHËNIME PËR LIBRAT

QË SONETI I URAN KOSTRECIT MOS TË MBETET NË HIJE SI VETË JETA E TIJ

Nga Emrije Krosi

(fq. 12)

...nuk mjafton vetëm keqardhja apo ndonjë falje për braktisjen e poetit, por kritika nuk duhet të jetë armiqësore, klasore, përjashtuese, klientiste, por profesioniste duke u marrë më shumë me sonetin.

NJË VËSHTRIM MBI ROMANIN "DARKA E GABUAR" TË KADARESE

Nga Ervin Nezha

(fq. 14)

PROZAT POETIKE TË ERNEST KOLIQIT

Nga Fatlum Mehulli

(fq. 14)

PRAPA MURIT TË DHUNËS – "BARI QË RRIKET MBI VARRE"

Nga Ballsor Hoxha

(fq. 15)

Visar Zhiti në dy kohë BALSAMI SHËRUES I PLAGËVE

(fq. 6)

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

Visari i ruhej gardianëve, unë vazhdoja të ngecja në pritë e redaktorëve dhe recenzentëve, ku dorëshkrimet mbylleshin në sirtarë. Ishte po ai shteg, që e kishte daljen në qeli. Jeta e solli që...



Albanologu i njohur zviceran

BASIL SCHADER:

MË VJEN KEQ NGANJËHERË, PËR
NJOHURITË PAK TË KUFIZUARA
TË GJUHËS STANDARDE SHOPE
TË BREZIT TË DYTË A TË TRETË TË
MËRGIMIT SHOIPTAR

(fq. 18)

Intervistë dhënë gazetares Mimoza Hasani Pllana

"MESHARI" – VEPËR E HARTUAR NGA GJON BUZUKU

Nga Anton Nikë Berisha

(fq. 16)

Meshari është "i pari libër i madh i shqipes" dhe "më i pari monument i literaturës shqiptare" dhe se "jo vetëm nga pikëpamja e kohës, por përgjithësisht dhe e nivelit të kryet e vendit në literaturën shqiptare të vjetër; e në fushën e prozës poetike edhe për më vonë është vështirë t'i vihet ndonjë tjetër përkrah".

Të gjesh të njerëzishmen dhe përulësinë tek

ALBERTO GIACOMETTI

Gunnhild Øyehaug
mbi një nga skulptorët
më të mëdhenj të
shekullit XX

(fq. 22)



BIBLIOTEKË

Anton Pappleka

(fq. 8)

Korrigjimet e qiellit

Artur Spanjoli

(fq. 9)

Kthimi i përjetshëm

Mehmet Elezi

(fq. 19)

Një biletë falas për Barcelonë

Giorgio Caproni

(fq. 20)

Je kujtim veret

Mark Twain

(fq. 23)

Tregimi i djalit të prapë

Botohet ne gjuhën maqedonase
romani "Valsi i lumturisë"
i Ylljet Aliçkajt

(fq. 11)

Besnik Mustafaj vlerësohet në
Itali me çmimin e lartë
"Virtyti dhe Dija"

(fq. 13)

MBISHKRIMI NË MUR

Nga Pol Milo

(fq. 10)

RUDOLF MARKU

NJË TAKIM I PAHARRUAR ME SHKRIMTARIN JOHN UPDIKE



Në Korrikun e vitit 1994 ndodhesha i ftuar në një program kulture në Shtetet e Bashkuara. Qendrimi im për afër dy muajsh nënkuptonte një udhëtim intensiv nga Bregu Lindor (Washington DC, North and South Caroline, New York City) në Bregun Perëndimor të Kontinentit amerikan (California).

Pas dy javësh të mbërritjes time në SHBA, jam në Massachusetts. I ftuar nga Harvard University, kisha kërkuar të shoh një kopje të gazetes studentore Crimson, gazetë ku Tomas Stern Eliot, student, në qershorin e vitit 1915, pat botuar së pari poemën "Këngë dashurie për J. Alfred Prufrock,,. Një gazetë e zakonshme dhe tepër modest studentësh që vazhdon të botohet dhe sot e keaj dite me katër faqe, e që u kish prezantuar për herë të parë lexuesve veprën poetike të poetit më të madh të shekulli të njëzet.. (Me kish shkuar ndërmend shkarazi se asnjë shkrimtar shqiptar nuk do ta kishte ulur veten deri aty sa të kishte pranuar që të botonte një poemë të veten në një gazetë studentësh me katër faqe...)

Në Washington DC, në Library of Congress,

para se të mbërrija në Boston, kisha ende të freskët kujtimin me Maya Angelou, poeteshen e njohur amerikane, por jo domosdoshmërisht një poete që më pëlqente (më vonë e kam parë se ka qënë poeteshë e zgjedhur nga Obama në ceremoninë e zgjedhjes si President. Jo gjithmonë shijet poetike përputhen me ato të Presidentëve!) dhe me poeten tjetër të njohur, laureate, Rita Dove

...Një burrë i vrullshëm pat dalë nga e njëjta dhomë ku hyja. U patëm përshendetur me kokë shkarazi, duke shmangur përplasjen. Maya Angelou më tha:

- E njohe kush ishte?

Poeti rus Joseph Brodski. Tipi më i veshtirë që kam njohur der' më tash. Ngulte këmbë që të pinte cigare në dhomë. Më tha se ndalimi i cigares është një violencë kundër të drejtave të poetëve. Pastaj hapi vetë dritaren dhe piu pesë cigare rresht, gjysmë i përkulur jashtë dritares. Mund të binte poshte nga çasti në çast. Dhe nga ku? Nga godina e Senatit Amerikan! O zot, këta poetët rusë!

Ne Boston më lajmëruan se do do takohesha me shkrimtarin John Updike. Nga Updike kisha

lexuar romanin "Lepur, vrapo" (Rabbit,run,), romanin e tij të parë "The poorhouse Fair", si dhe një vëllim me tregime të shkurta. Një tregim të tij e kisha përkthyer dhe botuar në gazetën Drita, në vitin 1988, me një paraqitje te autorit. Ishte botimi i parë i Updike në shqip. Por jo përmendja e parë e emërit të tij në shtypin shqiptar. Më kujtohej se si në vitet '70 emri i tij përmendej, po në faqet e gazetës "Drita", si emri i një shkrimtari dekadent reaksionar dhe libri i tij "Lepur, vrapo", si shembull i degradimit të letërsisë në perëndim. Emrin e Updike--ut artikushkruesit vigjilentë, si për ta sharë më tepër, e si për të treguar shkallën e lartë të rrezikshmerisë së tij, e rreshtonin me atë të Kafkes e të Prustit!

Po ashtu, në leksionet për letërsinë borgjeze dhe revizioniste të shekullit të njëzet, lektorë të ndryshëm na kishin spjeguar rrezikshmërinë e letërsisë absurde, dhe romanin "Lepur, vrapo" një profesor e spjegonte si historinë e një lepuri që nuk kish arritur të bëhej kurrë njeri!

Organizuesit e udhëtimit tim në SHBA i kishin shkruar Updike--ut se unë i kam përkthyer një tregim në shtypin shqiptar, dhe po ashtu i kishin dhënë disa nga poezitë e mia të përkthyer në anglisht. Kishte shfaqur përnjëherë dëshirën dhe kureshtjen që të më takonte.

Ideja që do takohesha me John Updike, të cilin një shkrimtar anglez e ka quajtur Dostojevski i letërsisë amerikane, më jepte një ndjenjë kureshtjeje të përzier me pasigurinë se çfarë do të flisja me të. Pasigurinë ma shtonte, krahas të tjerash, dhe fakti se diku, në një tregim të tij, ai kishte një referencë jo dhe aq simpatike për shqiptarët! Por, nga ana tjetër, ai kishte botuar një shkrim të shkëlqyer për romanin 'Kronikë në Gurë, të Kadaresë!

Takimi do bëhej në King's Grant Inn, në periferi të Bostonit, fare pranë Salem. Mendova të merrja me vete një liber të tij. Nuk ishte gjë e lehtë për të gjetur një libër të Updike--ut në libraritë e Bostonit. Librat e tij ishin më të shiturit. Një miku im amerikan më dha nga biblioteka personale romanin e parë të Updike--ut. Nxitova të mbërrijë në kohë. Arrita pesë minuta me vonesë. Jashtë, në oborrin e King's Grant Inn priste një burrë gjatosh, elegant, me flokë të bardha, i veshur me një bluzë polo verore. Ishte e kundërta e figurës zyrtare, hijerëndë, të kontraktuar, pozante dhe distancëmbajtëse të shkrimtarëve që kisha




njohur unë deri me atë kohë. Kishte sytë më të qeshur e më të butë që kam arritur të shoh tek një qenie njerëzore. I kerkova të falur për vonesën. I tregova se sa e vështirë kishte qene për të gjetur një libër të tij në bookshop-et e Bostonit. Ai më tha se isha munduar më kot, ngase ai vetë kishte sjellë katër libra te tij për t'm'i dhënë me vete.

Filloi te pyeste për Shqipërinë. Kishte lexuar romanin e Kadaresë "Kronikë ne gur," dhe e kishte admiruar talentin e shkrimtarit shqiptar. Në revistën prestigjioze "New Yorker," ku ka botuar dhe shkrimet e mrekullueshme estetike, ka shkruar një recension tepër vlerësues për të. Përmendi vetë fillimin e romanit, atë të përshkrimit surreal të pijanecëve që gdhihen në ditën e nesërme mbi çatitë e pjerrëta të shtepive të qytetit. Dhe qeshi. Qeshte i lumturuar nga përmendja e romanit të Kadaresë (në një kohë që shumica e kolegëve shqiptar qenë ngrysur përzishëm nga botimi i "Kronikës në Gur,."). Tha se ai vetë ishte çuditur se si kjo veper qe shkruar nga një shkrimtar shqiptar. Tha se kishte qënë ndër shkrimtarët e parë amerikanë që kishte vizituar Bashkimin Sovjetik. Gjatë kohës së Hrushovit. Kudo i thonin të njëjtën gjë, të njëjtat fjali, i bënin të njëjtat pyetje se Prozatori më i madh i letërsisë amerikane është Jack London. Se Poeti më i madh është Karl Sanburg. Se Thomas S. Eliot është poet katolik, dhe prandaj, reaksionar... Më vonë kishte vizituar Poloninë, Çekinë, Gjermaninë Lindore, Bullgarinë. Të njëjtat biseda, madje e njëjta strukturë sintaksore, të njëjta idoma të shprehjes. I njëjti leksik, e njëjta buzëqeshje. E njëjta lëvizje e krahëve. Nuk kish

arritur kurrë t'i kuptonte shkrimtarët e vendeve komuniste. Nuk kish arritur madje as që t'i kuptone sadopak veprat e tyre. Ishte trishtuar nga uniformiteti njerëzor. Nëse shkrimtarët janë qenie të uniformizuara, ç'mund të presësh nga të tjerët? Më tha se nga letërsia amerikane autori që vlerësonte më shumë nuk ishte Jack London, por Nathaniel Hawthorne. Për fat të mirë, nga Hawthorne kisha lexuar "The House of seven gables," dhe një përmbledhje tregimesh. Iu bë qejfi që e admiroja dhe unë Hawthorne. Natyrisht, duke ia fshehur me kujdes pëlqimin tim të hershëm për Jack London.

Më pyeti se cilin nga tregimet e tij kisha përkthyer. Ah, këtë paske përkthyer? Është tregimi im më i njohur nga studentët amerikanë, ngase është i përfshirë në të gjithë Antologjitë shkollore.

Tregimet e Updike-it i kam admiruar që herët. Ai vetë ka botuar tregime që në moshën 22 vjeçare, dhe që në atë moshë është pranuar si shkrimtar jashtëzakonisht serioz. Ajo që binte në sy tek Updike ishte natyrshmëria e jashtëzakonshme me të cilin shkruan. Dhe ajo natyrshmëri ndjehej kudo, në të gjithë qënien e tij. Updike nuk është shkrimtar i temave të mëdha. As dhe i temave politike. Kryetema e tij është marrëdhënia mes burrit dhe gruas, seksi, divorci. Karakteret e tij janë njerëzit e zakonshëm të provincës amerikane. Stili i të shkruarit është realist. Por është mjeshtër i përshkrimit të situatave, i analizës së gjëndjes njerëzore, i ironisë së hollë, dhe mbi të gjitha, i dashurisë për njeriun edhe kur tallet me të...Kjo është arsyeja që lexuesit amerikan e ndjen veten të identifikuar me karakteret e veprave të Updike.



E pyeta se cilët nga librat e veta vlerësonte ai vetë më shumë. *Centaur*, *Witches of Eastwick* dhe *Gertrude and Claudius*. Ky i fundit është ri-shkrimi i marrëdhënieve të Gertrutës, nënës së Hamletit, me burrin e saj të dytë, Claudin. Me pyeti nëse e kisha parë realizimin në film të *Witches of Eastwick* me Jack Nickolson...Nuk i pelqente që shumë lexues e përmendnin si autorin e "Rabbit, run,..." Tha se sa e vështirë është për një shkrimtar kur ndesh në lexues që e përmendin si autorin e veprave të para të botuara...


Disa vite me vonë e kam kujtuar këtë pjesë të bisedës tonë tek lexoja njërin nga tregimet e tij në përmbledhjen e tregimeve "Your lover just called," ku ai tregon një shkrimtar të bezdisur nga që e përmendin si autorin e veprës së tij të parë të botuar...

Tek ndaheshim, bëmë një fotografi bashkë. Më dha katër librat që kishte marrë me vete nga shtëpia e vet para se te vinte. "Centaur", "Gertrude and Claudius", "Witches of Eastwick" dhe "Beck". Të gjitha me dedikaset e veta.

Një muaj më vonë, në Tiranë, marr dhe letrën e parë të tij. Më shkruante me kortezinë më të madhe se sa shumë e vlerësonte kohën që qendruam bashkë dhe bisedën tonë. Me pyet për udhëtimin tim për në Shqipëri...

Në shtëpine time, në Tiranë, ruaj katër letra të shkruar nga John Updike, të cilat ai m'i ka dërguar në vite të ndryshme. Letra miqësore, të shkruara me natyrshmëri dhe me një puls të thellësisht njerëzor.

Shkrimtari anglez Justin Cartwright, mik i Updike-it, shkruan me rastin e vdekjes së tij se ai mbetet "shkrimtari më i madh amerikan i pjesës së dytë të shekullit të njëzet.... Dhe se cilësia e tij më e rrallë mbetet integriteti absolut. Kurrë nuk ka shkruar në mënyrë pretencioze dhe asnjëherë, tek shkruante, nuk qellonte me grushte..., Ashtu si plot të tjerë, mendoj se Bota letrare ka dështuar ngase John Updike nuk e mori atë që duhej të kishte marrë. Pavarësisht se ai fitoi dy herë çmimin Pulitzer dhe dy herë National Book Awards, atij ju mohua çmimi Nobel. Ai vetë shkruan për një shkrimtar medioekër e të mërzitshëm, Henry Bech, tek merr çmimin Nobel dhe tek mban një fjalim në Stockholm me foshnjen e vet mbi shpatulla...Është ky një pazash i shkruar në njërin ndër librat e tij që John Updike ma pat dhënë në Boston me dedikasin e shkruar me dorën e vet.



Visar Zhiti në dy kohë

BALSAMI SHËRUES I PLAGËVE

Fatbardh Amursi (Rustemi)



Për të njohur realitetin socialist, Lidhja e Shkrimtarëve, na jepte leje krijuese. Isha caktuan në minierën e Gurit të Kuq, ku duhej të frymëzohesha nga heroizmi i minatorëve. Në minierën e *Spaçit*, Visari, vuannte dënimin me 13 vite burg. Shtoni me mend: galeri personazhesh, galeri arti, në origjinë të të cilës: një shpellë, ku mendohet se u mbyllën Muji dhe Halili. (U mbyllën heronjtë, por jo rapsodët.) Në labirintet e minierës takova një minator, i cili me martinel, Martin duhej: hapte vrima për kallupët e dinamitit brenda një guve. (Shpiksi i dinamitit është Nobeli, emrin e të cilit mban dhe “*çmimi Nobel*”. Kadare kandidat i kahershëm.) Minatori po më shpjegonte shtresat e dheut, ndërsa mua më dukej, sikur po merrja mësim nga orakujt e antikitetit: “*Kjo shtresa këtu, më tha, është e sigurt, si njeriu i mirë, që s’ të vjen as një e keqe. Kjo këtu, para se të shembet, hedh ndonjë guriçkë, si paralajmërim, sikurse njeriu i lëkundur, ndaj të cilit duhet të bësh kujdes. Ndërsa kjo shtresa këtu të zë befasisht, si i ligu, që të ha pas shpine.*” Rrëshqiti pak gishtin mbi të dhe, përnjëhertësh ranë të shkërmoqurat. Doja të shkruaja për Martinin me martinel, tërhequr dhe nga filozofia e shpjegimit të karaktereve nga horoskopi i shtresave të dheut, por, ditë më pas, mësova se e kishte zënë dheu, shtresa pa paralajmërim. Të shkruaje për aksidentet në kantieret e punës, ishte njësoj si të bëje shaka me prangat. Si minatori dhe Visari e pësuan nga “dheu i pabesë”, kur atdheu mburrej se qe prej hekur-betoni dhe se e udhëhiqnin burra me tabanë?! Nuk di pse mu kujtua poezia e Faslli Halitit “baltë e kurdisur”? Isha midis heroit të vrarë dhe poetit të dënuar. Qëllimi i lejes krijuese: të njihja jetën, por, të vrarët dhe të burgosurit duheshin shmangur, nëse s’doje që të merrnin me vete. “Sa gjë e vështirë qënka, të fillosh ta njohësh qiellin, kur të rrëmbejnë të drejtën që ta soditësh atë.”-shprehet Shpirtçiltri, personazh i Volterit. Predikoheshin “horizontet e hapura”, ka dhe një film me këtë titull, duke na e hequr të drejtën të kapërcinim kufirin, edhe pse në balada thuhej: “shtatë male kaptuar”. Aty ku premtohen horizontet, të parët që e pësojnë janë ëndërrimtarët. “Ëndërruam lirinë dhe u bëmë vetë ëndërr”-do shkruajë poeti Zhiti. Duke shfrytëzuar të çarat e ferrit, ku zbulon thesaret e frikës, në një funeral të pafund, nga valixhja e shqyer hedh një kafkë në këmbët tona, jo për të na trëmbur, por për të na kujtuar krimet e komunizmit, falë kujtesës së ajrit, ku mbillen vetëtimat, Visari krijon BunkArtin e tij, pa artifica. Nën shembullin e rrathëve të Dantes, hakmerret veçse me libra, që shumë syresh i përmbledh në një titull të vetëm: “Burgologjia”, apo “Kartela të realizmit të dënuar”, duke e “burgosur” për së dyti veten, si e si të mbajë gjallë frymën e protestës. Eskili, në asnjë tragjedi tjetër, nuk do e identifikon veten, veçse tek “Prometeu i lidhur”, si pararendës i Krishtit.

Për hapjen e një tuneli, punohet nga të dyja krahët. Nuk di a është e përshtatshme kjo figurë, nëse letërsinë e realizmit socialist në dukje dhe letërsinë e burgut në fakt, i shohim si plotësime të njëra-tjetrës, apo duhen vënë përballë për të mbajtur gjallë një zjarr, ku në vend të shtrigave, i vjen përsëri radha Xhordano Brunos? Një kohe të padrejtë nuk mund t’i kundërvihesh duke abuzuar me lirinë. Revanshi është një ndërrim vendesh midis djallit dhe shejtanit. Si mund të bënte hajër i zoti në një kohë që, po mohohej dhe vetë zoti?! “Njerëzit gjejnë mënyra të reja për t’i shtypur të tjerët, mënyra të reja për t’i zhbërë arritjet më të mira të të tjerëve.”-na sensibilizon Salman Ruzhdie, duke na mprehur shqisat. Në minierë ishim të dy, shokë fëmijërie e rinie, nisur së toku udhën e poezisë, me fate tashmë të ndara: unë me leje krijuese dhe Visari, i dënuar politik. Mos në një anë ishte shpirti i lirë dhe në anën tjetër vullnete të ndrydhura? Mos ishim të ndarë dhe në rrugën e letërsisë: ai tek “realizmi i dënuar” dhe unë tek “realizmi socialist”? Nga 1972 deri më 1985, dy vite para daljes së Visarit nga burgu dhe 4 vite para rrëzimit të regjimit, 13 vite vara-vinga, mezi munda të botoja libërthin me poezi “*Në kthjelltesinë e syve*”, i kapur me tela dhe jo me penjë, i cili më përngjante me skeletin e peshkut, që plaku Santjago i Hemigüejt nxori në breg. Visari e humbi betejën me redaktorët, po unë a e kisha fituar atë?! “Libri është i mirë kështu siç është dhe jo ashtu, siç kërkon ta bësh ti.”-do i thoshte Kadareja redaktoret së librit të Faslli Halitit. Zor se i ka shpëtuar kush rrumbullakosjes, kuadratit për të qenë brenda, ndëshkimit paranojak se mos po bëhej gabimi. Visari nuk lëshoi pe dhe ata i shtërnguan litarin. (Zyrat po perceptoheshin si vendi ku tridheshin demat.) “Vallë ç’ duhet bërë për të shpëtuar poezinë nga mati i drunjtë i dobësive?”-shkruan ai në poezinë “*Kullë e fildishtë*”, e shënuar kjo poezi në akt-akuzë si “provë krimi”. Pikërisht, në kohën e “*gjuhës së drunjtë*”, mori përparësi “tallashi i presuar”. Thirrja e poetit për të shpëtuar poezinë, përputhej në parim me luftën e pretenduar kundër skematizmit dhe mediokritetit. Thirjet për shpëtimin e poezisë, të dorëshkrimeve të mbyllura në sirtarë, u perceptuan si kërcënim ndaj artit zyrtar, socrealizmit, sikurse preferohet ky term sot me ngjyrim pezhorativ. Përballja e shpirtit poetik të Visarit me prozaizmin e

redaktorëve mori përmasat e një drame. *Është e turpshme ta shohësh atë, si një melodramë*. E bën shembull, që të zinin mend dhe ne të tjerët. Sikurse do na kërcënonin, kur ai u fut në burg: “Ishalla u del ndonjë e keqe me Visarin, pa ia tregojmë qejfin edhe këtyrë?!”

Në librin voluminoz “Kartela të realizmit të dënuar”, quajtur prej Visarit si “letërsia e burgut” radhiten të gjithë autorët, që, në vend të dekoratave: kishin plagët. Kur Visari i referohet letërsisë së realizmit socialist, kartelat janë bosh, pa emra. Ndërsa, Agron Tufa, pa mëdyshje, i plotëson kartelat me emra konkret, duke e cilësuar letërsinë e realizmit socialist si “letërsi morgu”: “Romane të tilla të kësaj kolane janë: “Çlirimtarët” e Dh. S. Shuteriqit, “Ata nuk ishin vetëm” të S. Spases, “Para agimit” të Sh. Musarajt, “Ara në mal” të P. Markos, “Lumi i vdekur” dhe “Juga e bardhë” të J. Xoxës (përkatësisht paralele të dy romaneve të M. Shollohovit “Doni i qetë” dhe “Tokat e çara”), “Një vjeshtë me stuhi” të A. Abdihoxhës (paralele me “Garda e re” të A. Fadajevit), “Përsëri në këmbë” të Dh. Xhuvanit (paralel i “Si u kalit çeliku” të N. Ostrovskit), “Komisari Memo” i D. Agollit (shih “Çapajev” të D. Furmanovit e disa romane të tjerë socrealiste sovjetike mbi luftën), “Përballimi” të T. Laços (shih “Buka” të Aleksej Tolstoit), “Zbulimi” të A. Kondos (shih “Çimentua” të F. Glladkovit) etj, pambarim.” Konstatimi i Tufës për ndikimin e letërsisë sovjetike qendron, ndonëse shumë shkrimtarë sovjetikë ishin nën ndikimin e artit perëndimorë, përfshi dhe Majakovskin. U mësuam të marrim, ç’ ka lënë të tjerët. Edhe kur u prishëm me Bashkimin Sovjetik, edhe kur luftoheshin ndikimet borgjezo-revizioniste, ndikimi i letërsisë sovjetike lejohej, bëhej një sy qorr. Duke u mbrojtur Stalini mbrohej dhe Zhdanovi, hartuesi i metodës së realizmit socialist, i pranuar në kongresin e parë të shkrimtarëve sovjetikë, ku në tribunë bashkë me Gorkin ishte dhe Pasternaku. (Ndërkohë, Kadare botohej në Perëndim, duke ecur në drejtim të kundër të rrymës.) Konstatimi i Tufës, referuar shembujve të mësipërm, nuk ka të sharë, por, konkluzioni: “letërsi morgu”, është i ekzagjeruar, për të mos thënë: një nihilizëm mefistofelian. (Më duhet ta përsëris: ra metoda, por jo letërsia.) Duke marrë pjesë në funeralin e “letërsisë së realizmit socialist” lihet të kuptohet, se letërsia e mbijetesës, kjo e burgut, ka përmbysur herarkinë e vlerave. Mbrojtësi më i flaktë i kësaj letërsie është pikërisht Visar Zhiti, njëherësh i pakursyer në vlerësimin e Kadaresë, Agollit, Arapit, etj, ngaqë në vend të mureve preferon të ngrejë ura, duke mos u bërë urë e vig të kalojë i mirë dhe i ligë. Si viktimë e akt-ekspertizave, distancohet dhe prej kritizërëve, përherë këmbëngulës në *promovimin e vlerave të munguara*. (Vitet ‘60-të kanë hyrë në histori, si lufta midis poetëve anakronikëve dhe novatorëve. Enver Hoxha nxitoi t’i shuante gjakrat, duke mbajtur anën e të rinjëve, pavarësisht se “Grupin komunist të të rinjëve” e kishte eliminuar me metoda terroriste, sepse përplasja e shkrimtarëve shfaqte simptomat e “luftës së brezave”, kur kauza



e diktaturës ishte “lufta e klasave”. Gjithsesi, ishin anakronikët që i shtonin radhët, si gardianë të metodës së realizmit socialist, ndërsa novatorët rralloheshin rrugës: mbaheshin nën trysninë e gabimit të mundshëm, të akuzuar shpesh se po shkelnin parimet e metodës, sikurse i ndodhi dhe Visarit. Realisht novatorët u ndodhën midis dy zjarresh: anakronikëve të djeshëm dhe modernistëve të sotëm. Letërsia është një e tërë, pasi ajo ka vetëm një përmasë: vlerën e saj. Itakonte Visarit ta mbyllte shtegun e keqkuptimeve, si promovues i “letërsisë së burgut” dhe e bëri duke i qendruar besnik vetes: “Flokët a do të më bëhen më kaçurelë, kur të rriten? E vetmja dredhi e imja.” Duke mos vuajtur nga vesi i të përshtaturit, rigjenerohet përmes reflektimit.

Visari i ruhej gardianëve, unë vazhdoja të ngecja në pritat e redaktorëve dhe recenentëve, ku dorëshkrimet mbylleshin në sirtarë. Ishte po ai shteg, që e kishte daljen në qeli. Jeta e solli që të mos i përkas: as “letërsisë së realizmit socialist” dhe as “letërsisë së burgut”. Kështu që s’kam ndonjë konflikt interesi në trajtimin e tyre. Gjithsesi, gardianët nuk e ndalonin dot Visarin t’i hipte Pegasit, kalit fluturues. Ja sesi: “U pashë në sytë e kalit/(Pegasit)... Isha i qethur tullë, pis dhe me mjekërr.../U mënjanova/se mos i dukesh kalit i egër.” (Sot është në modë të rruarit tullë. Shumica e atyre që merren me art, mbajnë mjekërra, ku Pegasin me sa duket e marrin me qera. Mos e dhëntë zoti të jenë vjedhës kuajsh!) Ngjall interes të dihet: Visari hyri në burg si poet (27 vjeç), ishte burgu që e bëri poet (35 vjeç) apo u kurorëzua në demokraci si i tillë? (“Librin poetik “Kujtesa e ajrit” e botoi në vitin 1993, në moshën 41 vjeçare.) Nëse ai s’do ishte një poet i suksesshëm, i spikatur në shtypin letrar të kohës, kam bindjen se do kishte patur një fat tjetër. Dihet që talenti është një telash. Titulli i dorëshkrimit “Rapsodia e jetës së trandafilave” në dukje i shkon për hosh “pranverës socialiste”, por, i duhet dhënë përgjigje faktit: pse vëllimi poetik ngeci në sirtarët e redaksisë nga viti 1972 deri më 1979, aq vite sa autori vuajti dënimin në burgun famëkeq të Spaçit, 1980-87? Gjembat e trandafilave do i shfaqeshin tek telat me gjemba. Nëse në Shtëpinë Botuese u mbajt peng, në shtypin letrar, gazeta “Drita”, revista “Nëntori” apo gazeta “Zëri i rinisë” Visari botonte rregullisht poezi apo cikle poetike, ku spikati, si një talent premtues. U bë i njohur ende pa shkuar tek libri. Shtypi letrar veç imazhit pozitiv e kishte certifikuar dhe politikisht. Si ndodhi që, deklarimet publike thuajse superlativ të Driteroit, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve i asaj kohe, u bënë nul para akt-ekspertizës së redaktorëve? Kjo përmbysje ndodh veçse kur ndërhyr një fuqi madhore. Vonë do mësonim se ky ishte Ramiz Alia. (Shtëpia Botuese mbante emrin e Naim Frashërit, kur dhe Naimi vetë *çensurohej*!)

Në burgosjen e poetit nuk duhen llogaritur vetëm dëshmimtarët, përfshi hetuesit, para tyre ka dhe shumë të tjerë, që japin konsiderata, krijojnë opinione duke rrëmuar në errëtime metaforash, zhdanovistë që përcillnin udhëzime apo shënime në anë të fletës. Në fillim poeti ishte i lirë, ndërsa poezitë ia mbyllnin në sirtar, më pas ndodhi e kundërta: poetit i hiqet liria dhe poezitë dalin nga burgu. “Me 94 poezitë në kokë, aq sa më dukej se i shikoja, edhe vargjet i dija si ishin vendosur në ajër, me pengun që s’i bëra dot 100, më çuan në burgun e Spaçit, ku një shok i ngushtë imi, çami Bajo, e thërras në libër, kishim qenë studentë bashkë e guxova e ia tregova, ia mërmërisja në terr, më nxiti t’i shkruaja, ato e të tjera dhe ai e miq të tjerë më ndihmuan në fsheshjen e tyre, në kashtën e dyshekut, në thasë, mes rrobave a ndonjë ushqimi, që lejohej në burg, etj, etj. Pata fat dhe i nxora nga burgu të gjitha poezitë e mia... është meritë dhe e familjarëve të mij, e sakrificës së tyre.” I gjithë ky rrëfim ngjethës, ka dhe një ngazëllim, që i dedikohet Pegasit. Pa ndihmën e një flete e të një pene, i duhej të krijonte në fshetësi, duke besuar tek “Kujtesa e ajrit”, rrënjësuar kjo ide ndoshta në orët e ajrimit. (Kontrasti i një “dhëu të hedhur”, me “vendin e mirë” ku ngrihet një teqe, reflektonte polarizimin moral të shoqërisë në diktaturë, e cila të shtynte të bëje keq, por nuk të pengonte të bëje të mirën. Fuksa kishte në radhët e krijuesëve, sikurse spiunë dhe në radhët e të burgosurëve. Për të vetmin njeri, që Kastriot Myftaraj ka folur mirë është komunisti Karahman Ylli. “Beu ynë ishte i mirë”, do i thoshte xha Lazja Ramiz Alisë.) “Dënimi im nuk erdhi nga shokët e mi, që s’dita t’i zgjedh e fola me ta, nuk di të më kenë denoncuar shokët, ja, juve ju kisha shokë a të tjerë si ju, nëse dini më shumë, do të doja ta thoshit, ndryshe ata nuk janë shokët e mi të vërtetë e as tuajt.”-reagon Visari i revoltuar ndaj një tentative për të ndryshuar motivin e burgosjes: jo për faj të poezive, scripta manent, por, me gjasa se i kishte dhënë gojës në shokë të gabuar, verba volant. Pra, fajin, ta ka llapa dhe jo shpirti krijues?! Nëse, Visari, i kishte hipur kalit fluturues, Pegasit, unë kisha shaluar “kalin e betejës”, duke mos shënuar asnjë fitore. Si ai dhe unë: në raport me kohën: mbetëm kalorsiajë. Nëse doje të frymëzohesha, me lejen e shtetit shkoje me hir në minierë dhe nëse duhej të ndëshkohesha për krijimtari të gabuar: degdisesha me pahir po në minierë. Ja që pasuritë tona

dilnin prej ferrit, duke mos e pretenduar: as “parajsën e humbur”, as “parajsat fiskale”. Nëse nuk do të ishte kështu, pavarësisht fatit, rrugët tona nuk kishte gjasa të bashkoheshin ndonjëherë.

Prej vitesh ishim shokë bange, ku urtësia e mësueses Liri Kazazi, mbeti si një bekimi në rrugën tonë të mundimshme drejt artit. Kur lexoj poezinë “Të (mos) skuqesh”, e cila, e merr spuntton nga ndërhyrjet kozmetike për të hequr skuqjen nga fytyra: “...sepse është turp të kesh turp. Nuk duhet të skuqesh më.”, më sjellë në mend fytyrën e Visarit, që bëhej flakë në momente zori. Tek ai e gjeti të shfaqej e kuqja?! Një udhëtar në një natë dimri troket në një derë malsori. E hap një grua e re: “S’ e ngriti fenerin të shihte se kush isha./Mjafton që fytyra ime ishte e njeriut.” Është po ajo situatë e një kënge, që pëlqehet në publik: “Ti më vjen pa trokitur”. Ky që vinte pa trokitur në këngë, ishte “i yni”, ndërsa ai i poezisë: i padëshirueshmi?! U fanitej vetja me napse cubi dhe e kërkonin kusarin ndër ne. “Kush del në këtë rrëmujë e në këtë rrëmet/O është hajdut, o është poet?!”-ishin vargjet, që na pëlqente t’i thoshim shpesh. Në bangë si shkollar, mes bangave si mësues, i rritur me raftet e librave në sy, ku: “Dëshira e shenjtë e rritjes/na detyroi të bëheshim burra./Nga jelet të sajnim harqe violinash./nga kapistrat/të mendonim hekurudha.” Ku ta dinim se një ditë, Visarin do e priste një tjetër bangë, ajo e të akuzuarit?! Edhe “shkollën e burgut” e kishte mangut?! Lexonim thujse të njëjtat libra, i gëzoheshim patosit të ndërtimit, transformimeve, rendnim pas së resë, duke admiruar idealet dhe urryer pretendimin se njeriu duhet të rrojë për shtetin. Ishte koha kur vizionarët përndiqeshin prej largpamësve. Nuk mund të mos bëjë përshtypje zelli demoniak i krijesëve dhe i redaktorëve, ku akt-akuza ndaj poetit merr autoritetin e një pretence: “Ky element armik është i bindur në mendimet e tij të gabuara dhe armiqësore.” Përdorimi i termit të botës inorganike “element”, vinte si një kërcënim për botën e gjallë. Jo më kot Ayn Rand romanin e saj me subjekt nga periudha e terrorit stalinist e titullon “Ne të gjallët”. (Kapja e shkelsit të kufirit, shkelësit të vijës, i normave të moralit proletar, pra, aksionet për kapjen e “elementit armik”, aq më mirë në radhët tona: të kujtonin betejat me pushkë druri, që bëheshin dikur në Meksikë, ngaqë kapja gjallë e armikut kushtonte goxha shtrenjtë në tregun e zi të robërve, ndërsa vrasja e tij mbetej thjesht një kufomë e kthyer në statistikë. Zeja e përfitimit në kurriz të “elementit armik”, u kthye në një biznes fitimprurës. Hapja rrugën vetes duke ia mbyllur të tjerëve.) “Ky pseudopoet në vend ta vërë talentin në shërbim të popullit (Pseudopoeti na paska talent?! F.R)...derdh helm në mendjen dhe ndjenjat e lexuesit” Absurde ta mendosh se një libër në sirtar nuk paska lexues?! Për më tepër që autori: “Është i mbyllur dhe përdor figura që nuk zbërthehen dot.” Jo më kot një nga perëndit e Olimpiti i drejtohet Prometeut: “Fol qartë, Promete, jo me enigma!” Nëse hajdutët nuk arrijnë të zbërthejnë një kasafortë, mos faji i duhet vënë pronarit?! Një vend i gojës së kyçur, *hermetik*, i trëmbej figurave që nuk zbërtheheshin?! “I lodhur nga mosgjetja”, ku një “fjalë jetime/i thotë të gjitha.”, poeti i mësuar që tek të ndaluarat të gjejë atë që do, ecte në rrugë të pashkelura, por, një e drejtë kjo që u njihej veçse udhërrëfyesëve, që pretendonin se “*çanin në shtigje të reja*”. Vetë mburreshin, që shkelnin në shtigje të reja, ty të ndalohej të ecje në rrugë të pashkelura?! “Vetëm një këshillë e vogël miqësore: mos harroni se në fjalim u tha se *ç`i pret ata që kujtojnë se janë më të mençur se partia.*”-*shprehet një nga* personazhët e Ayn Rand *në romanin “Ne të gjallët*”. Hiqeshin se “Fjalët e qiririt” të Naimit i mbanin si amanet: “Në bëhi shokë me mua,/në më doni si u dua./njëri-tjetërin në doni,/të paudhë mos punoni.”, por, në kohën e pishtarëve të kuq apo blu, “fjalët e qiririt”, nuk vlejnë as

për një: “I ndrit shpirti”. Kush po bënte paudhësi: poeti apo akt-akuzuesit e tij? “Ky pseudopoet me imitimet e artit reaksionar është përpjekur të mbjellë barëra helmuese në kopshtin tonë të pastër letrar dhe të prishë kështu atmosferën tonë letrare.” Ta mbash dorëshkrimin prej 7 vitesh në sirtar dhe të ankoresh se ky po e helmoka aromën e kopshtit socialist, është si të presësh protagonizëm nga një gjallesë, që mbahet në inkubator? Ta heprpolizosh fuqinë demoniake të këtij “elementi armik”, aq sa prishka “atmosferën tonë letrare”, pa dashur ke pranuar fuqinë e talentit të tij. Sa të drejtë ka Antigona, kur rebelon: “Një i çmendur po më quan të marrë?!” Ndërsa redaktorët ankoheshin nga helmi, Visari, botonte në shtypin letrar, i përcjell me një jehonë pozitive, i dalluar për një frymë të shëndetshme, që silltë larmia figurative. Mozaiku shkakton alarm në botën bardhezi. Imazhi i tij poetik ishte krejt tjetër nga portretizimi në akt-akuzë, si një keqbërës me rrezikshmëri të lartë. “Njerëzit që po drejtojmë, nuk po rriten, ata po tkurren. Po tkurren në një nivel ku asnjë krijesë njerëzore nuk ka arritur më parë.”-ankohet shkrimtaria ruso-amerikane Ayn Rand. Të tkurrurit nuk mund të duronin bymimin e askujt, sikurse të krekosurit tërboheshin nga krenaria e cilitdo, duke u ndjerë të sfiduar. Ia njihnin vetës madhështinë e realiteti socialist

Me Visarin ishim, jo vetëm shokë të një bange, por dhe të një mëhalle. (U kthye në proverbiale batuta, që i jati i tij, Hekurani, aktor estrade, do i thoshte Dhimitër Shuteriqit, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve aso kohe: “Unë jam një shkrimtar lagjeje”.) Ndryshe nga jati, Visari, nuk do i fsheh pretendimet, ambicjet: duke trazuar ujërat e fjetur të provincës, ku të mësohet si të vegjetosh. Shpresa e vetme e Zhitëve për t’i ngritur lart, do i fundoste edhe më keq, vetëm ngaqë “plangprishësi” tërhiqej nga “bota e madhe” e artit, kur të këshillohej t’i shërbeje “botës së re” të propagandës! “Dritaret/janë britma ime që të braktiset/dhoma e errët e vetmisë”-shkruan ai, pa fshehur asnjë lloj djallëzie, përngjashëm me personazhin Poco të Samuel Bechettit: “Sepse unë, miqtë e mi, nuk rri dot pa njerëz për një kohë të gjatë dhe kur ata që më rrethojnë nuk janë krejt si unë.” Britmën ia morën si dobësi dhe nuk ia kursyen dhomën e errët. Ka të ngjarë që kjo poezi, të jetë e një kohe me ndryshimin e titullit të romanit të Kadaresë nga “Dimri i vetmisë së madhe” në “Dimri i madh”, ku hiqet fjala “vetmi”. Regjimi nuk e duronte fjalën “vetmi”, por, britma e poetit në këtë rast ishte kundër “heroit të vetmuar”. Ndoc Gjetja ka një poezi, ku kollitet në shtëpi për t’ mos u ndjer i vetmuar. Kur regjimi të dënonte, fëmijtë duhej të të braktisnin, gruaia të ndante, shokët dhe miqtë të largoheshin, pra, të mbeteshe vetëm. Në këtë poezi, thonë akt-akuzuesit, “ka një farë singeriteti. Si element armik ai e ndjen veten të vetmuar dhe të braktisur në ambientin tonë socialist.” Një paragjykim vrastar. Shprehin si të mirëqenë atë që pritej të ndodhte: braktisja e poetit të dënuar. Me përdhunë tentonin të nxirrni dhe nga kujtesa e popullit. (Visari kishte shokë më shumë nga të gjithë ne.) Nëse ti je vetëm dhe zgjon gjyshin, përsëri tenton të largosh vetminë. Por, nipi në një vend ateist, thua se po ngjallte Jezusin. “-Gjysh, o gjysh, çohu!/-Ç’është, bir?/-Kam frikë se mos nuk zgjohesh më.” “Hetuesi më ulërinte se “është thirrje që të ngrihen klasat e përmbytura, nga që gjyshi yt ishte shpallur kulak”. Për *çudi kjo hamendje perverse i ndodhi së vesë së diktatorit, ku nusja shkon ta zgjojë: “Çohu, mama, se po shkruajnë gazetat se ke vdekur!”*

“Dikur mbanin gaztorë. Tani mbajnë sejmen.”-ky është dallimi i një oborri mbretëror nga ai i Bllokut komunist sipas Samuel Bechettit, i përligjur ky perceptim dhe në vargjet e Visarit, që ekspertët e akt-akuzës e përdorin si provë të fajsisë së tij: “Unë nuk *çava përpara në art, sepse paskam dashur gërmadha/por nuk më deshën (dhe s` më ndihmuan)*, sepse unë duke u bërë burrë, do të isha talent/i tmerrshëm... dhe nëpër dosje e lanë zemrën time si një

mi/që bren veten e vet.” Kjo është esenca e gjithë këtyre shfaqjeve armiqësore... Autori nuk është i kënaqur me realitetin tonë dhe është gati të thyejë dhe brinjët e tij, vetëm të dalë nga ky realitet, të cilin ai e quan frengji.”-nënvizojnë akt-akuzuesit, duke folur me gjuhën e djallit: “Vetëm realitet nuk sheh në këto vargje, veç revoltës së poetit ndaj pengesës artificiale që i bëhet, por që në fakt është censura e shtetit.” Konflikti shkon përtej një zyre redaksie, por poeti nuk e sheh. Kurdisjet nuk janë të atij që shpiku orën. “Mohoju më të mirëve të drejtën për të kapur majat, dhe s` do të mbetet prej tyre as nam, as nishan. E çfarë janë masat popullore tuajat, veçse shpirttra të topitur, të vyshkur, të mykur, që s` kanë mendime të vetat, vullnet të vetin, që hanë, flenë dhe përtypin pa mendje fjalë që ua fusin të tjerët në tru?”-futet mes palëve Ayn Rand, ku poeti tërhiqet nga ideja për të kapur majat, ndërsa sejmenët e regjimit tentojnë të topisin shpirtin e tij, që, nga një inkonformist *të lëpijnë zgjedhën dhe të hajë bukën e përulësisë*. Visari e parandjen fatin e tij të turpshëm, thonë akt-akuzuesit, ndërsa poeti e sheh të keqen e vetes tek talenti “i tmerrshëm”. Është një dyluftim që ka zgjatur 7 vite, ku palët nuk i hapin rrugë njëra-tjetrës. Në poezinë “Në amfiteatrin e madh” dozat e pakënaqësisë shtohen: “Ndoshta një djalë të guximshëm./ (ai paska fytyrën time)/e burgosën në sallën me tigra./se deshte *të bënte kryengritje.*” *Poeti u kishte dhënë material, ta sulmonin. Më në fund pajtohet me fatin:* “S` kisha pse t` i tregoja hetuesit që aq shumë më pëlqenin mbrëmjet në Tiranë dhe, që të zuzarepsja deri vonë, nuk shkoja nëpër kushurinjtë, por, meqenëse nuk më mjaftonin paratë për hotel, flija i lumtur lulishteve. Mbi gjethet e mëdha të vjeshtës shkruaja poezi... Dënimit s` i shpëtoko dot, por pakso dhembjet dhe brerjet e saj, të mos jenë të gjithmonta. Se ti u caktove për humbjen.”-shkruan Visari në librin “Rrugët e ferrit”. Pse redaktorët nxitoni ta quanin “armik”, ende pa u shprehur gjykata? Sepse fati i poetit ishte i paravendosur nga lart. Qe i shenjuar, sikurse druvari bën shenja në pemën, që duhet prerë në pyll. (Bashkëvuajtës të Visarit, si Ngjela e Lubonja, i shkruanin Ramiz Alisë nga qelia. Edhe Ramizi ka shkruar libër burgu, por a do përfshihet në “letërsinë e burgut”?) Si ndodhi që, edhe në demokraci, kryetari i shtetit, president Nishani, nisur nga “qytetari digital”, një ish shef i policisë së bërhen, sulmon sërish poetin? Si është e mundur, që lart e poshtë bëhen kundër tij, edhe në diktaturë, edhe në demokraci? Sepse në Shqipëri flitet veçse për të rrëzuar. Më me fat del të jetë Enver Hoxha, që i rrëzuan vetëm shtatoren.

Ishim jo vetëm në një bangë dhe në një lagje, por jetonim dhe në një qytet, i njohur për qendra internimi më shumë se në çdo zonë tjetër të Shqipërisë, ndërkohë që lëvdohej si “hambar i Shqipërisë”. Hambar apo qilar? Nëse “dielli alegorik” i Migjenit merrej si një ogur i mirë, “dielli i dytë i Visarit me gjakun, që derdhet.”-u interpretua si një ogur i zi. Paranojakët, duke patur monopolin mbi simbolet, dhe vargun më të çiltër: “E di që do ta dalë në një arë me diell.”, që, e gjeje thujse tek të gjithë poetët, ia morën *për ekuivok, si një shteg për në “parajsën e humbur”* të gjyshit kulak. Cili optimist nuk do të ngazëllehej nga ky varg: “Një kali të shkoqësh./të mbushet dora me kokërrza të ëmbla shprese”? Dhe më tej: “E desha grunoren në rrethinë./Kallinjtë e rënë mbi buzë desha./Sa herë e zhvesha dashurinë./Aq herë me dashuri u vesh.” Adrenalina rritet: “E desha grunoren në rrethinë./Kallinjë e rënë në libra desha./Të mbyllësh sytë si kopertinë./Ta vazhdosh librin, ribëhet vetja.” Poezitë me varg të rregulltë, tradicional, kalonin paq, ndërsa dyshimet hidheshin tek vargu i lirë. Kujtoni shprehjen e kapove, sa herë u duhej të sulmonin ndonjë tendencë liberale: “Ça, u lirua kshu? Liri e popullit!” “Në poezi duhej të ishim të lumtur”-shkruan Visari. Gjithsesi lirikat e tij nuk janë shtirje. Në to burojnë vrulle djaloshare. “Sa herë ndoqëm pas karrocat tuaja/nëpër rrugët e verbta gjithë baltë./Ju mbajmë mend, me mjekrra të parruara./me kamxhikët që s`goditët./por i mbanit lart.” Shihni se ç`kontrast krijohet, midis karrocierëve dhe ata, që nuk i kursyen kamzhikët e Shën Pjetrit mbi poetin. “Qytet i dhëmbshëm./qytet i vogël./ku përsëritej herë pas here e njëjta ngjarje./Ne, të ardhurve, na i dhe një shtëpi/si fole në sqetullën e një dritareje.” Mirënjohja e tij shkon për bujarinë myzeqare, ku së fundi shpallet dhe Qytetar Nderi i Lushnjes. “Dobësinë time për të qenë sa më i dashur e kishin pikasur dhe të tjerë. Narcizmi im-të mbytesha nëpër sytë e bukur.” Mund të mrekullohesh tek “syri i kaltër”, por mund të bjesh dhe në një gropë skeptike. “Ne nuk pranojmë asgjë mbi kokë/shumë-shumë mund të pranojmë kapelet tona.”-shkruan ai tek poezia “Njerëzit e punës”. Fundja pushtet i popullit, klasa punëtore në fuqi, sikurse thoshin. “Jo, jo,/Nuk i lyej këpucët/Te llustraxhinjtë!/S` i dua njerëzit te këmbët e mia.” Pse duhet parë me dyshim poeti, kur “thjeshtësia proletare” predikohej dhe nga: “I tmerrshmi sfinks me krifa muzgu/qëndron i zymtë mbi shkretëtirën./Madhështia e tij e rëndë prej guri/e bëri, ah, të palëvizshëm!” (“Një gazetë italiane do të vërente se Kadareja i kishte shumë të shtrenjta këpucët, edhe pse i takonte një vendi të varfër.” “Sepse ju të shikoni nga këmbët”,-u qe përgjegjur shkurt shkrimtari ynë. “Meqë binte shi, ajo pati veshur një palë çizme të shkurtra, të cilat u evidentuan nga kameramani... Që atë mbrëmje, të nesërmen dhe disa ditë më pas zien komentet inatçore kundër Nexhmije Hoxhës, jo aq për çfarë kishte thënë, por për çizmet, si dëshmi luksi.” Sa shumë që u fol dhe për çizmet e shtrenjta të Monikës. Poetit i duhej të thurte vargje nën çizmen e ushtarit, për të vetmin faj se mund të pranonte mbi kokë shumë-shumë një kapele. “Ja, kështu e ka njeriu. Merret me këpucët, kurse fajin ia ka këmba.”-do ankohet një nga personazhët “Duke pritur Godon.”) Qyteti, *që do ta frymëzonte në rini*, boçet e pambukut, karrocieri, do ta zhgënjente më pas, kur ai do të rikthehej nga burgu. “Qyteti s`më flet./Qyteti më ka harruar. Paranojak është qyteti./Rrugët s`më çojnë dot deri në fund të një mendimi.” U trondita shumë kur e gjeta babanë të verbër, nuk më kishin thënë në letrat që më dërgonin, që të mos

Vijon në faqen 7



Rreth përmbledhjes së parë me poezi
të Agron Tufës “Aty te portat Skëe”

PRAPA MURIT TË DHUNËS – “BARI QË RRITET MBI VARRE”

Nga Ballsor Hoxha

Përmbledhja e parë me poezi e Agron Tufës – “Aty te portat Skëe” është një prej testamenteve poetike të kësaj kohe të post- tiranisë komuniste në Shqipëri. Dhe atë pikërisht në hapjen, si të Portave Skëe (shih parathënien nga autori), të vetë qëniesimit në tërësinë e tij: prej mitikes, Zotit, tej tek njeriu - i “privuar në mish” dhe në “barin që rritet natyrshëm mbi varr”, gjë që është cikli i plotë i vetëdijes së njeriut, në lirinë e plotë. Në fjalë të tjera është një ndër veprat e para post – komuniste, kur një vepër hapë horizontin e qëniesimit në të gjitha zonat e vetëdijes së tij. Kështu duke e parë lirinë të plotë, dhe paradokslisht, me “barin i cili natyrshëm rritet mbi varrin e njeriut”. Pra, në tërë lirinë e qëniesimit të njeriut.

*“Pos dritës së Zotit s’ka vdekur
Gjithë ç’që e privuar në mish,
Dhe nata, si provë e pjekur,
Dergjet pa frymë mbi plis.”* (poezia “Provë e pjekur”)

Le të nisemi pra nga kjo poezi e përmbledhjes “Aty te portat Skëe” të Agron Tufës. Tri shtresa, tri lloje të vetëdijes në të vërtetë: Zoti, e privuara në mish, dhe nata provë e pjekur. Tri paravetëdije, tri primordiale, dhe tri ekzistenca të pavetëdijshme, përkundrazi. Poezia e Agron Tufës, në këtë përmbledhje, para leximit të tij të Martin Heidegger, para studimit të këtij filozofi gjë e cila do të ndikojë në këtë poet më vonë, është një “portë” e cila hapë qytetërimin, sipas tij, në të përjetshmen, siç e quajmë, por që në të vërtetë është paranjerëzore, dhe pas njerëzore, në të vërtetë e pandjeshme ndaj njeriut, si në qëniesimin e saj po ashtu edhe në të qenit ndaj njeriut.

Sigurisht, për poetë të këtij kalibri, qoftë përmbledhja e parë, e qoftë e fundit, është e përqendruar në sistem personal poetik, poetikë unike. Përmbledhja “Aty te portat Skëe” është

një hapje e qytetërimit, dhe më tutje përballje e njeriut me - zotin të vetmin të vdekur -, me njeriun “të privuar nga mish”, dhe deri tek nata/natyrja/universi i cili po vdes, *po dergjet*, dhe po mbetet nën “barin e varrit”. Për më shumë, janë disa nga simbolet e këtij poeti që e krijojnë këtë sistem: zoti, qytetërimi, “bari i varrit”, “filli”, harrimi dhe vdekja, dhe “varri lundruar nëpër natë”.

*“I ankoruar te kjo dhomë
Si një varr lundruar nëpër natë...”*

...

Përnjëherë rrëqethja fëshfërin

Në kurmin tënd të butë

Me ngatërrimin e vetave...” (poezia “Kontrapunkt”)

Sikur ta marrim që vargu “përnjëherë rrëqethja fëshfërinë” është intertekst, i pavetëdijshëm, apo periferik me poezinë e Camajit mbi vdekjen, del një ndërthurje perpetuale, e cila zbulon dhe shfaqë strehën e poetit të “Aty te portat Skëe”, në poezinë e Camajit dhe në përpjekje perpetuale për të komunikuar të harruarën e “të të gjithës” nga komunizmi tashmë në ikje e sipër të kohës reale të këtyre poezive.

Në poezinë e Camajit kemi, si shembull poezinë:

Disa herë në jetë

*Disa herë në jetë e ndieva në fytyrë
erë e trupit të saj në lëvizje
dhe s’pata frigë. – Mordja! – thashë
e duert e mija ishin të ngjituna
ngusht njana me tjetrën
dhe s’pata frigë
Në gishtat e mij kisha lidhun dhimbën
me fije të kuqe*



dhe dashuninë s’e harrove.

*Besoj se asht larg,
por kur ajo në ndonjë fatkeqsi
ngreh kambën rrëshanë nëpër pluhnin
e gërzhatshëm t’udhave, më përqethet
shtati, e s’kam frigë.*

Besoj se asht larg,
por kur era muzgut më kapet për tesha
mërdhas e parandjenja e saj m’fryn zemrën
me plasë: Ajo asht e ftohtë!

Kur të vdes, më veshni me tesha të leshta
sikurse ishte dokja ndër të parët e mij
(Martin Camaj, poezia “Disa herë në jetë”, përmbledhja
“lirika mes dy moteve”)

Është ndër-komunikim dhe aq më shumë kthim prapa në të provuarën dhe në të kaluarën e përjetuar si të plotë me të gjitha mundësitë, prej Zotit të pandaluar e deri tek “mëlçia” e njeriut.

Në njërën anë kemi poezinë e Tufës e cila ndërton shprehjen e saj përmes zërimit të “Zvarritjes” së vdekjes në trupin e tij, të të prëafritmit të ankthit ekzistencial ndaj vdekjes, dhe në anën tjetër është poezia e Camajit e cila shtjellon këtë ankth ndaj vdekjes, si fenomen i paevitueshëm njerëzor, në zërin estetik të “zvarritjes” së saj nëpër trupin e poetit.

Por, në të vërtetë, poezia e Tufës, është shumë më thellë në ndërkomunikim me poezinë e Camajit, duke qenë se ri-mishëron dhe gjen “zvarritjen” e një fenomeni si ankthi njerëzor ndaj vdekjes, kudo dhe në çdo moment e hap të lirisë, tashmë të hapur nga “Portat Skëe”.

Është një poezi, duke përfshirë të dyja, atë të Camajit dhe të Tufës, shprehet si një çift binjak siamezë e cila lundron, përpëlitet nën, dhe i del përballë si – Resoluteness – këtij ankthi njerëzor ndaj vdekjes.

Të dyja këto thekse, të poezisë së Agron Tufës, qysh në përmbledhjen e tij të parë, pra qëniesimi i plotë, deri në ekzistenciale të plotë, dhe në anën tjetër interteksti i tij me poezinë e Martin Camajit, janë motivi, interesi, sistemi i lartcekur, dhe aq më shumë filozofia e tij.

Në këtë, koha reale e kësaj poezie duke qenë – kalimi – i shoqërisë shqiptare nga komunizmi dhe diktatura, në demokraci dhe liri të kësaj shoqërie, e gjen poetin të kapur pas kërkimit të “fillit”, e filli duke qenë vetë “mëlçia” e njeriut. Njeriu i gjendur në – aporinë – e të vuajturit të dhembjes, dhe në të njëjtën kohë të të qenit i përhumbur në topitjen nga dhembja, pandjesia ndaj saj dhe “harrimi” i saj.

Dhe po kjo duke e thelluar po të njëjtën – apori – në “fillin” e ditur, të freskët e plagët të pambyllura, dhe në përhumbjen e njeriut në ironinë e “mungesës” së fillit.

Por “bari i rritur mbi varrë” është i shtrirë në tërë poezinë e Agron Tufës. Si ankth, ekzistencial, dhe si dëshmi e reales, si vrojtim i jetës ndanë tij, si paqe, më në fund, jo e “dhunës”, jo e dhembjes, jo e vrasjes, por e të parit matanë murit të vrasjes dhe dhunimit të diktaturës, në vetë vdekjen në të cilën vdes njeriu.

Sa është e dhembshme, sa është paradokslae, dhe po aq edhe dramatikë e errtë, në të vërtetë, kjo është liria, e plotë dhe e natyrshme: bari që rritet mbi varrin e njeriut.

Menjëherë, në këtë liri, njeriu kalon në të “Privuar nga mish”, në të vërtetë, në – aporinë – e të qenit mish, i etur, i pangopshëm dhe i patjetërsueshëm në këtë, dhe me “problemën” e kockave që i mbeten si përkujtim i një kohe “kur njerëzit e hoqën qafe mishin”. Aq më shumë poeti – thërret –
“... shpall botërisht
Divorcin e madh
Të kockave me mishin...”

...

Kam neveri

Dhe dua të arratisem përgjithmonë

Nga ky burg banal prej mishi.” (poezia “Apologjia e kockave”)



Por, së pari, para se të qëmtojmë “problemin e mishit”, të trupit, të pangopshmërisë së tij banale, le të quajmë tri shtresat, zonat ku edhe gjallon poezia e Tufës.

Ajo hapet në dyzimin e mitologjikes, dhe të të kaluarës së Qytetërimit të njeriut, në poezitë e para (shembull këtu janë poezitë “Elegji”, “Pikturat e Tua”, “Këngë”, “Kuajt e ëndërrt”, etj).

Më pastaj poeti mjeshtërisht krijon zonën dhe shtresën e radhës së perpetuales së poezisë së tij, brenda vetëdijes/dritës/zotit, gjë që e përballë atë si njeri.

“*Zoti majtas dhe zoti djathtas
Të shtypnë për në qendër,
Ku një tjetër, po ashtu zot,
Ai sipër dhe
Ai poshtë,
Gjuajnë fort dhe egër
Mbi kopenë e trembur në qendër.*” (Poezia “Siujdhesat e Odiseut”)

Dhe në fund shtresa e të qënit të gjallë i vdekur “*... Andej del faresh një shilarës i çartur,
Mbi faunën e yjeve duke bërë kërdi.
Lëshohet gjith'kob mbi tokën e plakur
ku kurrë nuk vdiq, as nuk u ngjallë njeri.*

”
*Ndaj, Zot, mos na lër kokën ta kthejmë
nga dergjet përthellë kapitje luledielli.
Mbi teka e pengje pa mort bleroftë
Injëjti dru i vdekshëm – Harrimi!*” (poezia Nga e shkuara vjen stuhia”)

Këto tri zona të gjallimit të poezisë së Agron Tufës, prej dramatikes dhe dyzimit të mitikes me realen aktuale të poezive të kësaj përmbledhjeje, si happe, e njerëzimit ndaj qëniesimit në plotësinë e saj, e më tutje në konfliktin dhe përballjen me zotin, dhe më tutje në të qëniesuarit dhe të kaluarit në qëniesim të vetëdijshëm mbi Harrimin, dhe të të vdekurit , të vetë Temporales, poezia e Agron Tufës krijon kockën e saj, të fundamenteve të saj dhe të masave të saj të përballjes dhe të qëniesimit të saj.

Dhe tani, pasi që kemi kaluar nëpër këto katër zona, duke i kthyer njeriut, si i privuar në mish, si qenie e pangopshme, si qenie harruar kocin e tij, si qenie e tradhtuar veten e saj gjendemi përbrenda dhe përballë ekzistencës sonë, të menduar si thirrje (- summon – nga anglishtja) të të gjitha zonave të qëniesimit dhe të lirisë.

Poezia e Agron Tufës në këtë përmbledhje është meditim i dramatizuar poetikisht, dhe meditim e filozofi omnishente ndaj temës së saj. Në të vërtetë ajo shfaqet e këtillë në të shumtën e përmbledhjes dhe si intimitet poeti në poezitë e tjera, siç është në poezitë e titulluara Kontrapunkt dhe Kontrapunkt 2, ndër të tjera.

Mirëpo ajo gjithherë është e kompozuar në konstelacion, në perpetuale me poezinë e Martin Camajt. Në të vërtetë një prej poezive antologjike dhe rrënjësisht tronditëse është edhe poezia e fundit në këtë përmbledhje “*Kronikë e një vrasjeje të mallëngjyer*”

Në këtë poezi, ka një intertekst të shumëfishtë, gjithnjë duke konotuar tragjedinë shqiptare të gjakmarrjes, dhe të vazhdimësisë së saj. Interteksti është eksplicit në referencën ndaj këngës dhe legjendës për Aga Hasan Agën dhe dashurinë e tij të “privuar” nga gjakmarrja, dhe në anën tjetër është një lojë dhe ndër-komunikim me dramaticitetin dhe ekzistencialen e Camajt.

Përmbledhja me poezi “Aty te portat Skëe” e Agron Tufës është një udhëtim në hapjen e dyerve të qytetërimit, të vetëdijes, të Botës si Publike dhe aq më shumë duke shkuar tutje në thellimin e qëniesimit si ekzistenciale, me paravetëdijen dhe me paranjerëzoren e tokës. Është një nga poetizimet më kuptimplota të lirisë dhe të qëniesimit në liri pas rënies së komunizmit dhe të gjetjes dhe të perceptimit të vërtetë dhe të plotë të lirisë në qëniesimin e plotë të njeriut.

Është në të vërtetë e shquar dhe mjeshtëri e shquarjes së qëniesimit si ankh, si harrim, si Temporale e cila qoftë në lirinë e harruar kalon në një vdekje të pakuptim. Gjë që bën të dhembshmen e qëniesimit – pakuptimësinë e jetës, qoftë edhe në lirinë e njeriut!

Vijon nga faqja 5

dëshpërohesha... “Plak fatkeq, i verbër/më i verbër se nata. Asnjë yll/s’të vjen në ndihmë.” Dhe në fund pohon i pikëlluar: “Errësira ime e verboi”... Ndërsa një dramaturg i absurdit si Bechetti, do thoshte: “Një ditë të bukur u zgjova i verbër si fati.”

“A është e vërtetë se pas një kohe të gjatë në burg, i burgosuri dashurohet me qelinë?”-e pyet Ismail Kadare Pjetër Arbnorin. “Po, Zoti Kadare, i burgosuri dashurohet me qelinë.”-shkruan Edison Ypi në postimin e tij “Të dashurohesh me qelinë”. (Kur ra Muri i Berlinit, një gjermano-lindor, shkoi të vizitonte Murin Kinez.) “Ej, të ka marr malli/për burgun ty./nuk i tregoj njeriu?” Kjo retorikë provokuese e Visarit më shumë se sa trazon shpirtërat, trondit perceptimet. Kush nuk do të çuditej: të kesh mall për burgun?! Për të hedhur dritë në këtë paradoks, Uolltër Skoti, na afron urtësinë e tij: “Plagët që durohen për hir të ndërgjegjies kanë në vetvete balsamin shërues.” Një dukuri e rrallë, por jo kushdo e ushtron veten në këtë lartësi morale. Këto plagë që durohen për hir të ndërgjegjies, jo një ndërgjegjie dosido, por krijuese, është balsami shërues për një shoqëri ta traumatizuar prej urrejtjes. Pelegrinët u falen tempujve në maja malesh. Nga raportet ideale të plagëve me ndërgjegjien përftohet “balsami shërues”, një produkt aq i nevojshëm ky aty ku hakmarrja ka bërë kërdrinë. Poeti duke mos i patur ndonjë borbxh së shkuarës, i detyrohet vetëm së ardhmes, ndaj shpalos kredon e vet: “Ne nuk kemi shkruar nga urrejtja, por nga dhimbja.” Kjo kontratë me veten ia kalon çdo betimi. Si mund të pritet “balsami shërues” nga një “Pseudopoet... që është përpjekur të mbjellë barëra helmuese në kopshtin tonë të pastër letrar”, dhe tani na ofroka “balsamin shërues”?! Vetëm kështu mund të kuptohet se ka ndodhur një përmbysjë.

Të dashurohesh me qelinë, nuk është shfaqje e “sidromës së Stocholmit”, ku viktimia adhuron persekutorin, duke pritur shpëtim prej zemërgjerësisë së tij. (Superimi i avokatit mbrojtës në diktaturë favorizonte “sidromën e Stocholmit”. Kështu që ti: s`kishe xhami ku të faleshe, veçse tek ai, që të kishte jetën në dorë, xhebrahili yt. Persekutorrëve iu dha rasti ta luanin të mirin, ku ti të ishe mirënjohës për të keqen, që të bënin, qoftë dhe duke ulur ndonjë vit burg.) Edhe aty ku pasioni lë pak vend për dhimbjen, poeti befason, me vargje si këto: “Ty të ka marrë malli/për robërinë time të dikurshme./s` të kujtohet ngrohtësia e duarëve të mia të vrara./por prangat./Mbase buzëqeshja ime është më e varfër, se plagët e mia/që ti i lëvizje si dekor plot me yje/për profilin tënd”. Mos po shfaqen kthetrat pikërisht atëherë, ku priten përkëdhelitë? Trukohet edhe me prangat, duke i quajtur byzylykë. “Tregonim plagët tona./sikur t` i rrëfenim njëri-tjetrit gurë të çmuar, diamantë./dhuruara nga një përbindësh./Mburrehim me skllavërinë/duke e kritikuar ashpër. Dhe/s` po gjenim kohë të ishim të lirë./Dikur robër, mos ishim më të lirë?” Nga dekor i plagëve stolisur me thesarët e frikës, mos po nis kështu revanshi i medaljeve prore me prapavijë humbësish? Mos është po ajo inerci, që i ndodh çdo çlirimtari, të cilit nuk i ndahet shpirti nga lufta dhe s` do jetë tjetër, veç asaj: ku jetohet si në rrethim? Në këto përjetime, poeti shtron pyetjen: a janë bërë vrasësit më të mirë? “Seç kanë një frikë të papërcaktuar/i çojnë gratë të hapin derën.” (Ish drejtori i policisë së burgut, që “luante violinë dhe piano” ankohet se në burg “paska humbur pjesën më të bukur të jetës”. Ankesë gardiani dhe jo shaka! “Gardian i Kushtetutës” po i thonë dhe presidentit?! Duke mos patur reflektim, pale ndjesë, në sytë e specialistëve të artit, hetuesit dhe gardianit poeti vazhdon të jetë i padëshirueshëm. A do të ndodhte kështu, nëse do të ishin dënuar krimet e komunizmit? “Komunistët ordodoks” thënë ndryshe “xhaketat e kthjera”, ia dolën të vinin në kohën e re, duke rrëzuar shtatoren e Hoxhës. I dhanë gjithçka, duke e lënë pa gjë. “Të dy kishim një status, që s` ia kishim caktuar vetes.”-deklarohet shefi i policisë së burgut, duke patur *në krah dhe Presidentin e Republikës kundër poetit. Në këto kushte, kur gardiani qanë vitet e rinisë, pse viktimia duhet të ndëjë mall për qelinë? “Balsami shërues” nuk është për ata, që lëndojnë. Nëse* Patrokli merr rrobat e Akilit, ushtaraku i burgut thua se ka marrë uniformën e Trifon Xhagikës?! (Një uniformë do më ndjek pas gjithë jetën, shprehet nobelisti Pablo Neruda: i përndjekur nga regjimi i Pinoçetit.) “Nga shkaku i poezive klandestine në burg, rrija pa bërë rebelin, as heroin, poetin jo e jo, në heshtje i besoja një të ardhme.” Protagonizmi i poetit nuk është demonstrim force, nuk është mani për t` u dukur, veçse një ushtrim i vetes përmes fuqisë së fjalës dhe heshtjes përbuzëse. (Kur Odiseja kthehet në Itakë dhe nis të eliminonte rivalet e së shoqes, në një kthinë gjen një rapsod. Po ti kush je, i thotë. Jam poeti, i përgjigjet i mënjanuari. Odiseja ul shpatën. Mbi ty nuk vihet dorë, pasi ti do t` i përshkruash të gjitha këto, që ndodhën. Por, krimi shtetror nuk do dëshimtar.) Në burgun e shefit të policisë, në Spaçin e vitit 1981, në poezinë e arratisur, (ta paska hedhur poeti gardian,) me titull: “Rreshti i këpucëve të burgosura” Visari shkruan: “Ja dhe këpucët e spiunit./me lidhësen që u varet si shpifja nëpër gojë”, pasuar nga vargu i poezisë “Ëndrra”: “Dhe le ta bëjnë ferr galerinë/ti vuan që të mbetesh engjëll.” Nëse persekutorët nga “shtëpia e të vdekurve” presin të nxjerrin xhenazen, Nënë Tereza, pikërisht atje: i ngriti himn jetës. Ata që e futën poetin në burg dhe ata që i shpëtuan poezitë nga burgu, si betejë e përjetshme e trupit me shpirtin, dëshmon se shoqëria shqiptare nën diktaturë nuk ishte aq e nënshtruar sa dukej, dhe aq e indoktrinuar, sikurse e paraqesin. Ne kemi një problem me heroizmin, e shohim atë vetën në pjesën e dukshme të ajzbergut, më së shumti me heronjë *të fabrikuar, duke ngatërruar shpesh statujat prej dylli me ato të derdhura në bronz.*

“M` i hodhën prangat mu në mes të qyteti verior, Kukësi i Ri, jo shumë larg urës së madhe, ku ujërat e dy Drinave, i Ziu dhe i Bardhi, megjithatë nuk po flinin... Pallatet shëmbeshin pas meje, pa zhurmë në shurdhëri.” Krahas qytetit të vjetër i mbuluar nga uji i liqenit të hidrocentralit, tashmë i erdhi radha të fundosnin poetin, (e drejta mund të fundoset por nuk mbytet), i cili më 2 shtator 1979, i kushton poezinë “Kukësi i ri”, afro dy muaj më parë se të arrestohej: “Statuja vumë/mbi bulevardë./Në dyqan të çiftelive/gjen copra ballade./Dhe lejkëkët kur erdhën/pyllin s’e gjetën./Mbi pyllin me antena/U ulën lejlekët.” Një vit pasi Visari kishte dalë nga burgu, në vend të statujës, në sheshin e qytetit varet poeti Havzi Nela. “Kravata s` do kishte kuptim, në qoftë se s` do bëhej litar i varjes.”-shkruan Visari në poezinë kushtuar Migjenit, të cilën hetuesit dhe redaktorët e akuzuan se po nxinte realitetin. Siç shihet “lidhëset që varen si shpifja nëpër gojë” u kthyen në litar për poetin kuksian. “Unë jam Kryetari i Degës së Punëve të Brendëshme dhe shoku tjetër është Shefi i Hetuesisë, i cili ka zbuluar armiq shumë të mëdhenj e grupe të tëra armiqsore, kuptove?” (Krahas këtij hetuesi, po bëj dhe unë zbërthimet e mija.) “Ta zbërthym poezinë me specialistë, me kritikë të shquar, me poetë.” (Njëherësh krahës specialistëve më të shquar po analizojë edhe unë. Natyrisht në një kohë tjetër. Ata zbulojnë armikun, që fillimisht e mbyllën në sirtarin e redaksisë dhe më pas në qelinë e burgut, ndërsa unë po merrem me poetin, me të cilin kisha ndenjur në një bangë, në një lagje, në një qytet dhe tash në Amerikë.) “Im atë s` e fshihte kënaqësinë dhe mezi çpriste që poezitë e mia t` i shihte Razi Brahimi, specialist i klasit të parë... Një ditë ai lexoi poezitë e mia, ja dha im atë. I kisha hedhur në të pastër në atë fletoren e bukur, me kapak blu-mermeri, lidhur me atë spiralen metalike, të ndritur (si trupi i hardhisë që i vjen rrotull një pallati). Për të dëgjuar mendimin e Raziut, i thashë se a mund të vinim së bashku me një shokun tim të klasës, shkruan dhe ai, që të përfitonim së bashku. Po, tha ai. Dhe kështu Bardh Rustemi kundërshtonte për vërejtjet kritikun, më të mirin në Shqipëri, thoshin, Razi Brahimi.”-shkruan Visari në burgologjinë e tij. (Komenti është i juaj.)

“-E pse ke frikë të jesh armik?-më tha sikur unë të kisha refuzuar një dharatë.

-S` kam dhe aq frikë,-i thashë,-por s` jam.” “Krijimet e mija u bën krime. Kri(ji)me.” Poeti refuzon të qënit armik. Bëjnë punët e djallit duke tundur temjanicën.

“Mua po më trulloste absurdi... Metaforat?! Policia do të ndjekë metaforat? I njëjti inat si i redaktorëve dhe kritikëve ndaj konfigurës letrare... Isha bërë më i njohur si armik, jo si poet.” Lë pas yllin e kuq, dhe me “yllin blu të fatit” shkon në Kosovë, ku luftohet për të mbrojtur një varrezë hebrenjësh me yllin e Davidit. *Më parë se të hapej ambasada izraelite në Prishtinë, beteja për të mbrojtur një varrezë* hebrenjësh, nuk i shpëton vëmendjes së poetit. Kur regjimi i Milosheviçit kishte nisur spastrimin etnik, genocidin, në Kosovë botohet një libër i Visarit. “Po librin tim me poezi, që e përgatiti Anton Nikë Berisha./më të dhëmbshurin se u botua në Prishtinë./do ma hidhnin në zjarr?”, do shkruajë ai i shqetësuar për fatin e librit, i kërcënuar sërisht nga diktatura.

Kur ti lexon vargjet e një i ish të burgosuri: “Gjithmonë jam me të mundurit./me përpjekjet e tyre/(që afrojnë dritë)./Jam me ta deri në çastin e fitores, pastaj iki, i braktis/dhe bashkohem/me të mundur të tjerë”, beson edhe më shumë tek “balsami shërues” i dhimbjes njerëzore. Mesazhin e kësaj poezia Visari do e kthejë në slogan të fushatës së tij elektorale, si deputet në kryeqytet: “Dua fitore pa të mundur”. I pari, që u bë me të mundurit, ishte Homeri. Edhe pse grek, mbajti anën e trojanëve. Hektori mbetet më i dashur për lexuesin nga Akili, sikurse mbreti Priam më i urtë nga Agamemnoni. Të mundur ishin dhe ushtarët italian, por shqiptarët i strehuan. Natyrisht, që duhet dalluar i munduri nga i dështuari. Dhe të dështuarit janë specialistët e artit, hetuesit dhe gardianët e qelive, përfshini nëse doni edhe një president. Në poezinë kushtuar Ramush Haradinajt, Visari shkruan: “që heronjtë/të bëhen të fajshëm/mjafton mëria e të mundurve.” Kjo mëri të mundurish vazhdon edhe sot me të tjerë luftëtarë të UÇK-ës. Kjo mëri solli Vitin e Mbrapshtë të `97-ës: “Këtej ishte bërë revolucion i mbrapshtë./Qemë mundur të gjithë. S` kishin as miq, as ideale/...Na kishin vjedhur/parat nëpër piramida dhe mumiet gjithandej/qenë pasuruar/...Nuk qetësoheshim dot pa armiq./ndryshe duhej të çmendeshe si kallashnikovët. E grinë qiellin.” Kur zoti ndau tokat, poeti, që kishte mbetur pa gjë, shkoi t` i kërkonte pjesën e vetë. Zoti i thotë: “Ku ishe ti, kur unë po ndaja tokat?” “Në qiell.”-i përgjigjet poeti. “Atëherë duku, kur të ndaj qiellin!” Është ai qiell, që na ndalohej ta sodisnim, ku kubeja e faltoreve u konvertua me kubënë e bunkerëve. Dhe tani, BunkArt.

“Invictus”-latinisht i pamposhtur, titullohet poezia e Uilliam Ernest Henley, të cilin Visari e përktheu në burg. (Minush Jero u fut në burg pasi shkroi dramën “I pamposhturi”). “Nuk paskësh qenë në burg ai, thashë me vete dhe pata një si keqardhje lehtësuese, më mirë. Por, mund të jesh dhe pa qenë, edhe e kundërta, që duke qenë në burg, mund të jesh i lirë, “invictus”. Falë poezisë, kemi më shumë qëndresë brenda vetes për të qenë sa më të lirë. Jo aq shumë heronj, por më shumë njerëz.” Në një vend ateist, ku heroi i pamposhtur ngadhnjente mbi vdekjen, edhe në artin e realizmit socialist kësisoj, “Ngadhnjim mbi vdekjen” titullohet një film, Visari fuqinë e shpirtit ia njuh zotit, që është në qiell. Kur u shkatërruan faltoret bashkë me Visarin shkojmë në kishën e Golemit, e bastisur. Aty morëm ikona të hedhura dhe fshehurazi, sikur të ishin vjedhës ikonash, në fakt, po i shpëtonim ato, i fshehëm në bahçen time. Nuk di kush na kishte spiunuar në shkollë, mësuesi i historisë na detyron t` i dorëzonim. I kthym shenjtorët, të cilët mësuesi i kaloi një e nga një në sqepar dhe i hodhi në sobë. Më kujtohet kjo histori sa herë që shoh foto të Visarit me Papët. Altari i rrënuar i atdheut ofron: “Ne, që e deshëm atdheun aq shumë./na deshi më pak/dhe mbetëm të varfër./Ne, që u munduam për atdheun/që na mundoi aq shumë./mbajtëm kryqin e tij mbi kurriz/mbi të përpjetat e fatit.” Ndaj: “Bijtë e mi./kërkoj ndjesë për këtë atdhe të ashpër/dhe të padrejtë.” Në një emision televiziv ndiqja një mjeshtër çiftelie, i cili këshillonte se druri i përshtatshëm për çifteli, duhet zgjedhur nga ajo anë e pemës, që s` e kanë rrahur erërat. Besoj se këtë kusht e kam plotësuar.

KORRIGJIMET E QIELLIT

Cikël poetik nga Anton Pappleka

JETA QË NUK E KAM JETUAR

Kush do ta jetojë jetën
Që nuk munda ta jetoja
Ose që nuk dita ta jetoja?

Në ç'pikë të gjithësisë ka shkuar
Ajo jetë?

A mos ka vdekur
E mbyllur në një sarkofag guri
Në një arkivol plumbi?

A mos është ruajtur diku
Në arkiva misterioze
Si një projekt i dështuar?

A mos është mbyllur
Në ndonjë frigorifer special
Me qëllim që të çakullohet e të ngjallet
Për t'u përdorur sërish
Si një organ i transplantueshëm?

Njeriu që do ta jetojë
Jetën që më ka munguar
A do të mendojë për mua
A do të përpiqet të më përfytyrojë?

Ndoshta jeta
Që nuk munda ta jetoja
Ose nuk dita ta jetoja
Do të vazhdojë për shumë kohë
Të kërkojë një njeri tjetër
Që më në fund do të arrijë ta jetojë...

Qendra Georges Pompidou, 30.6.2021

KORRIGJIMET E QIELLIT

Edhe qiellit i vjen të pëlcase
Nga të qenët tërë kohën
Një qiell i kthjellët e i zbrazët

Për këtë arsye
Herë pas here ai mbushet
Me re me vetëtima
Me shira ose me borë
Me tufa zogjsh shtegtarë

Për të populluar plotësisht
Njerëzit e lashtë shpikën
Bestiarin e yjeve
Fisin me flatra të engjëjve
Qilimat fluturues

Njerëzit modernë
I shtuan qiellit
Shpikjet e tyre të veçanta
Avionët
Satelitët
Dhe anijet kozmike

Vetëm falë këtyre korrigjimeve
Që iu bënë qiellit të kryehershëm
Tërësisht i kaltër e i zbrazët
Qielli u bë kompleks e i larmishëm
Si tabloja e përkyer e një piktori
Ku nuk mungojnë dritëhijet
Dhe as paleta më e vogël...

Paris, 6.7.2021

UBI SUNT...

Pjetër Budit që e trajtoi i pari këtë motiv
të letërsisë latine

Ubi sunt lulet
Që disa javë më parë
Më kanë mahnitur?

Ato janë zhdukur
Si t'i kishte përpirë dheu
Që i kishte nxjerrë në dritë

Nuk ka asgjë për t'u habitur
Nga zhdukja e këtyre luleve
Një zë i brendshëm më pëshpëriti
Edhe ti që ecën midis këtyre drurëve
Do të kesh të njëjtin fat si lulet

Resht së përsërituri si papagall
Sintagmën e pakuptimtë:
Ubi sunt?...Ubi sunt?...

Gjithçka që zhduket
Kthehet atje nga ka ardhur

Kur zhduken lulet
Është e kotë keqardhja

Toka do të nxjerrë lule të reja...

Bois de Boulogne, 29.6.2021

1.Ubi sunt: ku janë

VEZIRI I YJEVE

Omari tha me zë të lartë:"Lermë me yjtë e mi!"
Amin Maalouf

Kur nuk e pranoi postin e vezirit
Të një perandorie të gjerë
Omar Khajami tha:
"Lermë me yjtë e mi!"

Në vend të pallatit të vezirit
Ai parapëlqeu observatorin e astronomit

Ata që u habitën nga mospranimi i poetit
Nuk mund ta kuptonin
Se perandoria e yjve
Ishte më e gjerë e më jetëgjatë
Se të gjitha perandoritë tokësore...

Paris, 3.7.2021



HESHTJA E PANDEMISË

Unë jam heshtja e pandemisë
Një heshtje e plotë
Unë dua ta shtrëngoј me duart e mia të çelikta
Gurmazin e botës
Unë dua t'i mbyт të gjithë tingujt
Ngado që të vijnë
Unë dua të mbretëroj
Si një sundimtar absolut
Si një diktator i një regjimi totalitar
Mbi të gjitha qeniet e gjalla
Unë dua të imponoj kudo pushtetin tim
Të mos lë të dëgjohet asnjë fjalë
Pikë
Asnjë zë
Pikë
Asnjë zhurmë
Pikë
Që mund t'i kundërvihet
Shurdhërisë sime
Pikë
Unë dua të jem
Sundimtari i vetëm i botës
Unë heshtja e pandemisë
Nj heshtje plotë
Pikë Pikë Pikë...

Paris 7.3.2021

E KAM ZILI...

E kam zili fëmijën që vraponte nëpër muzg
Duke mbajtur në ballë dritën e xixëllonjave
Fëmijën që shpresonte të kapte fluturat me dorë
Fëmijën që bridhte nëpër pyje me veshët pipëz
Për të dëgjuar nga larg thirrjet e Zanave
Djaloshin që bëhej gati të shkonte në takimin e parë
Që ende nuk i kishte dhënë një puthje të dashurës
E kam zili atë që e lajmërojnë për herë të parë
Se është bërë babai i një foshnje të sapolindur
Atë që mund të thotë:"Do të shkoj te nëna"
Atë që ëndëron të botojë librin e tij të parë
Atë që lexon një libër të ndaluar nga censura
Atë që lexon një libër të trashë pa syze
Atë që i ngjit shkallët dy nga dy
Atë që ecën me vrap në një shteg pylli
Atë që nuk ndien në trup ndonjë dhimbje
Atë që nuk mendon ende për vdekjen...
Këto gjëra janë të ndaluara për mua
Në jetë të jetëve

Paris, 30.6.2021

NJË MOLLË

Dy bashkëshortë të moshuar
Kafshonin me radhë një mollë

Ata e kafshonin sa mundeshin
Sikur ajo mollë të qe jeta e tyre e përbashkët

Ata e kafshonin deri te farat
Sikur ajo mollë të qe dashuria e tyre

Për ta ajo renetë e verdhë ishte
Një mollë e këputur në kopshtin e Hesperideve

Duke bërë atë gjest të zakonshëm
Ata ringjallnin mitet që lidhen me mollën

Ata aktualizonin metamorfozat e të dashuruarve
Të shndërruar në trëndafila a në drurë

Duke kafshuar mollën atë vërenin atë që mbetej
Për t'i lënë tjetrit kafshatën e fundit

Ai frut ku ata kafshonin sa mundeshin
Ishte zemra e tyre e shndërruar në mollë

Ishte dielli i asaj dite vere
Që ata e ndanin me njëri-tjetrin...

Aeroporti i Beauvais-së, 7.7.2021

KTHIMI I PËRJETSHËM

*Tregim nga
Artur Spanjoli*



Nuk e mbaj mend mirë nëse flija apo isha zgjuar. Gjithçka shpëstillej në një vorbull të pavërtetë por në të njëjtën kohë, gjithçka ishte aq e vërtetë dhe e bukur. Dukej sikur mbas çdo mbyllje qepallash gjithçka ndryshonte në çast, dhe aty ku kishte dritë, hapej një hon i frikshëm. “Ku jam?!” mendoja. E dija që doja të shkoja dikund. Do të merrja diçka dhe do t’ia jepja të zotit. Si nëpër mjergull, diçka më vinte ndër mend. Ose thjeshtë kujtesa, bënte një nga ato xhirot në ndërgjegjen time të fjetur. Pastaj, fill, sikur përgjigjja të kishte ardhur nga fundet e vetvetes, u rishfaq.

Isha atje, në fshatin e fëmijërisë. Isha poshtë një plepi i cili fësh-fërinte mistershëm, me një zhurmë e cila sikur vinte nga kohërat e largëta. Gjethnaja me shushurimën e mbas ditës sëç thoshte. Pak nga pak e kuptova se nuk ishte veç zhurma që era prodhonte duke depërtuar mijëra gjethet e gjelbra të plepit. Ato zhurma ishin zëra. Zëra të largët të cilët tani, ringjallur nga flladi i ngrohtë veror, bashkë me aromën e fortë të limfës, sillnin edhe zërat e humbur të epokave. Pëshpëritnin emra, fjalë, ndjenja.

Përreth, pafundësia e tokave me liqenin tutje, gjelbërimi veror, pemët, ullinjë, mugëtira e ngrohtë e stinës, ajri që ziente nga dielli zhuritës nuk do të ishte asgjë pa atë heshtje aq të shenjtë. Ishte një heshtje tjetërlloj. Heshtja e qelqtë dhe gazmore në pritje të diçkaje të bukur. Se ç’ish kjo diçkaja e bukur as nuk e dija fare. Thellë-thellë, ndoshta as nuk doja ta dija. Hidhja sytë përreth me një kurjozitet që rritej. Por bashkë me kuriozitetin rritej edhe një ndjesi gazi dhe lumturie. Pak nga pak, si intensiteti i muzikës kur ngremë volumnin e tingujve që na emocionojnë. Ç’bëj këtu? Nuk e kuptoja as edhe gjendjen time. Isha i madh, sepse mendimet i kisha të thella dhe pyetjet prej të rrituri, por ndjehesha edhe i vogël sepse harenë dhe gazin e kisha prej fëmije. Gjithçka tek fëmijët është e pastër dhe e pafajshme, sidomos emocionet lidhur me lodrat. Më kujtohet, më shumë lumturohesha kur shkonim me familjen në plazh apo tek nëndaja të shtunave, sesa kur na blinin një gurabije apo na falnin pesë lekë. Pranë meje, një aromë e fortë toke e sapo punuar, përzihet me atë të barit të sapo korrur.

Nuk ka aromë më të forte se ajo e barishteve të cilat kur i këput i çon pranë hundës dhe i nuhat fort. Era e fortë e limfës së gjelbër, lëngu i trashë dhe i bardhë i mbush mushkëritë. Pranë meje, mes plepit shushuritës dhe gardhit të madh shoh lulet e zjarrit, mëllagat e egra dhe lloj-lloj gjethurishtesh kacavjerrëse si kaçube. Ferra dhe manaferra. Kur ishim të vegjël gjatë gjithë zhegut të vapës, me Gonin dhe Tanin shkonim për manaferra. Tani e di që jam i madh, por kam në gjoks të njëjtën dëshirë përvëluese ta mbush qesen me manaferra plot lëng vishnje. Ku jam pra? Po shoh ëndërr apo po e jetoj me të vërtetë?! Rri ulur nën hijen e plepit, dhe tani, një aromë e ngrohtë baj-gash të thara në diell vjen lehtëzi në ajrin përvëlues. Pak më tutje shoh dy lopë, të cilat poshtë hijes së ullirit mbllaçiten në heshtje. “Nuk ishin që parë!” them me vete. “Nuk ishin të betohem! Përndryshe do t’i kisha parë!” Tutje, duket kodra e shtufit, e gërryer nga shirat e shekujve, dhe pak me tej është lugina në tatëpjetën. Akoma me poshtë vezullonjë në ujërat e mbas ditës së liqenit. Liqeni i vogël tani është me i gjerë, gati i pafund me miliona flutura drite që vezullojnë nën heshtjen e ngrohtë të mbas ditës. Kënga e gjinkallave nuk rresht dhe nxehtësia është e këndshme. Është një vapë që nuk dërron. Është një nxehtësi flladi plot parfum, një nxehtësi që duket sikur depërton në shpirt dhe e rrit forcën e haresë. Një hare e paimagjinueshme, sikur sytë e mi, të dehur nga bukuria, të mahniteshin krejt nga drita e cila vezullonte nëpër ngjyra. “E mora vesh ku jam!” mendova. “Jam fëmijë. Jam atje. Jashtë gardhit të madh të shtëpisë në fshat. Përtej baçes. Tek rrugica e vogël plot tokë të rrahur, të cilën, familjarët, duke e bërë përditë në këmbë ja kanë mohuar dheut të drejtën të mbijë bari. Pluhuri i athët tani rri përmbys por po ta prek me majën e këpucës ai do të ngrihet!” Kafshët janë akoma nën hijen shekullore të ullinjve të sheshit. Ullinjët e Cenit të Teqes, mendoj në çast. E di mirë se po t’i bie përqark gardhit të madh me ferra, plot gjemba, lule zjarri dhe lule maji, do të zbres poshtë duke ecur gjithmonë nga e majta deri sa të arrij tek pusi, poshtë shtëpisë dykatëshe. Stinën e kuptoj, është verë, por nuk kuptoj ç’moshë kam?! Po të isha akoma fëmijë atëherë, në zhegun e vapës, lja do të ma kishte ndaluar bredhjen vetëm nëpër ferra, ku shpesh, gjarpërinjtë, të mbledhur kulaç, flinin të qetë pas dreke. Gjarpërinjtë ishin tmerri i të mëdhenjve. Edhe pse kishim dy infermiere në shtëpi, tezen dhe Dejen, prapë të mëdhenjtë i ruheshin kafshimit plot helm të nepërkave, të cilat, nuk e di pse, në fëmijë, sapo i pikasnim, mundoheshim t’i vrisnim me gurë.

U gjenda tek ecja gjithmonë nga e majta. Habia shtoej dhe nga e djathta, kaloi një flutur e shtëmadhe. Me krahë të shndritshëm blu turkeze dhe me disa njolla violeti të cilat vezullonin. Tek fluturonte linte pas vetes, disa grimca drite të cilat si xixëllima mahnitëse shuheshin pak nga pak si ëndrra mëngjesore. I habitur krejt mbeta gati pa frymë. “Si ka mundësi?!” mendoja. “Fluturat nuk janë kur-

rë kaq të mëdha dhe të bukura!” Prapë një dyshim i çuditshëm ma mbërtheu ndërgjegjen. I njoh mirë këto insekte. Janë më të vegjël, mendoja i habitur krejt. Nuk kanë kurrë një dritë kaq mahnitëse. E pikasa prapë tek fluturonte si mbi një material të ëndërrt derisa u zhduk përtej gardhit të madh, brenda kopshtit të shtëpisë ku gjenden manat. Tre manat e mëdhenj ishin bërë tashmë si legjenda brenda ndërgjegjes time. Janë, ndoshta, apo nuk janë më?! Nuk arrija t’i shihja ende. Vazhdoja të ecja, dhe përtej ishin plepat e rinj me gjethet aq jeshile sa drita i depërtonte kudo. “Do ta marr topin, mendoja, dhe do t’ia jap prapë djemve!” Tani e kujtoja mirë. Isha aty se i kisha fshehur topin djemve të lagjes. Na e prishnin gjithmonë lojën dhe unë, nga inati, duke folur me Gonin dhe Tanin i kishim fshehur topin e llastikut. Tani, nuk ndjeja më peshën e fajit. Nuk ndjehesha më ai fëmija i cili bën një paudhësi, edhe pse e dija se do shkoja tek vendi ku kisha fshehur topin e më të mëdhenjve. Zakonisht ata loznin mbrapa shkollës, me porta të vogla. Aty mes varrezave të vjetra dhe shkollës, ishte një copë tokë katrore ku shpesh, daja së bashku me Fajen, dy mësuesit e fshatit, bënin orën e gjimnastikës. Por kur djemtë si Beni e Titi apo Ridi loznin përpara oborrit, atëherë na largonin me shkelma.

Të mërzhitur e mbanim frymën poshtë tek kanali i ujit vaditës, ku pompa e fuqishme, mbasi sillte ujin sipër nga liqeni, e shpërndante nëpërmjet kanaleve duke vaditur tokat mbi kodër. “Ju s’na lini?! Jua tregojmë ne!” kishim menduar, dhe i kishim fshehur topin. Tani e dija se po shkoja drejt vendit të dikurshëm ku e kisha fshehur shekuj më parë ndoshta, duke u betuar mos t’ia jepja më kurrë. Por çuditërisht gjithçka ishte aq ndryshe. Trupin e kisha të një të rrituri, edhe mendimet vazhdonin të bënin pyetje të thella ekzistenciale, por kisha në shpirt të njëjtën mani fëmijërore. Të njëjtin gaz plot dritë shprehur tek sytë, kur Lala, pasi lodhej për orë të tëra tek qoshja e tij, më sajonte nga asgjëja një lodër druri. Preferoja makinat dhe karrocet. “Ç’është kjo punë?” i thosha vetes, tek i mahnitur krejt, ndërsa ecja, poshtë kodrës, nga krahu verior i baçes së madhe në kodër, mes gjelbërimit veror, lulet bëheshin gjithnjë e më të shndritshme. Bashkë me flladin plot parfum, një fllad me ajër të pastër natyre, vinin si nga fundet e ndërgjegjes edhe copëza të harruara jete. Copëza jete të cilat njeriu nuk i humb kurrë. Veçse ne, i ngucim, i zhysim thellë nëpër kthinat të errëta ndërgjegjes dhe aty rrinë plot pluhur, edhe për tetëdhjetë vjet rresht. Asgjë nuk harrohet, po qe filtruar fort në dashurinë e dikurshme.

Gjinkallat vazhdonin të çmendeshin kapur mbi trungje pemësh. Turtulleshat këndonin poshtë degëve të kumbullës. Ajri kishte parfumin e pemëve të gjalla. Heshtja fliste vërtetë me gjuhën e përjetësisë. Qielli mbyste gjithçka me blunë e tij të qeshur. “Arti, eja sipër!” dëgjova një zë. Ishte një zë që e njihja mirë. Një zë nëne plot dashuri. Një zë që e kisha dëgjuar po aq shumë sa ai i nënës time!” Ktheva kokën por heshtja sundonte akoma atë mbas dite vere. Përtej, nëpër fushën me grurë, një e verdhë e pjekur, pa fund, me lulëkuqet delikate, përkëdhelej ëmbël nga flladi i mbas ditës. Shushurima zgjonte një si mallëngjim brenda meje. Sa më shumë kalonte koha, aq më shumë ndjesia e lumturisë rritej brenda. Pusi me kumbullën e verdhë ishte i njëjtë, ashtu si kujtesa e kishte ruajtur. Si diçka të vyer dhe të shtrenjtë, veçse tani gjithçka dukej aq e vogël. Më kujtohet, atëherë, duhej të ngrija këmbët për të parë poshtë tek ujërat e zinj të pusit, me hijen e kokës time të errët përmbys. Shpesh hidhja ndonjë guricë dhe rrathët e vegjël që hapeshin në ujin e mugët të pusit e copëtonin siluetën time në dhjetëra fragmente. Ajo gjendje më ngjallte tmerr edhe kuriozitet. “Mos iu afro pusit!” ma përsërisnin pa pushim. “Aty del kecka dhe të han!”

Ndërsa tani, çuditërisht ai ishte zvogëluar aq shumë. Iu ngjita rrugicës plot fiera dhe kaçube dhe barishte ku ishin dardhat dhe nuk po e kuptoja nëse zërin e ëmbël e kishte prodhuar ndërgjegjja ime, apo me të vërtetë e kisha dëgjuar atë. Një zë i cili vinte fill dhe nga fëmijëria?! Tek ngjitesha, spostohesha si nëpër gjendje shpirtërore. Më dukej sikur fluturoja, aq e lehtë dhe madhështore ishte gjithçka. Atëherë pikasa shtëpinë. E dija. Diku, groposur tërë mllaf, rrinte topi i futbollit. Atë top e kishin kërkuar gjithkund vite përpara, por nuk e kishin gjetur kurrë. Atëherë shtëpia dykatëshe u shfaq me tërë madhësitë e saj fëmijërore. Nga krahu i kundërt i diellit, muret e saj të rreshkura nga vitet, me gëlqeren e bardhë, gurët dhe shtresat e dërrasave për ta ruajtur nga sizmat, tani dukeshin akoma dhe më të bukura. Qoshku i Lalës me tullat e kuqe dhe me verandën poshtë ku rrinin shtambat plot ujë të freskët, tani jetonin në një gjendje përjetësie. Më kujtohet, zhapikët rrinin me orë të tëra pa lëvizur. Dukeshin si të pikturuara nga daja Sami, dhe veç kur i trembja shkisinin plot tmerr përgjatë murit duke u fshehur. Këngë gjinkallash, vapë dhe cicërima zogjsh, gjithkund. Më pëlqente kjo gjendje gazi. Një ndjesi hareje, sikur të kisha gjetur vetë origjinën e gjërave. Sikur të kisha gjetur një thesar të cilin e kisha kërkuar aq shumë sa e kisha humbur shpresën se do ta gjeja përsëri. “Sendet kanë shpirt të përjetshëm!”

ndjeva të më fliste një zë mbrapa shpine. U rrëqetha krejt nga emocion. Por ishte një emocion i bukur. Sikur të takoja një njeri të cilin prej vitësh e vitesh e kemi humbur. Ktheva kokën. Ishte Ai. Ishte më i ri nga ç e mbaja mend. Aq i ri, aq i bukur, sa jo vetëm u habita krejt por mbeta si i shtangur. “Ti këtu?!” Ai pohoi me kokë duke buzëqeshur bukur. Kishte flokët e zinj kaçurrel, hundën e madhe të çiallikve, zgavrat e syve kockore dhe vështrimin e tij aq dashur dhe të sinqertë. E njihja mirë atë buzëqeshje me pak shpoti dhe ironi. Një buzëqeshje njeriu plot shpirt. Nuk po kuptoja asgjë.

“Nuk kuptoj asgjë!” Thashë i mrekulluar krejt nga vizioni.

“Gjërat kanë frymë të përjetshme!” tha.

Pastaj nuk foli më. Rrinte dhe më shikonte përmallshëm.

“Ishte zëri i Ijes ai që parë?” e pyeta.

Ai buzëqeshi prapë, por nuk fliste më. E habitshmja ishte se përveçse ishte më i bukur dhe më i ri, por kur shprehej nuk lëvizte gojën por fjalët, si një fluks kozmik futeshin drejt për drejt në ndërgjegjen time. Pa mund, sikur edhe unë vetë të isha pjesë shpirtëzuese e sendeve, e pemës, e ajrit. Sikur të isha pjesë e energjisë së shpirtave të kushërinjve që ishin dhe që nuk ishin më. Sikur të jetoja një dimension hyjnor ku i gjithë fisi ndoshta kishte arritur tashmë.

Ngrita kokën. Furia e dritës, ishte aq e madhe, sa tejshkonte materien. Një materie e çuditshme sepse edhe pse unë e shihja shtëpinë dykatëshe të Likeshit me të gjitha detajet e saj të mundshme. Të kthjellët dhe të plotë siç mund ta ruaj kujtesa e freskët e një pesë vjeçari. Me dritaret e vogla veriore, me gardhin pranë burgut të lopës, me kolonat e tullave poshtë derës kryesore, me trëndafilat erëmirë dhe me trinën tutje, ku stolat e drunjtit poshtë lules së xhamisë ndriçonin si në gusht, prapë me sytë e mi shihja edhe gjëra përtej materies. Arrija të shihja edhe ç’bëhej brenda shtëpisë.

Një potpuri fëmijërie vinte nga një radio e ndezur diku. Ajri kishte shpirt, si një frymë engjëlli. Bukuria ishte e hatashme. Tashmë malli nuk më grishte aspak. Në vend të mallit, ndjeja një gaz. I kisha sytë plot dritë hareje dhe zemra më gufonte sikur do të takoja gjithçka që kurrë në jetë nuk e kisha parë. Veç se e kisha ëndërruar me zjarr. Me zjarrin e një artisti.

“Pra çelësi është tek respekti për jetën?!” Iu drejtova prap dajës, edhe pse më mjaftonte ajo pamje. Më mjaftonte që isha aty. Më mjaftonte të mrekullohesha nga ajo dritë e purifikuar, si një kujtim i shtrenjtë i cili, mbas shumë vitësh, brenda nesh, merr vlerën e një thesari të vërtetë.

“Gjithçka është e vërtetë këtu?!” pyesja veten. Dhe përgjigja vinte po vetvetiu. Si nga fundet e ndërgjegjes. Sikur të kisha mundësinë të komunikoj me vetë kozmosin. “Sa më shumë ta besosh, aq më shumë ajo bëhet e vërtetë! Siç bëhet e vërtetë një ëndërr për të cilën ke besuar dhe luftuar tërë jetën!”

Kjo gjendje kaq e kristaltë, plot flutura të shndritshme, qiej plot zjarr pasioni dhe natyrë mrekullore, kishte nevojë për një rritje shpirtërore. Duhej medoemos, të çrrënjoseshin nga ndërgjegjja gjithçka e dëmshme që materia na e fuste në shpirt duke na e katranosur keq e më keq ndërgjegjen.

Ktheva kokën por dajua nuk ishte më. Pak më tutje pikasa gjyshen. Ishte aq e re dhe e bukur sa gati-gati, pyeta veten si ka mundësi që unë, nipi të isha rritur aq shpejt. Isha gati më i vjetër se ajo vetë edhe pse dëlirësinë dhe gazin vazhdoja ta kisha akoma prej fëmije të vogël pesëvjeçar.

Po mblidhte trëndafilat rreth e qark baçes. I këpuste me një gërshërë dhe me kujdes i mblidhte mbi një çarçaf të bardhë.

Sapo puhiza e ngrohtë dhe shushuritëse u ngrit, atëherë ajri vezulloi papritur si një pluhur i floritë, sikur të ishte ndriçuar në çast nga një shpirt i padukshëm. Poshtë degëve kumuriat këndonin të dashuruara.

“Sa bukur këtu!” klitha dhe kisha në shpirt si një lumë drite. Ishte kjo vallë lumturia? Një lumë drite që të vërshon në gjoks. Kjo ndjesi kaq e lehtë, si hija e një barke mbi ujërat e kthjellët, si ajri transparent kur prek lëkurën. Të jetë vallë kjo lumturia e qenies, kur nga drita, gjithçka zhbëhet, ndizet me një entuziazëm ëndrrë dhe si drita pra, mund të gjendesh gjithkund. “Ije!” mëmërita. Ajo u kthye. Ishin të njëjtët sy kaf të dikurshëm. Sy të vegjël, të zgjuar por edhe të përmbajtur. Sy të dëlirë nëne e cila me dhjetë fëmijë për të rritur, jeta i kishte mësuar aq shumë gjëra. Më buzëqeshi. Nga bebet e saj u ndez një dritë pak ironike, si një shpoti, kur tallej pa të keq me ndonjë përgjigje të pakujdesshme. “Ije!” i thashë dhe u mbusha prapë me një entuziazëm të paparë. “Sa e bukur je!” i thashë. Ajo buzëqeshi prapë. Një mirësi të cilën e njihja mirë ia ndriçoi tiparet. “Këtu zbukurohem i të gjithë!” mu përgjigj. Prapa saj trëndafilat skuqeshin aq shumë sa nuk arrije t’ia hijqe dot sytë, nga hijesia pa fund.

“A ekziston ky vend?!” e pyeta.

E pashë të buzëqeshje prapë me atë ironinë e saj të përmbajtur poshtë syve të vegjël kaf. Mbante akoma mbi krye napën e bardhë siç e mbajnë nënat tona nëpër fshatra, veç se ishte më e re dhe më e bukur. Buzëqeshi duke lëvizur kokën.

Atëherë ajo e hoqi vështrimin nga mua. Pa drejt qiellit dhe u habita sepse nuk e kisha parë kurrë më të bukur se në atë çast. Pastaj u shpreh prapë me sytë e saj të ëmbël dhe plot dashuri. “Duaji njerëzit, ji vetvetja, ndiq të vërtetën!” pëshpëriti gjithçka. U mbusha ma këto fjalë. Gjithçka futej brenda ndërgjegjes time mrekullisht. Si në një botë ëndrrë, ku çdo gjë ishte më e vërtetë se e vërteta vetë.

Pastaj ktheva pak kokën dhe pashë pëllumbat e shtëpisë të cilët gugatnin brenda kafazit. Pastaj dikush hodhi një grusht kokrrash misri mbi tokën e rrahur dhe atëherë me një zhurmë flatrash plot dritë dolën me ngut dhe filluan të çukisnin kokrrat e misrit. Ndihej një si muzikë në ajër. Nuk ishte një tingull të cilit mund t’i përcaktohej instrumenti. Ishte një muzikë e cila përhapej në ajër me aq kujdes, me aq delikatesë, me aq bukurie sa zgjonte në shpirt një kënaqësi të paparë. “Dashuria!” mendova në çast. “Ç’ mrekulli!” Heshtja ishte e kristaltë. Zemra lodronte si fëmijë. Ku isha? Ç’bëja aty? Pse? A ishte gjithçka fryt i thjeshtë i ndërgjegjes time? Kur e kujtoj, rri në heshtje dhe mendohem. *Aeternae vicissitudinis*. Të jetë vallë kthimi i përjetshëm, e vetmja filozofi e jetës?!

“Të gjithë i shohin mbishkrimet në mur, por askush nuk mendon se janë shkruar për të!”

MBISHKRIMI NË MUR

(Një letër përtej kohës)

Nga Pol Milo

Petraqi ecte me hapa të ngadaltë. Në çantë mbante gjithnjë një palë syze dhe dy-tri libra të tij të punës. Në ato libra gjendeshin gjithnjë studime, informacione dhe pjesë-pjesë të një dije në proces, ende të paplotësuar tërësisht. Ndërsa pjesa kryesore ishte e dhënë midis rreshtave të librave që mbante. Madje shumë prej tyre ishin të nënvizuara dhe të shënuara me mbishkrime anash. Gjuha me të cilën shkruante ishte e rregullt dhe e kuptueshme. Kurse mendimet në kokë ishin të turbullta, të çrregullta e të pakuptueshme. Këto pakuptueshmëri në kokën e tij kishin ardhur pjesërisht nga dija që mbante duke zbuluar dhe studiuar, por pjesërisht edhe nga ajo e pazbuluara ende. Madje kjo e turbullonte akoma më tepër kokën e tij.

- Ç'paska qenë kjo ditë! - tha me vete - Ç'gjëra të çuditshme më duhet të mendoj. Më duhet të rikujtoj e të rikthehem edhe një herë. Të eci e të riei, por prapë një gjë spo e kujtoj.

Është një mendim i rëndë si një gur. Nuk është gur varri, si titulli i librit që kishte në çantë, por një gur i lashtë.

Gur mistik, do ta kishte quajtur, gur misterioz, si ata të rrënojave në themelet e kishave mesjetare, që dinë të ruajnë gjithçka që kanë parë, por që nuk i tregojnë, sado e madhe të jetë shtrëngata e lumenjve që kërkon ti zbërthejë, ti shpërbëjë, këta kriptogramë të universit përhapës. Jo vetëm përhapës si zgjerim fizik, por edhe përhapës të mendimit, të një mendimi herë të qartë si diamant dhe herë të turbullt si karbon. I errët, siç ishte edhe ky mendim që shtypte në kokën e tij, si një gur mulliri, elbin e mendimit, ndërkohë që mendohej të mblidhte esencën.

Në fakt këtu nuk bëhej fjalë për asnjë gur. Nuk kishte fare gur. Këtu bëhej fjalë për një libër. Dhe për një letër. Për një letër brenda në libër.

Një letër e vjetër, e lashtë, në mes të një libri po aq të vjetër, që atij nuk i'u kujtonte se si e kishte gjetur pranë një muri të rrënuar bizantin, në një qytet po aq të rrënuar. Letra ishte shkruar për të nga një mik që as nuk i'u kujtonte fare ta kishte mik. Nuk i'u kujtonte ta kishte takuar ndonjëherë. Kishte pyetur vërdallë, por një emër i tillë nuk ekzistonte në qytet.

Për më tepër nuk e kuptonte se përse një letër e tillë, nga një emër që nuk ekzistonte, duhej të ndodhej brenda një libri që nuk e dinte se përse ekzistonte, apo ndoshta nuk ekzistonte! As këtë nuk dinte ta shpjegonte.

Një rreze drite përshkruante qiellin e kaltër duke shkëlqyer mbi sipërfaqen e detit, i cili e shpërbëri atë në qindra vegime vezulluese.

- Njësoj si ky mister - mendoi Petraqi - që vetëm duke e shpërbërë në qindra apo mijëra pjesë, mund ta zbërthesh, copë pas cope, pjesë pas pjese, si një zbulim arkeologjik mendor, duke e analizuar siç mund të analizosh çdo kuant të dritës, për të marrë mesazhet që vijnë andej nga botët e largëta të Zotit univers.

Ky mesazh kishte mbërritur tashmë. Ai mbante në dorë letrën dhe bashkë me të, edhe mesazhin e saj, të cilin kishte mundur ta zbërthente.

Megjithëse dukej të vinte nga një botë e largët, ajo ishte reale. E shkruar në një gjuhë të vështirë dhe të pakohë, ajo kishte freskinë e mendimit dhe rrjedhën e kuptimit aq të qartë, saqë dukej e shkruar si në këtë kohë.

Apo në atë kohë!? Në çilën kohë?

Nganjëherë edhe kjo kohë edhe ajo kohë duket sikur janë e njëjta kohë. Gjërat ngelin të pandryshuara për qindra apo mijëra vjet dhe njëkohësisht ndryshojnë me shpejtësinë e sekondave. Këto ndryshime të dukshme dhe të kapshme të shpejtësisë së sekondave, ndodh që i hedhë poshtë vetë pandryshueshmëria e gjatë e kohës. Duket gjithashtu sikur ke qindra apo mijëra vjet që ecën, e në të vërtetë vetëm sorollatesh në një vend. Aty zbulon se nuk ke bërë asnjë hap, as para dhe as pas.

Ja, kështu u ndjente miku Petraq nga e gjithë kjo histori fluturuese dhe turbulluese, në mendjen e tij që punonte vazhdimisht, si guri rrotullues i mullirit. Ai e quajti atë letër pa kohë, pasi i tillë ishte mesazhi i saj, i shkruar për të, që nga përtej kohës.

Në letër shkruhej:

“I dashur miku im Petraq!

Tani jam ulur mes hije pishash shekullore ku melodi tokësore godasin ndërgjegjjen tonë mëshirë plotë. Hija që ato krijojnë qenka e bekuar. Është e bekuar sepse fillimisht ato përthithin nxehtësinë



dhe dhurojnë freskinë por është e bekuar sepse ato dhurojnë mjedisin e kulluar për të krijuar mendimin e përshtatshëm. Mendimi i përshtatshëm e ka munduar njeriun shekullor. Por jo pishën shekullore. As bredhin. As rrapin e lisin. Ndërsa njeriu qëndron në hijen e tyre i dobët. Mjaft i dobët.

Dikur shkruaja diçka për një njeri të lashtë nga Iliria, që koha e ngurtësoi dhe e transformoi në një shkëmb, për një qëllim të vetëm. Kërkimin e së vërtetës. Dhe unë e quajta atë njeriu shkëmb. Ai u detyrua të ngurtësohej për të zbutur ndërgjegjen. Ndërgjegjja e tij ishte dhuratë nga fisi i tij i lashtë, barbar dhe i egër. I duhej të sakrifikonte shumë. Për këtë fis patjetër që ishte e nevojshme prania e sakrificës. Nuk mund të ketë zbutje të durimit pa sakrificë. Sot, çdo shkëmb i ngurtë është një ndërgjegje ende e pa zbutur, një e vërtetë ende e pazbuluar.

E vërteta iu fsheh, ndaj ai u detyrua të qëndronte i vetmuar mbi brigje detesh në pritje të saj. E vërteta vjen tek njeriu, nuk shkon njeriu tek e vërteta. Njeriu është pjesë e gënjeshtrës, është pjesë e mashtrimit të madh.


E vërteta vjen tek njeriu nëpërmjet zbutjes së ndërgjegjjes dhe zhvillimit të arsytimit. Dikur këtë sfidë e kishin kaluar dhe dinozaurët që kishin jetuar disa qindra mijëvjeçarë më parë. Kjo pjesë e historisë ishte shkruar nëpër libra dhe kishte qarkulluar me mjaft interes.

Para disa kohësh lexova edhe një libër me vizionarë dhe orakuj që e kishin parashikuar këtë riciklim. Por mesazhi duhej deshifruar përtej rreshtave. Ishte e destinuar të shkruhej në një gjuhë ndryshe, një gjuhë tjetër lloj. As në një gjuhë të lashtë dhe të shkruar më parë, por as në një gjuhë të re dhe të kuptueshme. Për këtë, vizionarët dhe orakujt, zgjodhën me mjaft kujdes, një gjuhë të ndërmjetme ose mesianike, siç e quanin disa gjuhologë që ishin marrë thellësisht me rolin e saj, edhe pse teza e tyre nuk u vërtetua kurrë shkencërisht. Ku ishte gabimi!? Ajo ishte e destinuar të ishte e tillë, pasi mesazhi duhet të ruhej pikërisht kështu. Kjo nuk ishte aspak rastësi.

Eci nëpër rrugica të ngushta ku porta me harqe hapen dhe rreze drite burojnë përtej dërrasave të vjetra mbuluar me myshqe dhe bimë kacavjerrëse.

Tregtarët kishin zbrazur forumin e tyre dymijvjeçar duke lënë kolonat e rrumbullakëta në heshtje të rëndë, si hija që mbanin. Atje nuk gjeje më as amforat me verë as tavernat me ushqime dhe as arkat plot me frutat të freskëta mesdhetare me lëngun e tyre të ëmbël e marramendës, që dikur na trullosnin e na bënë të kërcenim vallot e mëdha, deri sa gjunjët mos të mbanin më trupat e dehur nga eliksiri i dhuratave të natyrës.

Po aty, pikërisht aty, kishte kaluar ajo, vajza e bukur e detit, me flokët e saj të lëshuara si krishtat e pambukta me gjerdanin e saj koralor që shkëlqente. Këmbët e saj të lehta duket sikur rrëshqisnin mbi gurët e lëmuar të rrugicave, derisa humbiste duke lënë pas imazhin e saj dehës. Ky imazh nuk humbi, as nuk u vanit, të paktën këto shekujt e fundit por u kthye në



këngë sirenash të cilën e përhapnin valët e detit në perëndimet shumëgjyreshe. Këto valë më pas e kishin marrë dhe e kishin çuar atë në çdo cep të brigjeve të thyera, ku përzihej me cicërimat e zogjve. Herën e fundit dëgjova të thuhej se një princeshë e bukur nga lindja e largët luante e pavetëdijshme me lirën e saj, të njëjtën melodi të vajzës së bukur të rrugicave të forumit. Thuhej se ishte rastësi, por ne e dimë mirë që nuk ka gjëra të rastësishme.

E kërkova të ma kthenin atë imazh, por pikërisht te ajo porta e drunjtë shekuj më pas takova plakun e urtë. Më tha se e kishte dëgjuar këtë histori vite më parë, nga një këngë që e këndonin disa njerëz me karvanë. Ata i kishin dhënë ujë të freskët. I kishin folur në një gjuhë të huaj, të ndryshme, të pakuptueshme. Kur ky i kishte falenderuar në gjuhën e tij, atëherë njëri në fund të karvanit me mjekrën e bardhë tha se vinte nga jugu. Vetem ai e kuptonte këtë gjuhë.

- Duhet të jesh krenar! - më tha - Me këtë gjuhë kanë folur perënditë.

Më pas më tregoi histori këngësh, më tregoi rrëfenja për luftëra, heronj, varre dhe mbishkrime. Më tregoi për këngët e dashurive dhe të verës, për festat pa mbarim, për lutjet dhe dëshirat, për natyrën dhe paqen, për jetën dhe virtytin, për shenjtorët dhe për parajsën e përtejme.

Në fund më foli për mbishkrimet që kishte gjetur, të gdhëndura mbi gurë dhe mure, për mesazhe që duhej të sillte. Këtë detyrë ja kishin ngarkuar si një mision.

Ai fliste për historinë e një murgu që kishte jetuar këtu shekuj më parë. Këtë histori e kishte zbuluar nga vargjet e një këngë pa rimë, të gdhendur, me një gjuhë me prejardhje të lashtë e të pakuptueshme në ditët e sotme. Por dikur thuhej se kjo gjuhë kishte patur misterin e vet. Ajo nuk shkruhej por vetëm flitej. Disa e kishin interpretuar si një fonetikë me prejardhje hyjnore. Sot, duke qenë se ka një largësi nga gjithçka hyjnore, është ende më e vështirë për ta interpretuar e për të hyrë në brendësi të kuptimit të saj. Kjo është lidhur me diferencimin spiritual.

Thuhej se nëpërmjet këtij komunikimi, një poet i quajtur Daniel Arnaut, nga brigjet perëndimore të gadishullit Ilirik, i paska folur për dritën dhe për këngën e saj, për trishtimin dhe shpresën, Dante Alighieri, dy shekuj përpara se ai të lindte. Po në ç'gjuhë të mistershme i paskësh folur!? Në gjuhën e ferrit a të parajsës!? Ç'shpirot poetik paskëshin trashëguar këto anë të një Ilirie sa luftarake aq dhe pagane!?

Thuhet se ekziston edhe një libër që qarkullon në mënyrë enigmatike nëpër qytetet e Ilirisë ku mund të gjendet bazat e lirikës dhe të gjuhës, kurse figura e tij do të projektohet diku në të ardhmen, në mos qënkësh projektuar në shënime apo afreske të mbetura mbi tempuj. Ndërsa tempujt do vijnë në vuajtje, në mos do të shemben, duke marrë me vete shenjtërinë e tyre. Me shembjen e tyre do të shembet dhe historia.

Këto po vijoja të diskutoja me mikun tim fatmbarë, kur thonim se gjëra të rëndësishme janë zhvilluar përgjatë historisë. Dhe pse është po kjo histori e mbushur me mistere. Kjo histori fsheh mistere. Ajo i mbulon me pluhurin e padukshëm dhe askush nuk arrin ti zbulojë po nuk gjeti çelësin e dobishëm të arsytimit magjik. Këtë ma kishte përmendur disa herë, ti miku im Petraq.

Nëpërmjet arsytimit magjik mund të hysh në brendësi të mendimit hermetik dhe më pas të deshifrosh kodet që mbartin të dhënat e të vërtetës.

Në ëndrrën e lashtë mu shfaq murgu bizantin, ku më shpuri në një mur të vjetër. Fëshfërima e gjetheve aty, ende vijonte të luante melodinë e psalmeve të Shën Astit. Në atë mur trupin e tij e kishin e goditur me gurë, derisa kishte dhënë shpirt.

Në një nga tullat e murit, në një vend që mezi dallohej, lexova të shkruhej:

“Unë Poliandër Mele
Pasardhës Ilirie nga Isidor Mele
Në kujtim vëllai të tij Kostandin, të rënë në luftë,
Varrosur nën tokën e qytetit antik
Deklaroj rimishërimin e shpirtit të tij
Dhe rëndësinë e kësaj zbuluese”

Mikut tim Petraq Bubarit!
Përtej kohës,
Poliandër Mele

Dyrrachium, Iulius MMXXI”
*Pol Milo është autor i librit “Shtegtimi i
dinozaurëve fluturues”

BOTOHET NË GJUHËN MAQEDONASE ROMANI “VALSI I LUMTURISE” I SHKRIMTARIT YLLJET ALIÇKA

Sapo ka dalë në gjuhën maqedonase romani “*Valsi i lumturisë*” i shkrimtarit Ylljet Alicka, Sbotuar nga shtëpia e njohur botuese “MAGOR-Pagoma Press”, përkthyer nga gjuha shqipe nga Fatbardha Shehu.

Me rastin e daljes së këtij romani shtëpia botuese shkruan:

“... Në vazhdimësinë e stilit të tij, ironik, të ndjeshëm e sarkastik, në dukje neutral e i paanshëm, autori rrëfen një histori, ku gjashtë personazhe kryejnë një akt kurajoz, donkishotesk dhe heroik në të njëjtën kohë, për t’ju nënshtuar më pas pashmangshmërisë së fatit të hidhur gri, ashtu si vetë horizonti i izolimit politik e atij njerëzor. Ligësia njerëzore, dinjiteti, ngrohtësia njerëzore, poshtërsia, nënshtrimi apo zotërimi, sipas autorit, shprehen më mirë nëpërmjet elementëve në pamje të paanshëm e butësisht.”

Romani *Valsi i lumturisë* botuar në shqip nga shtëpia botuese *Toena* mbështetet në një ngjarje të vërtetë.

Për botimet e këtij romani në Francë dhe Itali mediat kanë shkruar:

Stefano Pasta *Corriere della sera*: “Qesh hidhur tek lexon këtë roman, e megjithatë qesh.”

Goffredo Fofi, *Internazionale.it*: Një komedi shqiptare alla italiane, një Mario Monicelli, por më shumë acid, gati si Age & Scarpelli i Fellinit”.

Guido Votano *La Repubblica*: “Një rrëfim jashtëzakonisht ironik dhe absurd, i frymëzuar nga një histori e rrallë, ku zbulohen dy botë, gjë e rrallë kjo për romanin tradicional. Është kjo qasje që e bën letërsinë e Alickës origjinale dhe njerëzore”.

Mario Bova, *L’indice*: “Si vepër letrare, *Valsi i lumturisë* i kapërcen fuqishëm kufijtë e një hapësire kombëtare e lokale, për të arritur fuqinë e një reflektimi mbarëeuropian”.

Jean Paul Champseix *EaN (En attendant Nadeau)*: “...atmosferë mbytëse e një regjimi që nuk i ka njohur kurrë krimet e tij, fate njerëzore humbur në anonimatin dhe harresë, Ylljet Alicka ka ditur t’i përshkruajë nën një ironi të distancuar ,me mençuri dhe humorin e tij të zi”.

Në parathënien e botimit të këtij romani në gjuhën frënge Ismail Kadare shkruan ndër të tjera: “...romani vijon një traditë nga më të çmuarat në letrat e sotme shqipe, gërshetimin e tragjikes me groteskun. Vetë rendi komunist, thelbi dhe stili i tij e bënte të natyrshëm këtë tipar të përvetshëm të artit”.



QË SONETI I URAN KOSTRECIT MOS TË MBETET NË HIJE SI VETË JETA E TIJ

Nga Emrije Krosi



Ngjashmëria mes modelit petrarkan të sonetit dhe modelit kostrecian.

Nëse duhet të marim shembullin klasik të shkrimit të sonetit në: “**Mulliri batall**”, forma e vargut është: [abba/abba katrenat dhe cdd/cee], është një adresim “shumë” i saktë i shkrimit të sonetit, ashtu edhe vargimi “pothuaj” korrekt të metrikës:

N’mulli uji, guri e bosh, vërtitet luan...[a] 11
Trokashka rrapëllin me zhurmë ferri...[b] 11
Ai gur, pa drithë, atbot’ miell s’mund të nxjeri [b] 11+(1)
Po bën potere, ama, sikur bluan! [a] 10

Dhe rob’t nga rrena shteti u shurdhuan, [a] 11
Prapagand shteti i fut gjall të dheri... b] 11
Nga dhuna, uria iku hallku e nga tmerr! [b] 11
U lodhnë ata, u raskapitnë, u shuan... [a] 11+(1)

Po teksa aq vuajnë njerzit e ngratë, [c] 12 –(1)
Për turpin e saj, qeveria bën pallë; [d] 11
E s’pyet që hallku ik për të ngel’ gjallë, [d] 12 –(1)

Me ta kjo qeveri bën e gallatë: [c] 11
“Kaq t’mira u prura... - u thot’ - jeni me fat...”[e] 12 -(1)
Po zhurmë u pru si një mulli batall, [e] 11

Dominimi i njëmbëdhjetërokëshit, **regon** se nuk është një “eksperimentim” prej rioshi, por është një *njohje totale* dhe e *thellë* jo vetëm *metrike*, që teston edhe përvojën tashmë të krijuar të autorit. Ka një shprishje të radhës. Në st. 1, v.4 ka [10] por duke shtuar [11+1] nga v.3, kupton se “loja metrike” është e qëllimshme. Ndërtimi dhe forma e “ruajtes” së sonetit, vjen edhe nga “heshtja” dhe *mbyllja* për shumë *kohë në burgje* dhe kampe. Ato *tingëllima*, janë edhe lidhje mesvetes dhe botës së jashtme, mes *heshtjes* dhe *durimit*, mes *zemërimit* dhe *ur-rejtjes*, mes *pafajësisë* dhe *imponimit*, mes *dashurisë* dhe *ur-rejtjes*. Por, në dukje të parë nuk ka lidhje, sepse edhe në vargjet: *desh t’na zhdukte i Burrelit kapter! / Na fuste birucë dimrit ky xhelat: / Na lidhte e rrihte e n’ xhep lejen e pat! / Në shkurt, z bath n’çimento, pa tesha: ç’tmerr / Kur shpirt un gati jepja n’at acar, n’at ferr... / Gardiani shfaqte n’sportel at surrat / E m’thosh: - Kët herë do ngordhç... Se ke t’gjatë! / Dinim, që urdhra operativi ai merr... Të kesh në dorë njëzet (20-të) son-etet modeste dhe të fundme të Uran Kostrecit si: “Cili virus vrau më shumë”, “Helmi i sheqerosur”, “Nata e thikave”, “Gjergj Fishta”, “Mos harro!”, “Gardianët xhahilë të Burgut Burrel”, “Marashi”, “Medet”, “Mos harro!”, “Nata e thikave”, “Gjergj Fishta”, “Një kujtesë komunistëve shqiptarë”, “Tradhëtari i kombi shqiptar”, “Vrau edhe shokët e vet”, “Nga skëterra erdhi një zë”, “Atyre që yllin e kuq duan ende”, “Me sy nga qielli”, “Dardhushkë, Dardhushkë...”, “Gjuha jonë shqipe”, “Paturpësi”, “Mulliri batall”, do të thotë të kalosh sprovat dhe sfidat ndaj së keges sa individuale aq edhe shoqërore, por është dhe një përgjegjësi morale. Sone-ti, vërtet mund të quhet forma poetike më perfekte, si një mundësi që jep për realizim estetik (Krasniqi: 2005), por në një studim të (Milazim Krasniqi) mbi sonetet në letërsinë shqipe, një trajtesë e hollë për (sonetet e Enver Gjergjeku-t), se Kostreci nuk është trajtuar fare (ndoshta i panjohur për studiuesin në atë kohë). Trajtesa të tilla për sonetin mbase si lloj letrar, kërkohet një rreptësi shkencore, që unë nuk e kam, bashkë me dëshirën time dhe po ashtu modestinë e qëmtimit në këtë lëmë, (shën. im, e.k.).*

Uran Kostreci qe i fundmi i mohikanëve, qëndrestari i fundit nga radhët e -ish të burgosurve politikë, të quajtur nga (Visar Zhiti), Kont Urani, besatari që kurrë nuk e braktisi atdheun, apo edhe legjona e qëndresës antikomuniste, sipas (Nebil Çikës), i harruari në vetmi, ashtu si mjeshtri tjetër i lirikës (Frederik Reshpja), pa familje, Kostreci kurrë nuk u ankua, kurrë nuk kërkoj mëshirë, kurrë nuk u përkul para genocidit komunist, kurrë nuk fajsoj askënd për fatkubin dhe vetminë e tij, si qëndrestar, më thënie lapidare: **ata nuk e meritojnë urrejtjen time, unë ata i përbuz!** Një njeri që nuk e thyen as torturat, as provokimet, as burgjet e gjata të komunizmit, një burrë i dhembës, vetmitar, i dashur, i thjeshtë një bohëm i fjalës shqipes sidomos të tingëllimit, ose ndryshe sonetit, një mik i besës për ata që e njohin (fatkeqësisht vetëm njëherë e kam takuar), me atë pamje madhështore por edhe thjeshtore, me cigare në buzë duke shtungulluar bashkë me vitet dhe kujtimet rinore që iu shkërmoqën nëpër telat me gjemba, nëpër kampe pune, me dënime dhe ridënimë, në klavarin e Krishtit në Golgotë, i etur vetëm për liri, ky bard shqiptar i sonetit, jetoj dhe vdiq shpirtlirë.

Së pari të sqarojmë çfarë është soneti. *Soneti* është një lloj i veprës së shkruar letrare. Fjala sonet rrjedh nga fjala italiane «soneto», që do të thotë “këngë e vogël”, (wikipedia). (Nga shekulli 13-të soneti shpjegohet si vjershë lirike prej 14 vargjesh, e ndarë në katër strofa, dy të parat prej katër vargjesh dhe dy të fundit prej tre vargjesh, zakonisht njëmbëdhjetërokësh e me rima të gërshetuara në mënyra të ndryshme; tingëllimë). Soneti në letërsinë evropiane është përhapur falë poezisë italiane, të Françesko Petrarkës. Që në publikimet e sonetit, (Kostreci: 2006) ra në sy, me një mjeshtëri dhe stil krejt të veçantë dhe të panjohur në shkrimin e sonetit shqiptar, një gjini sa shpirtërore aq edhe unike, në llojin e trajtesës dhe “teknikës” poetike sendërtuese të sonetit (tingëllimës), si gjini letrare. Në poezinë shqipe soneti është shfaqur gjatë Rilindjes.

I pari që ka shkruar është L. De Martino, pastaj Ndre Mjeda, Zef Serembe, Ernest Koliqi, etj. Mirëpo, kulmin artistik e ka arritur Ndre Mjeda dhe i fundmi sonetian është Uran Kostreci. Tingëllima është modeli më i mirë i melodisë së shpirtit të lodhur por jo të mposhtur, duke e nxitur



në të cilën e shkuara dhe e tashmja shkrihen vazhdimisht bashkë (Gadamer: 1965) pa ndërmjetësimin e horizontit të pritjes, (Jauss: 1982) por thjesht receptimi në bashkëkohësi.

Të gjitha sonetet, jo vetëm që kanë të njëjtin kompozim, por edhe të njëjtin ndërtim fabulor, ku dominojnë fjalët: shqipot/t’kuq/komunizmi/helm/eshtra/ varr/vrau/ Enver/liri etj.

Nocioni i tingullit të pastër, si një “masë estetike”, është një sistem marrëdhëniesh që na paraqet:

- larmi të efekteve zanore,
- shtresë zanore,
- integraliteti i krijimit poetik,
- lidhja e qenësishme e brendëshme. Cilësia rela-

tive e tingullit, që dallohet nëpërmjet vargjeve, ku edhe dallimet e mbredëshme të tingujve, [lëkur’**bagtish**/ Përkthyes **ish**] ku veçantësia dhe muzikaliteti shprehen me termin “eufoni” bashkë me dallimet e tingujve që kanë në themel; *metrin* dhe *ritmin*. Soneti : “**Krenaria e qëmotshme e shqiptarit**”

Në koh t’Zogut na shkon një **katundar** [a]
Me shit lëkur’bagtish e bash **te ura** [b]
Pa hyr në treg ai takon **dy burra**, [b]
Përkthyes ish njëri e i foli **i parë**: [a]

“Në ke nijet për t’i shit **në pazar...** [a]
Zotria mund t’i blejë ato **lëkura...**” [b]
Fshatari u tha: “Un për t’i shitë **i prura...**” [a]
Zotria i thot: “Për tre lek copa **i marr...**!” [b]

“Në treg i shes pesë...” - iu gjegj plaku **atbot**. [c] [12]
“Jap katër! - thotë i huaji - nuk janë **pak...**!” [d] [13]
“Jo!” - “Mirë, - i tha tjetri - pesë i vëm **kapak**, [d] [13]

Ke dhe fukarallëk... nuk e **shtyn dot...** - [c] [10]
“Fukarallëku im ka vlerë; **sa kjo botë**, [c] [12]
S’ke aq lek ta blesh!” - ia ktheu rrept **ai plak**. [d] [10]

Ruajtja e *skemës së sonetit të Petrarkës*, dukshëm është dalluese edhe në sonetet e Uran Kotreci-t, që kanë po atë *përsosmëri petrarkan* si: ndraja në 14 vargje, 2 (oktava) me tetë rrjeshta dhe (sestet) me gjashtë vargje të ndarë në dy strofa, por sonetet e Kostreci-t, vetëm nuk ruajnë rimat në (sestet), në krahasimin me sonetin e Petrarkës, (kënga e Laurës).

.....
Dhe ju që lëvduat nëpër **rima** [c] [10]
Fjal dashurie atij në varg i **thatë**, [d] [11]
I ktheni nderin se vrau në jetë **kaq trima**, [c] [13]

Pse thau një shpirt të mikut tim të **ngratë?** [d] [11]
Ja, këtij Zoti lavd i thurt’ **shpesh herë** [e] [11]
Për ç’ju punoi nëntëdhjet’ e **nëntë here** [e] [12]

Modifikimi i Kostreci-t, sidomos duke *përmbysur rendin e sonetit të Petrarkës*, [cdc/dee] është bazuar edhe në variantin e vargërimit të gjuhës shqipe, [cdd/ccd]. Se vargimi ndryshon në gjuhën tonë (pra shqipe), në varsi të vargut *dhjetërrokësh* dhe *njëmbëdhjetërrokësh/dymbëdhjetërrokësh* karakteristikë e vargut në gjuhën shqipe. Një *risi tjetër*, është edhe mënyra e *akuzës, vëzhgimit, pyetjeve dhe dialogut*, kjo falë edhe *dimensionit jetësor* të poetit. Kjo vjen edhe nga vlerësimet e kritikës së kohës që kanë për veprën e Kostreci-t si: (Myzaf-er Xhxiu), (Petro Zheji) etj., por i vetmi studim sipërfaqësor, por si vlerë për një poet -mjeshër të sonetit shqiptar, është një botim në (fjalaelirë.com), ku *intelektualja* e Kostreci-t vihet *përballë mendësisë së kohës*, se vetë soneti shqiptar kalon edhe *kohën trediminsionale* të vetë Uranit. Për shkak të *narrativës strategjike*, që tregohet përmes soneteve, të një njeriu që iu është *dhunuar e vërteta* dhe mohuar *lira e jetës* dhe e *botimit* me mjete stilistikore, poeti ka sendërtuar *lëvizje afektive* dhe *zhvendosjet në emocionet e folësit* ndjenjat e tij *pozitive* dhe *negative*. Ai e ndjen *pikëllimin, hidhërimin* dhe *gëzimin* , se tekni-ka e sonetit edhe dukshëm me një *vetëdije të lartë tingëlluese*, (Bennett: 2007).

Soneti me titull: “**Humbi tradita e vyer në fshat**”, vargjet: *ca fshatarë, sot shesin drog bollëk./Hashash mbjellin n’parcel ... kanë huqe tjerë!/Një bujk droguar vret komshin në sherr/E ngjyq flet si gar-ip, shet tangërrllëk*, madje ironia dhe satira (në kundërshtim me mis-ionin e sonetit) kanë tipare të *posmodernitetit*, (Jencks: 1968)

Si përfundim: nuk mjafton vetëm keqardhja apo ndonjë falje për braktisjen e poetit, por kritika nuk duhet të jetë *armiqësore, klaso-re, përjashtuese, klientiste*, por profesioniste duke u marrë më shumë me sonetin, që ka *fare pak* apo aspak studime për këtë *stil poetik të vështirë* që shkencat letrare dhe kritika botërore e kanë trajtuar me shekuj. Uroj që soneti i **Uran Kostreci-t** mos të *mbetet në hije* apo i harruar si *vetëjeta e tij*, por të ketë një fat më të mirë se vetë poeti, që të jetë pjesë e *studiuesve të ardhshëm* pse jo dhe e antologjive shkol-lore dhe të huaja.

BIBLIOGRAFIA:

1. Bennett, Kenneth.C: (2007), *Threading Shakespeare's Sonnets* , Lake Forest , Illinois
2. Fraj, Northon: (1990), *Anatomia e kritikës*, përkth: Avni Spahiu, “Rilindja”, Prishtinë
3. Fridrih, Hugo: (1974), : *The structure of modern poetry (From the Mid-Nineteenth to the Mid-Twentieth Century)*, Northwestern University Press, Evanston, USA
4. Gadamer, G. Hans: (1965), *Truth and Method*, London.
5. Haxhira, V. Vilheme: (2020), *Poeti i sonetit, Uran Kostreci, në 82 vjetorin e lindjes së tij*, “Voice of Albania”, (VOAL, [https://www voal.ch/poeti-sonetit-uran-kostreci-ne-82-vjetorin-e-lindjes-se-tij-nga-vilhelme-vrana-haxhiraj/](https://www.voal.ch/poeti-sonetit-uran-kostreci-ne-82-vjetorin-e-lindjes-se-tij-nga-vilhelme-vrana-haxhiraj/))
6. Holland, Norman: (1968), *The dynamic of Literary*, Response, Oxford
7. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Soneti>
8. <https://revistaletrare.com/blog/2008/11/01/sonetet-e-zef-serembes>
9. Jauss , Hans-Robert: (1982),*Toward an Aesthetics of Reception*, Brighton
10. Jencks, Charles: (1968), *What is Post-Modernism?* London: Art and Design.
11. Kostreci, Uran: (2006), *Sonete*, Tiranë.
12. Krasniqi, Milazim: (2005), *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Koosva, Prishtinë.
13. Matz, Robert: (2007) *The World of Shakespeare's Sonnets: An Introduction*, London: Mc-Farland and Company.

BESNIK MUSTAJ
VLERËSOHET NË ITALI
ME ÇMIMIN E LARTË
“VIRTYTI DHE DIJA”

Shkrimtari, Besnik Mustafaj është vlerësuar në Itali me çmimin e lartë “Virtyti dhe dija” me motivacionin “Person i Moralit të Lartë, shkrimtar, ish-Ambasador i Shqipërisë në Paris dhe Ministër i Jashtëm në epokën post-komuniste, për dënimin e të gjitha formave të totalitarizmit dhe diktaturës në veprat e tij, për luftën e tij për liritë, për nxitjen e tij të pandërprerë për të rezistuar dhe reaguar kundër çdo forme të shtypjes politike “.

Ai është vlerësuar nga Gentiana Mburimi, Konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë.

Çmimi, në fjalë është i promovuar nga shoqata “MediterraneaMente”, në marrëveshje me Komunën e Porto Cesareo, e ka marrë emrin nga vargjet e famshme të Komedisë Hyjnore me të cilën Uliksi, duke iu drejtuar dinjitetit intim njerëzor, udhëheq shokët të tij të udhëtimit, duke i inkurajuar ata të lundrojnë përtej shtyllat e Herkulit. Një ngjarje që përqendrohet në Mesdhe, detin që bashkon popujt, kulturat e ndryshme dhe fetë e ndryshme rreth tij; deti që formoi civilizimet, që i bashkoi dhe i ndau, i cili i pa ata në kushte të mira dhe gjithashtu në konflikte të rënda. Mesdheu, deti që po pëson një kërcënim mjedisor në rritje, deti në të cilin mijëra migrantë humbin jetën, në një përpjekje për të arritur brigjet italiane, greke dhe spanjolle.

Fituesve u është dhënë statuja e perëndisë “Thot”, hyjnia egjiptiane e shkencës dhe mençurisë, që daton nga shekulli i gjashtë para Krishtit, i gjetur në detin e Porto Cesareo në 1932 dhe i ekspozuar në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të Taranto./abcnews.al/



NJË VËSHTRIM MBI ROMANIN "DARKA E GABUAR" TË KADARESË

Nga Ervin Nezha



Në rrjedhën e gjatë të kohës, historitë përsërisin vetveten. Dy mijë vjet më parë, në një darkë të paqartë, të mbuluar nga mjegulla dhe misteri, një burrë i quajtur Jezus, para dishepujve të tij në Jerusalem, do të parashikonte tradhtarin dhe fundin. Ka pasur shumë polemika, interpretime, mistere për atë darkë ashtu sikurse shumë të fshehta të pazbuluara. Një darkë e tillë do të përsëriste veten rreth dy mijë vjet më vonë, tanimë në Gjirokastrë, në një roman të Ismail Kadaresë. (Faktet historike nuk na hyjnë në punë).


Dhe ja se si: "Dy shokë universiteti, Doktor Gurameto i madh, takohet me kolonelin e tankeve Fritz von Schwabe, ardhur si okupator në Gjirokastrë, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ka shumë arsye për të pasur një darkë-takim mes dy miqve të shkollës. Koloneli gjerman ndihet i tradhtuar nga thyerja e kodit zakonor të Kanunit të Lekë Dukagjinit, mbasi mbi ushtrinë e Rajhut, janë shkrepur armë, ndërsa përligjja e darkës për doktorin është shpëtimi i pengjeve të qytetit.

Në njëfarë mënyre kështu zhvillohet një darkë e mbuluar nga misteri, nata dhe paqartësia e asaj që ndodh. Dhe për të nxjerrë një darkë nga mjegulla e misterit duhet gjithmonë një "Judë", i cili këtë herë qëllon të jetë një oficer i Gestapos, që ka vepruar jashtë syrit të rrëfimitarit, personazheve dhe lexuesit, dhe që bëhet syri dhe veshi i asaj që ndodh aty dhe që do të ngjasë më vonë, përmes shënimeve të tij.

Në pjesën e dytë të romanit mbizotëron "romanthi" brenda romanit i Shaqo Mezin, një personazhi brilant, simbol i rehabilitimit të figurës së tjetrit në letërsinë shqipe, që jo domosdoshmërisht duhet të paraqitet si "i kithëti" apo i ndryshmi. Përkundrazi Shaqo Mezin është "normali", një personazh njerëzor, veprimet e të cilit janë plotësisht të justifikuar, nëse kemi parasysh edukimin dhe nivelin e tij të intelektualit.

Nëse në pjesën e parë të romanit Gurametoja, është fokusi, ndërsa të tjerët, tipa personazhesh esenciale, pijanecë, karagjozë, derdimenë, thashethemexhinj që lëvizin si hije, në sfondin e romanit, duke shërbyer thjesht si personazhe Gaxhet, që zotërojnë një informacion, e japin dhe më pas treten, në pjesën e dytë, fokusi është Shaqo Mezin, ndërsa Gurametoja, është hija, që përbën sfondin e kësaj pikturë dhe dramën e hetuesit.

Të dy këto personazhe i lidh Gjirokastra, por i lidh dhe një personazh i tretë, Fritz von Schwabe dhe trilli i sajuar prej tij, që ngjall një histori të vjetër gjirokastrite. Historinë e të vdekurit që shkon për të bujtur, i ftuar gabimisht nga ftesa që djali i të zotit të shtëpisë e hedh mbi varrezat e qytetit.



Fritz von Schwabe nuk është Fritz von Schwabe, por Klaus Hempf, ndërsa këmbimi i identitetit me shokun e vërtet të Gurametos e shndërron pa dashje Gjirokastrën në qendrën e globit, ku mendohet se po luhet një komplot i madh, komploti i bluzave të bardha, i udhëhequr nga organizata terroriste hebraike e "Xhonsit".

Vetëm një mendje brilante si Kadareja mund të ndërtojë një botë të trilluar kaq të besueshme, ndoshta më të besueshme sa mund të ketë ndodhur në të vërtetë, sa pavarësisht dendurisë së rasteve, situatave të koklavitura, intrigave, të ruajë një qartësi të tillë, ku gjithçka të ndihet e përligjur.

1. A është historia e "Darkës mistike" vetëm një histori për t'u rrëfyer?

Romani i Kadaresë ka më së pari, vlera estetike. Është një tekst me aq shumë nënshtresa kuptimore, sa edhe në ato kapituj ku stuhia e intrigës qetësohet, vigjilenca e lexuesit është e pamundur të ulet, sepse mendon se po bie në grackën e një trilli, që sapo ka nisur të thuret. Për ta ilustruar këtë që dua të them, mund të shërbejë kapitulli "Zi Gratë", i cili edhe pse duket si i futur mekanikisht brenda romanit jep në mënyrë alegorike dhe groteske ndërtimin e rendit të ri socialist, sidomos farsës së asimilimit gjinor, të proklamuar në emër të barazisë gjinore nga komunistët.

Nga ana tjetër, Kadareja na servir një pamje, se ç'ndodh me individin, kur këmbimi i autoritetit, është i vazhdueshëm. Në një hapësirë relativisht të shkurtër kohore, qyteti kalon nga durart e italianëve, te gjermanët, deri pastaj te komunistët, shtojkë edhe mbetjet e ish-Perandorisë Osmane. Për atë që mund të jesh mik, i dëshirueshëm, i pranueshëm për tjetrin mund të jesh armik, i padëshirueshëm, i papranueshëm, madje i rrezikshëm. Kjo vjen për faktin se askush nuk mund të jetojë si ishull më vete, i pandikuar nga të tjerët dhe pa vepruar me të tjerët.

Fraza dëshpëruese e doktorit "Ah ajo darkë..." mund të orientojë lexuesin drejt leximit të mëkatit të zakonshëm njerëzor, të njeriut që nuk zhbën dot gabimet e së shkuarës. Madje nuk do t'i zhbente dot, edhe sikur të mund të kthehej pas për t'i ndrequr. Është pikërisht ajo që u thotë Jezusi dishepujve - gjërat do të ndodhin kështu se janë të shkruara të ndodhin.

2. Këmbimi i identitetit, plotësimi i kushtit ideal nga mungesa e vëzhgimit

Vëzhgimi në roman, si vëzhgim brenda një bote të trilluar që funksionon me ligje të pavarura nga bota e njëmendësisë, ka karakter fragmentar. Si rregull, ngjarjet, personazhet, skenat ekzistojnë për aq kohë sa ne arrijmë t'i vëzhgojmë përmes procesit të leximit.

Kështu është normale që një personazh të qëndrojë në fokus dhe mbasandaj të zhduket për kapituj të tërë. Si rregull, rishfaqja e tij, sidomos gjatë metamorfozave të dallueshme, duhet të shpjegohet nga autori, për të mos kompromentuar besueshmërinë e ngjarjes. Ose personazhi duhet të shpjegojë ndryshimin (çfarë ka ndodhur me të). Në rastin e Klaus Hempfit që vjen si Fritz von Schwabe, kushti i këmbimit të identiteteve është gati perfekt. Ky këmbim kryhet jashtë vëzhgimit të lexuesit dhe del e qartë vetëm nga të dhënat e paraqitura fillimisht nga hetuesi gjerman e mbasandaj nga ai, rus. E vetmja pikë komprometuese për besueshmërinë e ngjarjes mbetet pyetja e thjeshtë "pse"?

(Pse Klaus Hempfi prezantohet si Fritz von Schwabe?)

Përligjja vjen nga historia e të vdekurit, që ngrihet nga varri për të bujtur. Ajo është ana tjetër e monedhës, inercia e ngjarjes, ndryshojnë vetëm motivet, diametri është njëlloj.

Për mua, zgjedhja e Klaus Hempfit nëse është irracionale, pra instiktive, ka mundësi që zanafillën ta ketë te një ndjenjë sentimentale të lindur në spitalin fushor të Ukrainës, për Prince Von Shwabën e vërtetë, i cili nuk kishte mundësi të takonte më i gjallë mikun e tij shqiptar, sepse do të vdiste. Kështu, vdekja e Gurametos, në leximin tim, është rrjedhojë e një veprimi spontan të Klaus Hempfit, vjen si mënyra e vetme e bashkimit të dy miqve të vjetër, tashmë në botën e të vdekurve, pasi në botën e të gjallëve do të qe e pamundur. Ndaj ky ribash-

kim ndodh atëherë kur Gurametoja, në agoninë e fundit, nuk gjen të lidhur pranë vetes Gurameton e Vogël, siç mendonte, por dikë tjetër, një figurë të paqartë.

Dhe nëse zgjedhja e Klaus Hempfit është racionale, pra e qëllimshme, ka mundësi që historinë e vjetër të "të vdekurit", ai ta ketë dëgjuar në spitalin fushor, nga Prince Von Shwabe dhe ka dashur, ta zgjojë këtë histori rrëqethëse nga gjumi, ose më së paku, ka dashur të bëjë të mundurën të pamundur, pra të bashkojë dy miqtë në botën e të gjallëve. Kjo është e mundur, po të kemi parasysh se identitetin, e legjitimon më së pari esenca metafizike dhe më pas prezenca fizike. Prandaj, herë pas here, për të legjitimuar prezencën e Fritz von Shwabe, Klaus Hempfi, i adreson pyetjen permanente Gurametos,- ti kujton se unë nuk jam ai i atjeshmi? (pra, ai dyshon nëse e paraqet si duhet identitetin e ri).

3. Cila është viktima e vërtetë e trillit të sajuar nga Klaus Hempfi?

Kadareja thotë se darka u dënua nga të dyja palët, d.m.th., edhe Fritz von Schwabe i rremë u dënua nga të tijtë për darkën ku mori pjesë, ndërsa fati i tij nuk bëhet i ditur.

Viktima e vërtetë e kësaj dark nuk mbetet të jetë as Gurameto. Vdekja e tij mund të kishte ardhur edhe pa u hetuar fare, duke e dënua me damkën e tradhtarit që priti armiqet e kombit për darkë. Hetimi i ngjarjes thjesht shërben jo për të zbuluar të fshehtat e asaj darke, të pëshpëritura vesh më vesh, por për të nxjerrë në pah viktimën, "të vdekurin" e vërtetë, i cili nuk është tjetër kush përveç Shaqo Mezin. Një personazh kompleks, siç thamë, tërë kohën në evolucion. Drama e të qenit i "sëmure" nga deliri si anomali psikologjike. I devotshëm ndaj autoritetit që i shërben, e nis me besimin e plotë se ka në duar rastin që do ta bëjë emrin e tij qendrën e botës, aq sa zbulimi i komplotit të "Xhonsit" do ta ulë në të njëjtën tryezë me "babën shpirtëror" Stalinin. Mendim tipik i një mendjeje prej mediokri. I gjithë procesi i hetimit, Gurameton e shndërron vetëm fizikisht, ndërsa hetuesin e rrënon mendërisht dhe shpirtërisht. Në fillim Shaqo Mezin, kërcënon, ngulmon, provon me të gjitha mënyrat, në fund lutet, derisa përfundon i dërrmuar.

Vdekja e Stalinin e trondit. Tanimë çdo ëndërr e tij ka vdekur bashkë me "babën e madh" në jetën e tij i ka humbur të gjitha, karrierën, ëndrrat, të dashurën dhe dinjitetin. Sipas tij, fajtori kryesor është Gurameto. Ai Gurametoja shpërfillës, që e simpatizonte që i vogël. Gurametoja që zotëronte gratë e qytetit dhe që i shpërfillte të gjithë.

4. Një doktor për të shëruar Stalinin dhe një kronist i verbër për të dëshmuar darkën...

Galeria e personazheve të veprës është e jashtëzakonshme. Çdo personazh lëviz brenda një sfondi të mjegullt, por brenda një perimetri të përcaktuar qartë në kohë dhe hapsirë. Ndoshta mund të ketë arsye biografike, por zgjedhja e një doktori nuk është e rastësishme.

- Stalini po vdes, po mbytet, shpëtoje doktor, - klith Shaqo Mezin.

Sigurisht, ironia është therëse, Stalini "i pavdekshëm" pret të shpëtohet nga një doktor i rëndomtë, në skajin më të parëndësishëm të kampit të madh socialist. Sigurisht, nuk bëhet fjalë për një kurim fizik, por metafizik. Gurametoja refuzon. A e shkel betimin e Hipokratit? Ndoshta, po! Cilido doktor duhet t'i shërbejë cilitdo pacienti, pavarësisht rrethanave në të cilat ndodhet dhe pavarësisht mjeteve përmes të cilave mund ta shërojë.

Dhe në fund, personazhi mistik i verbër, Vehib Qorri, që nuk ka parë në jetë as të gjallë, as të vdekur, sepse ka lindur i verbër, mirëpo që është i pari që i shkon irracionalisht më pranë së vërtetës. Ngjarjet e mëdha, për të mbetur në histori, kërkojnë dëshmitarë "të verbër", që nuk merren me detajet por me thelbin. Kështu, këto ngjarje bëhen mitike, kanonizohen dhe bëhen të pavdekshme, njëjtë si të *Iliada* e Homerit.

Prozat poetike të Ernest Koliqit

Nga Fatlum Meholli

Në letërsinë shqipe, sipas shumë studiuesve, Ernest Koliqi konsiderohet si një ndër prozatorët më të mëdhenj. Koliqi shquhet më së shumti me zhanrin e tregimit dhe novelës, që i shërbyen autorit si medium dhe mjet për të shprehur idetë e botëkuptimet e tij mbi traditat, zakonet shqiptare, problemet e ndryshme sociale e kështu me radhë. Ernest Koliqi, ndër tjerash, pasuroi letërsinë shqipe në aspektin estetik-artistik edhe me anë të veprës letrare në prozë “Pasqyrat e Narçizit”. Shikuar historikisht, kjo vepër letrare botohet pas përmbledhjeve me novela dhe tregime siç janë “Hija e maleve” dhe “Tregtar flamujsh”: për herë të parë botohet më 1936 në “Gazeta Shqipëtare”, ndërkaq si libër i veçantë i ripërpunuar botohet më 1963 në Romë.

Para se të flasim për prozat e “Pasqyrave të Narçizit” në veçanti, duhet theksuar disa kualitete zhanrore. Prozat e kësaj përmbledhjeje orientohen kah natyra dhe modelimi lirik, sepse ato pësojnë ndryshim në manifestimin e botës fiksionale, në narracion, në karakteret letrare e kështu me radhë. Përmbledhja “Pasqyrat e Narçizit” përbëhet nga shtatë proza, të cilat sipas karakteristikave të lartcekura konsiderohen si proza poetike. Madje edhe vet autori është i vetëdijshëm për përkatësinë zhanrore, me ç’rast ato i quan si “shtatë pasqyra, shtatë poemtha në prozë”.

Siç titullohet edhe vet përmbledhja, miti antik grek mbi Narcizin dhe pasqyrimi i tij në ujë janë embrioni i krijimit të këtyre teksteve letrare, gjegjësisht prozave poetike. Prandaj është me interes që të njihet mirë ky mit.

Sipas mitologjisë greke, Narcizi ishte i biri i perëndisë së lumit, Çefizit, dhe nimfës Liriope. Ai shfaqet si një djalë shumë i pashëm, me ç’rast nimfa Eho bie në dashuri me të. Mirëpo, Narcizi ia refuzon dashurinë Ehos, duke bërë kështu që nimfa Nemesis, që sipas mitologjisë greke ishte perëndeshë e hakmarrjes, ta dënojë Narcizin. Kësisoj, ai refuzon të gjitha dashuritë e tjera përveç imazhit të tij të pasqyruar në ujë/lumë. Kjo çon drejt shkatërrimit (vetëvrasjes) dhe shndërrimit të Narcizit në një lule të bukur që sot e kësaj dite e mban emrin e tij.¹

Pra, Ernest Koliqi ndikohet dhe frymëzohet nga miti antik grek i Narcizit. E kjo hetohet qysh në fjalitë hyrëse të prozës së parë që titullohet “Ujë e pusit”:

Dashunova prrallën e Narçizit me të tănë hovin e gjakut t’im prandveruer. E gjithëkund e gjithëkah kërkoshem pasqyra ku m’u pasqyrue. Narçiz e quejta veten ndër ditët e rinis së parë, tue mos parandie asokohe sa trishtim mâ vonë do të më shkaktonte ky emën luluer.²

Koliqi i ndikuar nga shkolla simboliste, *Pasqyrat e Narçizit* i modelon mbi simbolikën e Narcizit, megjithatë ai e risemantizon mitin, me ç’rast ndryshimet janë evidente. Koliqi fokusohet vetëm te elementi i pasqyrimin dhe individualitetit. Me fjalë të tjera, autori merr mitin dhe e modifikon për nevojat e veta shprehëse. Po ashtu, duhet theksuar që vdekja (vetëvrasja) te miti i Narcizit, nuk është pjesë përbërëse e prozave poetike të Ernest Koliqit. Ndërlidhja e prozave poetike të Koliqit me mitin e Narcizit nuk ka të bëjë me narcizmin si dashuri në vetveten, por konsiston në dashurinë autoriale për atdheun, artin e kështu me radhë. Pra, prozat e kësaj përmbledhjeje pasqyrojnë shpirtin e autorit në etapa të ndryshme të jetës. Madje, siç thotë edhe studiuesi Anton Berisha, dashuria dhe afërsia e autorit me mitin e Narcizit shfaqet për arsye se ai ndërmjet artit gjakon pareshtur ekzistencën dhe përjetësinë artistike.³

Narcizi i mitit grek pasqyrohej vetëm në pellgjet ujore, ndërkaq te “Pasqyrat e Narçizit” të Koliqit reflektimi përveç në ujë shfaqet edhe në pasqyra, në xham. Kësisoj, prozat poetike të kësaj përmbledhjeje bartin karakteristika autoideografike të autorit. Madje, edhe vet autori e thotë që shtatë prozat e “Pasqyrave të Narçizit” tregojnë shtatë fytyra të ndryshme në fazat e jetës së poetit.

Në këtë vepër autori identifikon veten në raport me botën



shqiptare dhe të kaluarën përmes shenjave të ndryshme identifikuese, të cilat, edhe sipas Sabri Hamitit, mund të jenë: pusi i ujit, pasqyra shkodrane, përroi i Dukagjinit, kroni, çutërra në Helveti e xhami i dritares.⁴

Veprën “Pasqyrat e Narçizit” e përbëjnë shtatë proza poetike që janë refleksione autoriale. Në prozën e parë që quhet “Ujë e pusit”, autori sheh reflektimin e fytyrës së vet në ujë dhe dashurohet me të ngjashëm si Narcizi mitik, vetëm se Koliqi në identitetin e tij, ndërkaq Narcizi i mitit në pamjen. Koliqi në këtë pjesë rrëfen se qysh në fëmijëri ishte dashuruar me ujërat e rrjedhshëm, me natyrën; me fjalë të tjera, në gjithçka që lidhej me Shkodrën, vendlindjen.

Te “Pasqyra e vjetër shkodrane” kujtohet e kaluara e Shkodrës. Narracioni fokusohet në reminishencat autoriale mbi zakonet, traditat, elementet e vjetra që lidheshin me ambientin e Shkodrës. Duke na bërë të kuptojmë që elementet e ndryshme tradicionale do të mbesin vetëm si kujtesë. Gjithashtu në këtë pjesë shfaqen edhe besëtytnitë si për shembull tersi që mund të vjen kur shikohen pasqyrat gjatë natës:

*Ajo më tha me një zâ të prëm:
- S’bân. Nuk duhet m’u shikue natën në pasqyrë.
Ësht keq
- Keq? Pse keq?
- Pse njashtu!*

Po ashtu shpërfaqja e shenjave identitetare vendëse hetohet edhe te “Kroni i bardhanjorvet”, ku autori, ndër tjerash, pasqyron fazën e fëmijërisë. Tashmë kalohet nga “uji i pusit” te “kroni” dhe rrjedha ujore e tij që mund të simbolizojë rrjedhën e madhe shekullore të traditës shqiptare. Edhe te tregimi “Prrue në Dukagjin” narracioni ndërlidhet me dashurinë autoriale për bjeshkët e mëdha e të bukura të atdheut e kështu me radhë.

Vazhdohet me tregimin tjetër “Nji çutërr në Helveti”, në të cilin Koliqi përpiket që të hetojë ndikimin e kulturave të huaja në kulturën e tij dhe kulturën shqiptare në përgjithësi, duke u ndërlidhur edhe hapësirat zvicerane ku ndodhej. Ky tregim ka edhe një nëntitull “Kushtue kujtimit të Dom Lazër Shantojës”, me ç’rast reflektohet mërzia e madhe e autorit për vdekjen e këtij veprimtari e poeti shkodran, të cilin Koliqi e admironte.

⁴ Sabri Hamiti: *Vepra* 8, Faik Konica, Prishtinë, 2002, fq. 594.



Pas kësaj, kemi të bëjmë me pjesën tjetër që titullohet “Vala e detit”. Prej ujit të pusit, kronit, përroit, tashmë kalohet te deti. Simbolika e detit qëndron në hapësirën e madhe e të rrafshët të tij. Një lidhje mes vendesh dhe kulturash të ndryshme. Deti shqiptar autorit ia kujtonte historinë deri në Iliri:

- Jo, mue deti shqiptar më bân me àndrrue. Kur kët Shqipni e dashunojshem njomsisht me nji zëmër poeti gjashtëmbëdhjetëvjeçar shpesh mue m’a grabitshin fantazân e dalldisun nga leximet historike anijet illyre. Àndrrat e mija velezojshin me anije illyre mbi nji det epopeje.

Sikur te tregimi paraprak, edhe te “Xhami i dritores sime” kemi të bëjmë me elemente të shumta filozofike, meqë autori përsiatë mbi të kaluarën dhe botën e brendshme. Duket sikur tashmë ai është në kulmin e formimit të tij kulturor, nëse krahasohet me fëmijërinë dhe adoleshencën te pasqyrimi në ujin e pusit, të kronit... Pasqyrimet deri te kjo pjesë shfaqeshin vetëm nëpër ujëra të ndryshme, ndërkaq tashmë reflektimi bie mbi xhamin, duke simbolizuar dhomën, zyrën, ku ndodhet autori. Dritarja është simbolika prej së cilës ofrohet mundësia e vrojtimit:

Hapa dritoren kah oborri i shtëpis edhe në vend të pamit të përditshëm m’u shtroue para nji botë e vogël, e ylbertë, gadi e panjoftun, nonse përfshinte sende të njoftuna. Por asnji çudi nuk m’a luejti shpirtin, i cili më dukës se e prittë at vegim të jashtëzakonshëm, nât mbasdite t’ambël.

Pra, jepen memoriet që janë akumuluar si pasojë e përvojës jetësore autoriale dhe nacionale, duke ngërthyer kështu elemente psikologjike e arkipsikologjike. Prej xhamit të dritares shihet natyra, kalohet te dashuria për vendlindjen, për përroin e Dukagjinit, gjeografinë, karakteristikat tradicionale e kështu me radhë.

Siç e kemi përmendur edhe më herët, shihet që në këto shtatë proza poetike jepen fragmente të rëndësishme nga etapat e ndryshme të jetës së autorit, me ç’rast prozat marrin karakter autobiografik. Mosdhënia e totalitetit të botës dhe përqendrimi vetëm në disa detaje dhe fragmente specifike jetësore janë karakteristika të veçanta të këtij lloji prozaik, pra prozës poetike.

Prozat e “Pasqyrave të Narçizit” theyejnë rregullat e modelit klasik kompozicional, me ç’rast nuk respektohet hyrja, kulminacioni dhe përfundimi specifik. Mund të thuhet që këto proza që modelojnë përmbledhjen, nuk trajtojnë ngjarje siç ndodhë në tregimet e mëhershme të Koliqit. Rrjedhimisht, “Pasqyrat e Narçizit” nuk kanë subjekt të mirëfilltë, ato vetëm se parashetrojnë botën e brendshme të autorit përmes një gjuhe specifike. Me fjalë të tjera, shtatë pasqyrat e Koliqit nuk na shfaqin ngjarje të veçanta nëpër të cilat kalojnë karakteret letrare dhe ballafaqohen me probleme të ndryshme. Ato përmes pasqyrimin/reflektimit mishërojnë identitetin autorial, përkatësinë nacionale, identifikimin me shenjat tradicionale e kështu me radhë. Ngjason me një tendencë për njohjen e vetvetes, duke parë rrezikun e humbjes së shenjave identitare.

Narracioni është një kategori tjetër e veçantë e “Pasqyrave të Narçizit”, që shenjon një kthesë në teknikën e rrëfimit të Koliqit. Për kohën, një teknikë e tillë ishte e pazakontë në letërsinë shqipe në përgjithësi. Pra, narracioni i këtyre varg prozash modelohet nga veta e parë, përkatësisht nga narratori karakter. Një karakteristikë e tillë narrative e vë narratorin në krye të ngjarjeve, vetëm se këtu narratori karakter nuk ndërmerr veprime, ai vetëm rrëfen për anën e brendshme, perceptimin e botës, të kaluarën, shenjat identitare e kështu me radhë. Tipi dominues narrativ në prozat poetike të “Pasqyrave të Narçizit” është ai homodiegetik, i realizuar përmes një gjuhe mjaft simbolike e lirike. Përdorimi i vetës së parë si zë i tregimtarit është një element tjetër që forcon konstatimin që këto proza poetike bartin shenja autobiografike të Ernest Koliqit.

Në analizën e zhanrit të prozës një rëndësi duhet t’i kushtohet edhe kategorisë temporale. Kështu që, duhet përmendur edhe disa veçori të kësaj natyre në prozat poetike të “Pasqyrave të Narçizit”. Fillimisht, koha në këto proza nuk është e përcaktuar. Ajo nuk jepet me objektivitet ose në mënyrë konkrete, por manifestohet si një kohë mitike, abstrakte dhe fund e krye subjektive. Siç e kemi përmendur, ka pjesë kur kalohet deri në Iliri atje, më pas kthehet në kohët aktuale e kështu me radhë. Me fjalë të tjera, koha nuk i përgjigjet njëfarë paraqitjeje lineare. Gjithashtu edhe vendi në “Pasqyrat e Narçizit” nuk është një vend i përcaktuar ku vendosen karakteret letrare. Refleksionet dhe përsiatjet e çojnë narratorin karakter në Shkodër, Zvicër etj. Kësisoj, lexuesi nuk është i sigurt për vendosjen e saktë të hapësirës së veçantë.

Prozat poetike të Ernest Koliqit manifestojnë mjeshtërinë artistike në prozë të këtij autori, pikërisht për shkak të novacionit të tij prozaik dhe tematik, gjuhës, formës, narracionit etj., duke pasur për bazë gjithnjë poetikat e rrymës simboliste që Koliqi i hasi dukshëm te veprat letrare të shkrimtarëve të shkollës shkodrane të jezuitëve, me në krye Ndre Mjedjen.

Për dallim nga përmbledhjet e tjera me novela e tregime si “Hija e maleve” dhe “Tregtar flamujsh”, me të cilat Koliqi arrin popullaritetin, “Pasqyrat e Narçizit” krijohen për veten me një gjuhë simbolike e të tërthortë, me ç’rast nuk kanë për qëllim përcimin e ndonjë mesazhi moral, kombëtar. Kësisoj, tregimet e kësaj vepre kërkojnë një lexues semiotik/intelektual dhe përjashtojnë lexuesin semantik.

¹ Kathleen N. Daly: *Greek and Roman Mythology A to Z*, Chelsea House Publications, New York, 2009, pg. 99.

² Ernest Koliqi: *Pasqyrat e Narçizit*, në *Vepra* 2, Faik Konica, Prishtinë, 2003, fq. 317. Të gjitha citimet e tjera i referohen të njëjtë botim.

³ Anton Bersisha: *Proza e Ernest Koliqit*, në *Jeta e Re*, Rilindja, Prishtinë, 1995, fq. 54.

“MESHARI” — VEPËR E HARTUAR NGA GJON BUZUKU

Nga Anton Nikë Berisha

“O Zot i gjallëvet e i vdekunet, Shelbuosi i gjithëve, qi ti z do mortnë e t përkatënuomit, ma aj të konvertonetë e të gjellinjë, ndijemë, u tý të lus, e m ĩ afërë muo Dom Gjonit. E muo shkatëro të shkruomitë e gjithë katet mive. E tý tue t u pëlqyem, përzë oratëtë e mĩ qi u m tý përdāot, për muo e për gjithë njerëzit të mĩ ngjakut sim, e për miq të mĩ e pr anëmiqt të mĩ, për të gjallë porsi për të vdekurnitë”.

Gjon Bdek Buzuku
(Nga “Meshari”, XIX)

1. Vepra e Gjon Bdek Buzukut, e njohur me titullin e hamendur (titulli i vërtetë nuk dihet për shkak të mungesës së fletëve të para të të vetmes kopje që njohim) – *Meshari*, e para në gjuhën shqipe e zbuluar deri më sot, është e qenësishme në dy rrafsh: në atë gjuhësor dhe në atë shprehës letrar. Thënë me fjalët e njërit ndër njohësit më të mirë të saj, Eqrem Çabejit, *Meshari* është “i pari libër i madh i shqipes!” dhe “më i pari monument i literaturës shqiptare” dhe se “jo vetëm nga pikëpamja e kohës, por përgjithësisht dhe e nivelit zë kryet e vendit në literaturën shqiptare të vjetrën; e në fushën e prozës poetike edhe për më vonë është vështirë t’i vihet ndonjë tjetër përkrah”.

Në rrafshin e parë – si fakt gjuhësor dhe si vlerë gjuhësore – *Meshari* është i pakapërcyeshëm; shqipja, si gjuhë shtjelluese – shprehëse dhe komunikuese, paraqitet në formë e përmasë mjaft të plotë, qoftë për “pikësëpari me një gjuhë letrare: prodhim edhe i një zhvillimi të mëparmë të shkrimit edhe i përpunimit nga ana e këtij shkrimtari”, dëshmi e gjendjes së shqipes në shek. XVI-të dhe e tipareve të së folmes dialektore të Veriut dhe më gjerë, qoftë për gjuhën shqipe biblike e liturgjike, që si e tillë paraqiti bazën nga u nisën autorët tanë të mëvonshëm.

Në rrafshin e dytë - si vepër letrare – qenësia e *Mesharit* të Buzukut degëzohet në dysh: më një anë ajo është vepra e parë e letërsisë së shkruar shqipe, ku dëshmohen vlera letrare, gjë që mund të konkretizohet me disa pjesë të saj, ndërsa, më anë tjetër, ajo është vepra dhe dokumenti i parë i dëshmisë së genies (ekzistimit) të letërsisë gojore shqipe, përkatësisht i disa llojeve të saj. Pra, vepra e Buzukut dëshmon për përkime dhe për lidhje të shumta të artit letrar shqiptar: letërsisë gojore dhe letërsisë së shkruar⁵. Së këndejmi, në qoftë se në bazë të gjuhës, të frazeologjisë së pasur popullore, pastaj të elementeve të dukshme të strukturës gjuhësore-sintaktike të rrëfimit - tregimit gojor dhe të fjalëve të urta, urimeve, mallkimeve etj., që janë të pranishme në veprën e tij, them se autori i veprës së parë në gjuhën tonë gjatë punës së hartimit dhe përkthimit të pjesëve nga *Bibla* dhe nga tekstet e tjerë liturgjike dhe doktrinarë, kishte si mbështetje traditën letrare gojore shqipe. Kjo gjë vërehet edhe në disa pjesë të veprës së Buzukut që për shumë elemente përkojnë me prozën tonë gojore, përkatësisht me strukturën gjuhësore-sintaksore të disa llojeve të saj, si, fjala vjen, kur rrëfohen ngjarje e ndodhi të ndryshme marrë kryesisht nga *Bibla*, kur bëhet përshkrimi i ndonjë situatë, i ndonjë

veprimi, që janë veçanti e të ashtuquajturave *forma të thjeshta* (“Einfache Formen” sipas A. Jolles) të krijimtarisë letrare gojore.

Është fakt se disa pjesë të Biblës, të sjella në shqip në veprën e Buzukut janë të përshtatura nga ai, siç pohon me të drejtë prof. Çabeji: “në vend të një riprodhimi besnik të tekstit bazë jepet disa herë një version vërtetë më i pasaktë, po më i kuptueshëm për popull”⁶. Pra, disa pjesë në veprën e vet Buzukut i shprehu me një gjuhë e me një strukturë tekstore që u përgjigjet formave të transponimit

⁶ Eqrem Çabej, *Hyrje*, pun. i përm., f. 23.



dhe të komunikimit letrar gojor. Ai kishte një arsye të fortë të vepronte në këtë mënyrë: llojet e letërsisë gojore shqipe ishin mjaft të zhvilluara, prandaj atij i mbetej vetëm që mbi bazën dhe modelin e tyre t’i përshtaste, t’i shtjellonte dhe t’ua ofronte lexuesve (pse jo dhe dëgjuesve shqiptarë në kishë ose në raste të tjera). Me një fjalë, siç thekson Çabej, “Historikisht kjo vepër nuk do shikuar e izoluar e në vetvete, po përmenda një pamjeje më të gjerë. Ajo atëherë nuk do të çmohet ndryshe veçse si fryt i një politike kishtare zhvilluar rreth mesit të shekullit të XVI”.

Në rrafshin e studimit gjuhësor të tekstit të veprës së Buzukut janë mbërritur pa dyshim rezultate të mëdha, që përligjen me punën e bërë nga Pal Skiroi, Namik Ressuli, Justin Rrota, Martin Camaj, Eqrem Çabej, Wilfried Fiedler etj. Mirëpo, në rrafshin e përcaktimit të veçantive të tekstit të veprës e të natyrës së tij, të llojit që i përket libri: biblik, liturgjik etj., pastaj të përcaktimit të besnikërisë ose të shmangies së përkthimit nga libri - teksti nga i cili Buzuku e bëri përkthimin, sidomos përcaktimin se në cilën veprë ose në cilat vepra u mbështet ai për hartimin - përkthimin e veprës, ka mbetur edhe shume punë të bëhet.

Brenda këtyre çështjeve, sa të rëndësishme aq dhe të ndërlikshme, mungon ende një studim i qenësishëm i veçimit dhe i analizimit të veçantive të disa teksteve të veprës së Buzukut që padyshim janë hartuar nga vetë ai, pra, si të tilla nuk i përkasin asnjë teksti konkret liturgjik.

Pa qëllim që të ndalem më gjerësisht rreth dukurive që përmenda, po i shpreh disa mendime rreth karakterit dhe natyrës së veprës së Buzukut të botuar më 1555, që më lindën pas leximit të serishëm që i bëra kohët e fundit.

2. Nga një lexim i vëmendshëm nuk është vështirë të nxjerrësh përfundimin se libri i parë i botuar në gjuhën tonë shqipe, i njohur me titullin “Meshari”, në qenësinë e vet është vepër e hartuar nga Buzuku. Kjo përligjet nga fakti se krahas teksteve të përkthyer biblike, liturgjike, lutjeve e litanive, të zgjedhura dhe të shtjelluara nga Buzuku, në të ka edhe tekste të hartuara nga vetë ai. Veprimi i këtillë – hartimi i librit në këtë mënyrë – lidhet para së gjithash me qëllimin e hartimit të veprës: për t’u ardhur në ndihmë priftërinjve shqiptarë, po dhe besimtarëve, që të kishin një libër në gjuhën shqipe, nga i cili do të mësonin për disa nga dukuritë më të rëndësishme të besimit të krishterë e të shërbimeve që bëheshin në kishën katolike, jo vetëm në trevat ku Buzuku shërbente si prift, po dhe më gjerë – në botën shqiptare në përgjithësi. Këtë na e thotë vetë Buzuku në shkrimin përmbyllës të librit të tij, i njohur si *Pasthënie*:

“U Doni Gjonit, biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gjā të ndigluom q sē Shkruomit shenjtë, q sē dashunit sē botësē sanē desha me u fëdigunë, për sā mujta me ditunë, me zdritunë pak mendetë e atyne qi të ndiglonjinë, përse ata të mundë mernë sā i naltë e i mujtunë e i përmishëriershim anshtë Zotynë atyne qi ta duonë m gjithë zemër. U lus mbas sodi mā shpesh të ʋini m klishe, përse ju kini me gjegjuni ordhëninë e Tinëzot. E atë në mrarofshi, Zotynë të ketë mishërier mbī ju. E ata qi u monduonë djerie tash, mā mos u modonjënë. E ju t ini të zgjedhunitë e Tinëzot. E përherë Zotynë kā me klenë me jū, ju ue ndjekunë të dërejtënë e tue lanë të shtrembënë. E këta ju tue bām, Zotynë ka me shtuam ndër jū, se të korëtë taj të nglatetë djerie q sē vjelash, e të vjelëtë djerie q sē mbjellash. E u mā duo të mbaronj vepërënë teme, Tinëzot tue pëlqyem”.

Me një fjalë, libri i Buzukut është një zgjedhje – përmbledhje teksteve të karakterit e të llojeve të ndryshme biblike, liturgjike, lutjesh e litanish, ku tekstet

⁷ Eqrem Çabej, *Hyrje*, pun. i përm., f. 22.

¹ Eqrem Çabej, *Hyrje*. Në “Meshari i Gjon Buzukut (1555)”. Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej. Pjesa e parë. Hyrje dhe transliterim. Universiteti shtetëror i Tiranës. Instituti i historisë dhe i gjuhësisë. Tiranë 1968, f. 17. Vepra u ribotua nga “Rilindja”, Prishtinë, 1978.

² Eqrem Çabej, *Hyrje*. Në “Meshari i Gjon Buzukut (1555)”. Botim kritik, Pjesa e parë, vep. e përm., f. 7.

³ Eqrem Çabej, *Hyrje*, pun. i përm., f. 45.

⁴ Eqrem Çabej, *Hyrje*, pun. i përm., f. 19.

⁵ Shih më gjerësisht punimin tim *Krijimtaria letrare gojore shqipe dhe “Meshari” i Gjon Buzukut*. Në “Jeta e re”, nr. 3, 1988, f. 272 – 292.

– pjesët që përdoren në kremtimin e meshës (edhe pse jo më të gjithë përbërësit e rëndësishëm) bëjnë pjesën më të madhe të veprës. Së këndejmi, vepra e tij nuk është një libër i mirëfilltë doktrinar, as vetëm liturgjik, as libër i mirëfilltë meshe. Njohësit e teksteve të natyrës së këtillë do të mund të përcaktojnë mirëfilli sasinë (përmasën) e llojeve të teksteve përkatëse në këtë vepër të Buzukut dhe arsyet e futjes së tyre brenda një tërësie, një libri, siç ngjet në veprën e tij.

Në zgjedhjen e teksteve, përkatësisht shembujve që sjell nga *Bibla*, Buzuku synoi të ruajë një drejtpeshim midis teksteve të *Besëlidhjes së Vjetër* dhe të *Besëlidhjes së Re*. Në shumicën e rasteve (sidomos në pjesët që lidhen me liturgjinë) ai sjell dy shembuj: njërin nga *Besëlidhja e Vjetër* e tjetrin nga *Besëlidhja e Re*. Edhe zgjedhja dhe gërshetimi, fjala vjen, i tekstit të *Këngës së këngëve* me pjesë të tjera të *Besëlidhjes* (të Vjetër dhe të Re) përligj dukurinë se Buzuku i kishte zgjedhur dhe i kishte renditur tekstet sipas një koncepti përkatës, duke dhënë shënime se nga ishin marrë ato dhe në ç’rast duhet të përdorëshin. Natyrisht, ky veprim nuk e përjashton faktin se që për ta hartuar veprën e vet Buzuku do të jetë mbështetur tek ndonjë libër konkret i llojit *“Missale vulgare - Meshar popullor”*, të botuar në latinisht, në italisht, në kroatisht - serbisht, gjuhë të cilat ai i zotëronte. Këtë e pohon Eqrem Çabej në bazë të krahasimit që u bëri disa teksteve, përkatësisht të shtjellimit të fjalisë së përkthyer në shqip nga Buzuku.

Edhe ndryshimet e teksteve të përkthimit në shqip në krahasim me tekstet nga mund të jetë bërë përkthimi, dëshmojnë për punën që bëri autori ynë. Këtë e ka thënë në mënyrë të përmbledhur studiuesi, Zeqirja Neziri: “Mesharin tonë në fillim e barazuar me “Lutësozin” kroat të Vatikanit (shekulli XIV) dhe me “Pslaterin” dubrovnikas (shekulli XV), mesharët kroatë të vitit 1483 dhe 1494, si dhe me “Leksionarin” e Bernardinit të vitit 1495, tamam gjysmë shekulli më i vjetër se Meshari ynë, pastaj edhe me Mesharin e Verbiçës (shekulli XV). Rezultatet dolën të njëjta, me ato që i pati konstatuar Çabeji dhe i pari përforcuar Camaj (...) Këto hulumtime çuan drejt përgjigjes se Meshari i Buzukut për aq sa i ndjek këta mesharë, po për aq largohet prej tyre⁸”.

Në librin e Buzukut, ndërmjet pjesëve të zgjedhura biblike dhe teksteve të tjera doktrinarë e liturgjikë, janë rreth katërqind (400) ndërhyrje të autorit, që janë të natyrës sqaruese, shpjeguese dhe udhëzuese, herë – herë më të gjata e herë më të shkurtra. Këto tekste – ndërhyrje përligjin faktin se libri i Buzukut është hartuar – shtjelluar nga ai vetë dhe nuk është libër i përkthyer, siç është thënë zakonisht deri më sot. Për të konkretizuar këtë po sjell vetëm pak shembuj të natyrës së tillë:

“E këtu soset Officia e Zonjësë, qi thuhet për gjithë mot. E tash të zanë nfill Officia e Adventit. E këto Lekciona të kësh me thanë me këto Responsorja e me këto Antifena djerie mbas Krëshshëndellsh⁹”.

“E këtu soset Matutini i Adventit. E tash zanë nfill Antifenatë e Lavdevet¹⁰”;

“E këtu soset officia e Adventit. Këtu zanë nfill të shtatat psalmet Peneciale. I pari anshtë kondra irësë, e thotë¹¹...”.

“E këtu sosënë të shtatë Pslamat të Pëndesëve. E tas ze nfill Vespëri për të vdekuniët¹²”.

“Këto janë dhjetë ordhëna qi neve na shkrou vetë Zotynë me dorë të vet. E këto janë ordhënat   Sinëzot, me u mbajtnë   gjithëkuj qi anshtë pagëzuem. Përse kush anshtë pagëzuom, aj i kërshenë grëshitetë, e christianus do me thashunë njeri qi ndjek vepëratë Krishtit. E i pari ordhënë ky anshtë. ¹³”.

“Këtu   sosnë të dhjetë ordhënatë qi   Sinëzot janë ordhënuom na ato me mbajtnë¹⁴”.

“Të zanëtë e nfilltë të Ungjillit shenjtë porsi shkrou Metheu¹⁵”.

“E mbasandaj ti, prift, bani kruq   ballë e mbi zemërë:

Merr, Gjon, shenjtë e Kryqsë¹⁶...”.

“Mer pakëzë krypë e shtjere ndë gojë djalit, tue thashunë¹⁷...”

“E tash mā njdëknë oratëtë qi thuhënë përmbi njanët e tjetrit¹⁸”.

“E tash prifti k  me marrë me dy gishta të t  pakëzë p htymë   gojet së t , tue prekuni undëtë djalit, e tue thashunë¹⁹”.

“Gjithë popullin e k rshenë nd  Arban t ata   mortajet largo, t  t  lusm , Zot²⁰”.

Nga ndërhyrjet dhe sqarimet e këtilla që i bën Buzuku mund të kuptohet se ai vendin kryesor ua la teksteve që i kishte zgjedhur dhe qenësisë së kuptimeve të tyre e jo fjalëve ose interpretimeve të tij.

Të të njëjtit lloj dhe cilësi janë edhe udhëzimet që Buzuku i bën ndërmjet shembujve me të cilat u drejtohen priftërinjve, që e kremtojnë Meshën e shenjtë, si, fjala vjen, *“Zgiedh Pistullin (Letr n) e Amonit Profet ”*, *“Zgiedh Pistullin Sh n Palit qi shkruan Xhudhivet”*, *“Zgiedh   s  Bameshit s  Apostojet” (V prat e Apostojve)*. K to ndërhyrje, që janë të shumta, dëshmojnë se Buzuku nuk ishte një prift i thjeshtë, po një udh heq s, një prelat kishtar. Them k shtu p r arsye se m  duket e pazakonshme q  një prift i r ndomt  t  u drejtohej prift rinjve t  tjer  (barinjve t  tjer  shpirt ror ) si duhej t  vepronin gjat  liturgjis , gjat  krezmimit ose gjat  rritit t  v nies s  kuror s s  shenjt  ose n  raste t  ngjashme.

Dy tekstet, q  po i sjell n  vijim (t  nxjerra nga transkriptimi i Eqrem  abejit t  botuar m  1968) janë d shmia e mjaftueshme t  thuhet se vepra e Buzukut e botuar m  1555, em ruar “Meshari”,  sht  hartim i tij e jo thjesht  p rkthim i teksteve biblike e liturgjike ose p rkthim nga ndonj  lib r konkret i natyr s s  *“Missale vulgare - Meshari popullor”*, q  u hartuan dhe u botuan qysh para koncilit t  Trentos (1545 – 1563).

N  pjes n – tekstin n  faqet 54 – 55 (sipas transkriptimit t   abejit), pasi thekson faktin se kishte p rkthyer disa nga Psalmet, Buzuku p rmend edhe emrin e vet, prind rit e tij dhe b n t  ditur se lutet p r ta e p r t  tjer t. Ai i drejtohet Krishtit q  ta liroj  nga m katet (sidomos ndaj m katit p r gruan) dhe ta ndihmoj  t  ec n rrug s s  drejt  t  Zotit:

“O Jezu Krisht, sh lbuosi i gjith  shekullit e shp rblesi i shpirt navet, Zot, regj i p mort, u t  t  lus, Dom Gjoni, sh rb tori uit, t  madhen  zot n  tandet  p fine p r k ta t  k nduom t  k tyne Psalme, qi u i p denji k ndova, ti t  m  liberonjsh shpirtin tem   katit, e ti v liz zem r n  teme p rap t    duorshiit s atyne qi p r t  keq ecnj n . E   s  kujtuomeshit s  p d rejta e t  p ligje ti libero korpn  tem, aj p r nden  sh rb tyr    kati me mos klen . E ti bdo   meje t  desh ruomit  e katit gruos . E   meje hiq gjith  t  p ligje qish i p em ni mund  shtjer  nd  mend, ansish qish duken  e ansish qi z duken , qi ata lypnj n  shpirtin tem me mbajtn  me mos me ecun  pr udh  t  Tin zot. O Zot, b si i gjith  shekullit, t  t  klofsha truam, qi me At t e me Shpirtin  shenjt  gjellin e jet, p r gjith  jet  t  jet s. Amen. Oratio.

Zot, ti qi bane qiell  e dh n , a fr  veti ven  orat t  e m . E p r t  madhet mish rier tande e p r t  k nduomit qi u t  k ndonj k ta Psalma sod, u i p denji tue t u lutuni u t  t  lus, muo shrb torit tit mbi k t  jet  ti t  denjonesh muo me m  dhan  sh ndet   mendjet e   korpit, e mot u me b m pendes n  p rpara mort s sime. E m  ban hir, Zot, me pasun  t  liruomit  e katevet mive. P rse u mbi tjet ret jet  me gjith  Shenjt  t  t  u t  mundinj me pasun  patrien  e jet s  amshuome. Amen. Oratio.

O Zot i gjall vet e i vdekunet, Sh lbuosi i gjith ve, qi ti z do mortn  e t p kat nuomit, ma aj t  konvertonet  e t  gjellinj ,  dijem , u t  t  lus, e m i af r  muo Dom Gjonit. E muo shkat ro t  shkruomit  e gjith  katet mive. E t  tue t u p lqyem, p rz  orat t  e m  qi u m t  p rd ot, p r muo e p r gjith  njer zit t  m   ngjakut sim, e p r miq t  m  e pr an miq t  m , p r t  gjall  porsi p r t  vdekurnit . Oratio.

O Zot, ti qi ord nove na me  nderun  at n  e am n , ki mish rier, t  tue t u p lqyem   shpirtit t  tat s  tim e t  mam s  sime, e atyne   ndije katet e tyne; e muo e ata na ban neve na me pasun  gaz mendn  e drit s  jet s  glat . P r Krishtin Zot tan . Amin²¹”.

¹⁶ Po aty, f. 69.

¹⁷ Po aty, f. 71.

¹⁸ Po aty, f. 75.

¹⁹ Po aty, f. 77.

²⁰ Po aty, f. 51.

²¹ Po aty, f. 54 – 5.



N  faqen 69 (sipas botimit t   abejit) Buzuku shkruan p r dymb dhjet  artikujt e fes  t  dh n  nga Kisha e shenjt . Duke e konkretizuar t  parin, thekson se ai u p rket atyre q  thon  se *duan t  b hen turq* (n nvizimi im). S’ka asnj  dyshim se edhe kjo pjes  e tekstit  sht  e Buzukut:

“E tash flasm  mbi t  d ymb dhjet  artikuj t  fes  qi neve   ansht  ordh nuom   Klishet shenjte.

E ky ansht  i pari kat: Aj qi nuk jet fort mbi f t t  Krishtit, por s  vgj n kun pak t  keq, ashtu thot : Vete banem turk²²”

3. N  baz  t  asaj q  u tha m  lart (meq  dukurin  e v shetroj n  nj  punim m  t  gjat ), mund t  thuhet p rmbledhtas sa vijon:

a) Vepra e Gjon Bdek Buzukut e botuar m  1555, e njohur si “Meshari”, nuk  sht  nj  meshar i mir fillt  (si   sht  vler suar e p rcaktuar, kryesisht, deri m  sot); nuk  sht  as lib r tipik liturgjik, as lib r tipik doktrinar (kanonik) e as lib r tipik lutjesh, antifonash e litanish. Vepra  sht  hartuar nga Buzuku, pra  sht  nj  zgjedhje – p rmbledhje tekstesh t  karakterit dhe llojeve t  ndryshme teologjike, e shtjelluar sipas nj  koncepti t  caktuar, q  p rligjet edhe nga pjes t – ndarjen q  autori i b ri librit, ku gjith  l nda lidhet ngusht  me besimin e krishter  t  mb shtetur n  Shkrimin e Shenjt  dhe n  tekstet e tjera liturgjik  e doktrinar  q  p rdoren gjat  vitit liturgjik te katolik t.

b) Nj  q mtim dhe studim m  i imt  i disa pjes ve t  ve anta t  librit t  Buzukut do ta p rligj  edhe m  shum  faktin se libri  sht  hartuar prej tij.

c) N  vepr n e Buzukut, pos pjes ve t  p rkthyer nga *Shkrimi i Shenjt  - Bibla*, nga librat e tjer  kanonik  dhe liturgjik , ka dhe pjes  t  krijuara nga vet  Buzuku, midis t  cil ve janë edhe rreth 400 ndërhyrje, q  si t  tilla b hen pjes  e pandashme dhe e qen sishme e vepr s. K tu duhet p rfshir  edhe shkrimi p rmbyll s, e em ruar *Pasth nia*, q  p rligj proz n e par  origjinale t  botuar n  gjuh n ton  t  zbuluar deri m  sot.

d) Deri sa t  mos gjendet teksti ose tekstet p rkat se konkrete nga Buzuku mund ta k t  p rkthyer vepr n e tij t  botuar m  1555, dhe p rmes krahasimeve t  im ta t  d shmohet se p rkthimi  sht  i nj jt  (identik), vepr n e tij e njohur deri me sot me titullin “Meshar” me plot arsye dhe me t  drejt  duhet ta  mojm  si vep r t  hartuar nga ai, pra vep r t  tij. Jan  me dhjet ra e qindra raste q  antologjit  – zgjedhjet e ndryshme, qofshin ato letrare ose t  natyrave t  tjera, t  jen   muar e t   mohen si vepra t  atij q  i ka zgjedhur, q  i ka hartuar. Natyrisht, n  rastin e vepr s s  Buzukut nuk duhet mohuar n  asnj   ast fakti se l nda – tekstet e marra nga Bibla dhe nga librat e tjer  kanonik  dhe liturgjik  janë p rkthime t  tij, n  qoft  se nuk do t  d shmohet se Buzuku shfryt zoi ndonj  p rkthim paraprak nga ndonj  p rkthim n  dor shkrim ose t  botuar t  autor ve t  m hersh m shqiptar . Them k shtu duke pasur parasysh t  dh n n e Pjet r Budit, i cili na b n t  ditur se brenda poezive t  tij q  i botoi m  1618 dhe 1621 kishte shfryt zuar edhe disa poezi n  dor shkrim t  Pal Hasit.

²² Po aty, f. 69.

⁸ Zeqirja Neziri, *Libri i par  shqip dhe bashk koh sia*. N  “Buzuku dhe shkrimet e hershme shqipe”. Sesioni shkencor nd rkomb tar p r gjuh n dhe let rsin  shqiptare. Universiteti i EJT, Tetov , 18, 19 dhe 20 mars 2005, Tetov  2006, f. 134.

⁹ “Meshari i Gjon Buzukut (1555)”. Botim kritik. Punuar nga Eqrem  abej. Pjesa e dyt . Faksimile dhe transkribimi fonetik. Tiran  1968, f. 33.

¹⁰ “Meshari i Gjon Buzukut (1555)”. Pjesa e dyt , vep. e p rm. f. 35.

¹¹ Po aty, f. 35.

¹² Po aty, f. 55.

¹³ Po aty, f. 61.

¹⁴ Po aty, f. 65.

¹⁵ Po aty, f. 107.

Albanologu i njohur zviceran

BASIL SCHADER:

MË VJEN KEQ NGANJËHERË, PËR NJOHURITË PAK TË KUFIZUARA TË GJUHËS STANDARDE SHQIPE TË BREZIT TË DYTË A TË TRETË TË MËRGIMIT SHQIPTAR

Intervistë dhënë gazetares Mimoza Hasani Pllana

Duke qenë se Zvicra është një nga shtetet europiane me numër të madh emigrantësh nga vendet e ndryshme të Ballkanit dhe më gjerë, botërisht është e njohur për shumëgjuhësinë dhe tolerancën ndërkulturore. Zvicra është edhe një nga vendet ku është përqëndruar një pjesë e madhe e mërgatës shqiptare, në veçanti nga Kosova, të cilët zgjodhën këtë vend miqësor dhe demokratik pas përkeqësimit të situatës socio-politike në Kosovë. Përveç se Zvicra pranoi mijëra shqiptarë duke u ofruar siguri dhe kushte të mira jetese, në përmasa të kufizuara përkrahu edhe Lidhjen e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë në Zvicër, "Naim Frashëri", për organizimin e mësimin plotësues në gjuhën shqipe, si gjuhë amtare për fëmijët shqiptarë. Programet dhe sidomos, tekstet (librat shkollorë) për mësimin plotësues në gjuhën shqipe gjetën përkrahje edhe nga profesorë zviceranë. Të cilët me përkushtim dhe vullnet orientuan punën e tyre për zhvillimin e programve të reja, implementimin e atyre që ishin hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë. Kur kërkojmë për mësimet dygjuhëshe, është mbresëlënëse puna disa vjeçare e profesorit dhe albanologut Basil Schader në lidhje me përkrahjen e mësimin plotësues shqip. Më vonë profesor Schader, përveç mësimdhënjes dhe studimit të gjuhës shqipe, u përkushtua edhe për përkthimin e letërsisë shqipe nga autorë të Kosovës e Shqipërisë.

MIMOZA HASANI PLLANA: I nderuar profesor Schader, keni doktoruar për gjermanistikë në Universitetin e Cyrihut dhe për albanologji në Universitetin e Tiranës, çfarë ju ka shtyrë ju që të studioni gjuhën shqipe krahas asaj gjermane?

BASIL SCHADER: Që prej vitit 1990 fillova të merrem me pedagogjinë ndërkulturore dhe planifikova të botoj një tekst shkollor për klasat e shumta shumëgjuhësore që i kemi në Zvicër, ku përafërsisht 1/3 të nxënës/eve është me prejardhje jozvicerane. Meqenëse a) shqiptarët përfaqësojnë grupin më të madh të imigrimit të ri në Zvicër, b) të paktën në vitet 1990 nuk kishin një lobi si p. sh. italianët dhe c) unë personalisht kisha dëshirën të mësoj një gjuhë të re, të rëndësishme në kontekstin ndërkulturor të Zvicrës, zgjodha gjuhën e bukur shqipe.




Në fillim e mësova si autodidakt me një libër mësimi, pastaj – sa për përdorimin me gojë – me një shqiptar nga komuna ime dhe më në fund i kreu studimet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Tiranës, nën udhëheqjen e profesorit, Akademikut dr Gjovalin Shkurtaç, të cilin, ndërkohë, e kam mik të ngushtë dhe shumë të çmuar.

M.: Keni një përvojë të gjatë si profesor i gjuhës gjermane në shkollën e lartë pedagogjike të Cyrihut, a ju kujtohet nëse keni pasur studentë shqiptarë të interesuar për studime pedagogjike dhe gjuhë gjermane?

B.S.: Patjetër kisha studente dhe studentë shqiptarë në seminarin e mia dhe mund të them se ato/ata kanë qenë pjesë të studentëve/eve të mi të motivuar dhe me angazhim të jashtëzakonshëm. Ky fakt më gëzoj sidomos për dy arsye: së pari, sepse ai dëshmon që edhe shqiptarë/e bëjnë gjithnjë e më shumë karriera të bukura në profesione me kërkesa të larta në Zvicër, së dyti, sepse jam shumë i lumtur që do të kemi mësimdhënës/e me prejardhje shqiptare në shkollat tona – mësimdhënës/e të cilët/at janë tepër të rëndësishëm e të dobishëm jo vetëm për sa u përket nxënësve shqipfolës të tyre, por edhe si ndërmjetës kulturorë me përvojë autentike në shkollat tona shumëkulturore dhe shumëgjuhësore. Çka më vjen keq nganjëherë, janë njohuritë pak të kufizuara të gjuhës standarde shqipe të brezit të dytë a të tretë të mërgimit shqiptar.

M.: Zvicra është nga shtetet më të fuqishme që ka mbështetur hartimin dhe zhvillimin e teksteve mësimore në gjuhën shqipe si gjuhë e origjinës së qytetarëve të saj, shqiptarë. Kontributi juaj në këtë fushë është i jashtëzakonshëm, sa është sfiduese kjo punë e madhe që keni bërë dhe bëni për të përkrahur mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë të dytë?

B.S.: Patjetër kjo ka qenë një punë sfiduese, mirëpo po ashtu shumë e kënaqshme. Koordinimi dhe udhëheqja e grupeve të autorëve që kanë bashkëpunuar në këto projekte nuk ishte gjithmonë i kollajtë, mirëpo të gjitha diskutimet dhe debatet u zhvilluan, gjithmonë, në një klimë dashamirëse dhe jopolemike. Përveç kësaj, nuk



isha vetëm në udhëheqjen e projekteve përkatëse: kisha si bashkëudhëheqës nga ana e Ministrisë së Arsimit të Kosovës, miqtë e mi të mirë Nuhi Gashin dhe të ndjerin Arif Demolli; të dy tepër të angazhuar, me disiplinë e etikë tepër të lartë të punës. Ky bashkëpunim me siguri ka qenë edhe një parakusht i rëndësishëm për suksesin e projekteve tona shumëvjeçare.

M.: Keni realizuar shumë hulumtime në lidhje me mësimdhënien e gjuhës shqipe si gjuhë e origjinës si dhe krahasimet e dialekteve me gjuhën standarde shqipe. Si i vlerësoni këto dallime, sa e vështirësojnë ato mësimin dhe përdorimin e gjuhës standarde?

B.S.: Dallimet mes gjuhës letrare shqipe dhe dialekteve të ndryshme mund të përfaqësojnë një vështirësi të konsiderueshme sidomos për ata fëmijë shqiptarë në mërgim të cilët nuk shkojnë në mësimin plotësues të gjuhës shqipe. Meqenëse ata – sidomos ata fëmijë që vijnë nga familje pa shumë arsim – e zotërojnë gjuhën amtare vetëm në dialekt, në trajtën e folur dhe nganjëherë me një fjalor të kufizuar në tema familjare, rreziku nuk është i vogël që ata të mbeten analfabetë në gjuhën e tyre amtare dhe që ta humbasin gjuhën amtare pas 2-3 brezash. Me rëndësi të parë do të ishte, pra, që sa më shumë nxënës/e shqiptarë në mërgim të shkonin në mësimin plotësues të shqipes. Fatkeqësisht, shumë prindër nuk janë të ndërgjegjshëm për këtë dhe fatkeqësisht mësimi plotësues në shumë vende (edhe në Zvicër) nuk është integruar si duhet në sistemin shkollor të rregullt. Për sa u përket "dygjuhësisë së brendshme", pra me dialekte dhe gjuhën letrare, ne kemi të njëjtin fenomen edhe në Zvicrën gjermanishtfolëse, ku ekzistojnë njëkohësisht dhe paralelisht dialektet zvicerane dhe gjuha letrare gjermane, të cilat dallojnë mjaft në mes tyre. Si autodidakt i gjuhës jam i ndërgjegjshëm për këtë problematikë dhe kam zhvilluar edhe një fletore didaktike, e cila merret veçanërisht me këtë fushë, duke u dhënë mësuesve impulse si mund ta trajtojnë këtë tematikë në mësimin e tyre (shih <https://myheritagelanguage.com/sq/>, fletorja "Rreth përdorimit të dialektit dhe gjuhës standard").

M.: Një pjesë e studimeve tuja janë të bazuara në kontaktet mes gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane, a mund të përmendim disa rezultate rreth kontaktit, bashkëveprimin midis këtyre dy gjuhëve?

B.S.: Kontakti gjuhësor midis gjuhës amtare dhe gjuhës së vendit të imigrimit ndodhet kudo, qoftë midis shqipes dhe gjermanishtes në vende gjermanishtfolëse, qoftë midis shqipes dhe italishtes në Itali etj. Si pasojë mund të rezultojnë përzierje të gjuhëve në përmasa të ndryshme, të quajtura në linguistikë "code-switching" ose "code-mixing". Është një dukuri e natyrshme dhe pa rrezik – nëqoftëse të dy gjuhët ruhen dhe kultivohen edhe veç e veç (p. sh. në mësimin plotësues të gjuhës shqipe). Përndryshe përzierja e gjuhëve mund të kontribuojë në humbjen e gjuhës amtare. Sidoqoftë, besoj se duhet të tregohemi tolerantë ndaj code-switchingut, sepse ai i korrespondon 100% situatës së rritjes së fëmijëve në mërgim në një ambient dygjuhësor. Shpesh herë ky fenomen edhe zhduket pas disa viteve. Në vend të ndalimeve dhe qortimeve më shumë duhet t'i stimulojmë fëmijët që ta kultivojnë gjuhën amtare të tyre edhe në mënyrë jo të përzier.

M.: Përveç se jeni autor i librave shkencorë dhe atyre didaktikë, gjatë karrierës suaj keni përkthyer edhe autorë të letërsisë shqipe në gjuhën gjermane, a mund të na thoni cilët janë autorët tuaj të pëlqyer të kësaj letërsie?

B.S.: Kam përkthyer gjermanisht kujtimet e mrekullueshme të Arif Demollit me titull “Të gjallët e të vdekurit e një fëmijëri” (gjermanisht: Es war ein Dorf in Kosova. Die Lebenden und die Toten meiner Kindheit), romanin “Një grua nga Tirana” të Elena Kadasës, dhe librin “Emi-, Immi-, Remigrant” të Mahir Mustafës. Ndër autorët dhe autoret shqiptarë ka shumë që më pëlqejnë fort; më mirë mos të filloj fare me përpilimin e një liste përkatëse! Desha vetëm të përmend që, përveç autorëve të letërsisë artistike, ka edhe autorë shkencorë shqiptarë të shkëlqyeshëm.

M.: Sipas mendimit tuaj, sa është e njohur letërsia (shqipe) e Kosovës dhe Shqipërisë nga lexuesi zviceran, apo cilët autorë pëlqehen?

B.S.: Janë përkthyer mjaft autorë dhe autore shqiptare gjermanisht, ndër të cilët/at Rexhep Qosja, Fatos Kongoli, Besa Myftiu, Lindita Arapi, Ornela Vorpsi, Arif Demolli etj. Më i njohuri shkrimtar shqiptar është Ismail Kadare, ndër shkrimtarët ndoshta Elvira Dones. Shumica e librave kanë dalë në shtëpi botuese më shumë të vogla e të specializuara, të cilat për fat të keq as nuk kanë buxhete të majme për ta bërë të njohur letërsinë shqiptare sa duhet.

M.: Tani, në shumë kantone zvicerane është organizuar shumë mirë mësimi i gjuhës shqipe në nivelin e arsimit parauniversitar, po në arsimin e lartë?

B.S.: Në arsimin e lartë mbetet akoma shumë për t’u bërë (mirëpo po ashtu në mësimin parauniversitar, për fat të keq). Mirë do të ishin kurse për gjuhën letrare shqipe për studentë/e me prejardhje shqiptare (sepse ata/ato nganjëherë nuk e zotërojnë shqipen letrare si duhet); më mirë do të ishte instalimi i një katedre për gjuhën shqipe në njërin prej universiteteve zvicerane. Të paktën kanë filluar disa projekte shkencore rreth suksesit shkollor të fëmijëve shqiptarë dhe për aspekte të ndryshme të diasporës shqiptare në Zvicër.

M.: A mund të na thoni çfarë jeni duke lexuar apo punuar aktualisht në lidhje me albanologjinë, përkthimet letrare apo tekstet didaktike në gjuhën shqipe?

B.S.: Në radhë të parë, momentalisht, merrem me serinë e teksteve didaktike për mësimin plotësues dhe me uebfaqen përkatëse (<https://myheritagelanguage.com/sq/>), e cila, me sa shpresoj, do t’i përkrahë mësimdhënës/e në punën e tyre kërkuese. Përveç kësaj, jam në kontakt të vazhdueshëm me mikun tim të madh, Akademikun prof. dr Gjovalin Shkurtaç në Tiranë, me miqtë e mi shqiptarë në Kosovë dhe në Zvicër. Libri shqip që jam duke lexuar është romani “Secili çmendet simbas mënyrës së vet” të Stefan Çapalikut.

*

BASIL SCHADER, u lind më 1951 në Cyrih. Më 1971-73 ndoqi studimet latinishtes e të greqishtes në Tybingen dhe Cyrih, të cilat nuk i mbaroi. Pastaj, vazhdoi studimet për mësuesi në Cyrih. Më 1976-81 punoi mësues në ciklin e ulët në fshatin Hinwil të Cyrihut dhe paralelisht ndoqi studime të gjermanistikës dhe pedagogjisë në universitetin e Cyrihut, të cilat i mbaroi deri në nivelin master. Nga viti 1982 deri më 2016 punoi si profesor i gjuhës amtare në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Cyrihut (themelues i degës ‘gjermanishtja si gjuhë e dytë’). Më 1985 mbaroi studimet doktorale në fushën e gjermanistikës. Më 1989 mbaroi masterin e dytë në fushën e etnologjisë europiane. Më 1996 botoi tekstin shkollor ‘Shqip’ së bashku me Femzi Brahën. Nga viti 2000-2005 ndoqi studime (me korrespondencë) të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Tiranës. Më 2005 doktoroi me temën ‘Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër’ nën udhëheqjen e Akademik Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç. Prej vitit 2017 është pensionuar, por vazhdon me punë në projekte të ndryshme dhe me përkthime. Është anëtar i shumë komisioneve zvicerane dhe ndërkombëtare, udhëheqës i projekteve në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, është autor i librave didaktike, hulumtimeve shkencore, teksteve shkollore, përkthimeve nga gjuha shqipe etj. Po ashtu, për veprën e tij të çmuar është zgjedhur anëtar nderi i Lidhjes së Arsimtarëve dhe Prindërve Shqiptarë në Zvicër ‘Naim Frashëri’ dhe qytetar nderi i komunës së Balldrenit. Prej vitit 1996, së bashku me bashkëshorten Erica janë të angazhuar në projekte për renovimin dhe ndërtimin e shkollave në rrethin e Lezhës.

NJË BILETË FALAS PËR BARCELONË

Tregim nga Mehmet Elezi

Sekretarja u ndal nën një ulli. Dora e kthyer bërryl shtrëngonte dosjen e ditës. Ullinjtë në oborrin e vilës së shefit ishin krasitur të tërë njësoj, thua kishin qenë në floktore. Dalloi së largëti shpinën e tij ndërmjet degëve, nën *T-shirtin* me stemën e një ekipi italian të futbollit. Pantallonat e shkurta, të kuqe, i flakëronin. Shefin e kemi *cool*. Dyqind metra më tej merrte frymë deti. Zhaurima e valëve vinte e zbutur. Sekretarja ndjeu se i qe kapur këmisha diku lart mbi gju dhe përvodhi me sy anash. Lëshoi dosjen mbi një vazo lulesh, u përkul dhe me një lëvizje jo aq elegante ngriti cepin e fundit. Këmisha e ngecur diku mbi gju ra në vend. Tej shëtiste shefi. Me një thupër të hollë në dorë, si thupërz pushke. Kalimthi fisklonte ndonjë trung, ashtu kot.

Sekretarja ndenji në hije, statujë e valëzuar me dosje në dorë. Shefi doli në rruginën mes ullinjve dhe shpejtoi hapin. Gjithnjë me shpinë nga sekretarja, duke u larguar. Shqiptoi diçka. Asaj i tingëlloi sikur i bërtiti dikujt. Sikur iu drejtua me një fjalë të pahijshme. Do ta kem dëgjuar gabim. Shefi rrahu ajrin me fiskël dhe hungroi. Ajo e dëgjoi sërish atë fjalën e pahijshme. Me mua e ka? Nuk. Shefin e kemi artist. Një natë kishte postuar në feisbuk një foto të denjë për një emër të madh të artit. Dielli duke u rrëzuar në zgrip të ujërave, në perëndim, pak më lart një hënë vajzuke, këmbëhollë, si e veshur me minifund. Natën e mirë, mik, i thoshte shefi diellit. Të pëlqeu fotoja?, e pyeti të nesërmen sekretaren, kur ajo erdhi me dosjen. Njerëzit u habitën, tha ajo. Si i ka kapur edhe diellin edhe hënë aq pranë njëri-tjetrit, në të njëjtin muzg? Dhe thjesht me telefon, jo me fotoaparatur profesional! Po të mos ishte shefi, do të thoshnim është montazh. Njerëzit janë budallenj, tha ai. Ç’ne montazh, ç’nevojë kish për montazh. As diell s’kishte aty. Qe një llampë, në trajtë globi, mes pishave. Ajo dhe hëna.

Tej shefi vazhdonte lehtinën. Oborri i vilës mjaft i gjërë, më shumë kopsht se oborr. Herë pas here rrahte rruginën me majë të fisklës. I mëshonte dhe shqiptonte diçka. Njëpërdhëmbte atë fjalën e pahijshme. Zëri vinte si hungrimë.

Do ta kem dëgjuar gabim, tha rishtazi ajo, pasi ia dorëzoi dosjen. Shefi iu duk në formë. Shpesh burrat e mëdhenj mendojnë me zë. Burrat si shefi janë të rrallë.

Sekretarja erdhi prapë një ditë më pas, në të njëjtën orë. Shefi po bënte të njëjtën shetitje përmjedis të njëjtëve ullinj. Vetëm qielli nuk qe i njëjti. Qiellin e kish mbuluar një lëpë e shpërlarë, pa shije. Vransinë, pa hije ullinjsh. Shefi nuk po nxitonte. Nuk po e priste ajrin me thuprën e hollë. Nuk e

shqiptoi atë fjalën e pahijshme. Kushedi me kë e ka pasur dje, tha sekretarja. Shefi mendon me zë. Burrat e mëdhenj mendojnë me zë.

Kur erdhi në nesret, me dosjen plot, shkëlqente dielli. Shefi vijonte shetitjen nëpër rruginën e përmbytur me rreze. Përpara shkonte hija e tij e gjatë. Shefi shpejtoi hapin. Rrahu me fiskël barin përpara dhe shqiptoi atë fjalën e pahijshme. Po grindet me dikë, tha sekretarja. Dhe ky dikush është femër. Në gji i lëvizi një ndjesi e përzier.

Katër ditë rresht skena u përsërit pikë për pikë.

Ditën e pestë u shtua një ndodhi. Përskaç vilës së shefit kalonin çdo mbasditë do të rinj të zhurmshëm, dukeshin si studentë. Kthenin kryet kah vila për kërshtëri, i thoshin ndonjë fjalë shoqi-shoqit, duke e këqyrur me bisht të syrit shefin me pantallona të shkurta me ngjyra të ndezura, që bënte tifo për skuadrën italiane, dhe merrnin nga deti. Njëri prej djemve nuk u turr nga deti. U ndal dhe hodhi në feisbuk një video tri sekonda. Në video shefi ecte me hap të shpejtë dhe i mëshonte me thupër rruginës para vetes, sikur donte me vra një hardhucë. Se ç’murmurinte. Nga tërë çka shqiptonte, në video kuptohej vetëm fjala *kurvë*. Kujt po ia lëshon ky zotnia atë fjalë çnderuese? Kaq qe videoja. Një fakt dhe një pyetje.

Të nesërmen sekretarja erdhi me dosjen nën sqetull, pa ditur çqëndrim me mbajtë. Me u shti sikur nuk dinte për videon? E kishin botuar portalet. Gjithfarë komentesh, nuk numroheshin. Ndoshta shefi do ta ketë thirrur komandantin e gardës. Kaptërr në prapavijë do të shkosh, more vesh?! Pse lejon me u afrue njerëz pranë vilës e me ba këso montimesh të pafytyra? Njerëzit që i shohin kanë nivelin tënd, e ndajnë dot ata çka është e njëmendtë e çka e sajuar?

Videoja tri sekonda paskesh qenë vetëm antipasta. Pjata kryesore erdhi fill mbrapa. Pa kaluar njëzet e katër orë portalet gëlonin me një video tjetër. Kësaj here regjistruar me dron. Në video shefi duke u kthyer rruginës kryesore të oborrit. Me hap të shpejtë. Përpara, hija e tij e gjatë. Ai e ndjek hijen e tij të gjatë. Nuk e mbërrin dot. I mëshon me thupër fort, sikur po mbyt tashmë jo hardhucë, por gjarpër. Kot e ke, nuk më ik dot, moj kurvë, i thotë hijes së vet. S’ke të gjallë pa mua.

Videoja përfundonte me një pyetje: ky që kemi mbi krye është një i mençur apo një i marrë? Kush e gjen, fiton një biletë falas për të parë ndeshjen me Realin në Barcelonë!



GIORGIO CAPRONI

Leu në Livorno në 1912 ndërsa rininë e kaloi në Gjenova ku studioi për violinë në konservatorin «Giuseppe Verdi».

Në vitin 1933, gjendet në San Remo ku kryen shërbimin ushtarak. Pikërisht në këtë vit mbërriti ma në fund me botue edhe dy vjershat e para, njëra nga të cilat është «Vespro» – *Mbramsorja* që po botohet këtu. Në këtë periudhë të jetës njihet edhe me shkrimtarin tjetër të njohur Giorgio Bassani.

Me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1939, mobilizohet dhe dërgohet në frontin perëndimor. Pas kapitullimit të Italisë, kaloi në zonën e kontrollueme nga partizanët në Val Trebbia, Piacenza. Në vitin 1945 shpërngulet në Romë, ku punon si mësues i shkollës fillore deri në vitin 1973. Gjatë kësaj periudhe, njihet me shkrimtarët Vasco Pratolini dhe Pier Paolo Pasolinin.


Ashtu siç e kishte parashikue në vjershën e tij «Ascensore» – *Ashensori*, ndërroi jetë në Gjenovë me 22 janar 1990, qytet që e kishte përcaktue si «qyteti im i vërtetë.»

Ndër vëllimet e tija poetike më të njohura janë «Ballo a Fontanigorda» (1938), «Il passaggio di Enea» (1956), «Congedo del viaggiatore cerimonioso» (1965), «Il conte di Kevenhuller» (1985) etj.

Vjershat e përkthyme këtu janë marrë nga vëllime të ndryshme poetike si: «Come un allegoria» – *Si një alegori*, «Ballo a Fontanigorda» – *Vallëzim në Fontanigordë*, dhe «Il Passaggio di Enea» – *Të kaluemit e Eneut*.

Secili prej nesh e kundron peizazhin artistik në mënyrë të pavarur, prandaj edhe përkthyesi këtu do t'i shmanget kritikës artistike së këtij shkrimtari duke ia hedhur në prehër këtë detyrë lexuesit-shijues të poezisë.

Përktheu dhe përgatiti Arben Ndreca



MARZO

Dopo la pioggia la terra
è un frutto appena sbucciato.

Il fiato del fieno bagnato
è più acre – ma ride il sole
bianco sui prati di marzo
a una fanciulla che apre la finestra.

MARS

Mbas shiut dheu
asht si fruta të porsaqërueme

Fryma e sanës së vesueme
asht ma e tharbët – por i qesh dielli
i bardhë mbi livadhet e marsit
një vashëze që hap dritaret.

VESPRO

La fila lunga dei soldati
è passata; sul prato è rimasto
aspro l'odore dell'erba
pestata – e l'eco
d'un canto nell'aria serale.

Ad occidente, nel fuoco
bianco d'un astro, scompare
l'ultima rondine. A poco
poco, sbiadisce il giorno
(ricordo d'uomini e di giardini)
nella memoria stanca della sera.

MBRAMËSORE

Rreshti i gjatë i ushtarëve
kaloi; mbi livadh qëndroi
e ashpër aroma e barit
të shkelun – dhe jehona
e një kange në ajrin që muzget.

Kah prendimi, në zjarrin
e bardhë të një ylli, zhduket
dallëndyshja e fundit. Pak nga
pak, shkimbet dita
(kujtim njerëzish e lulishtesh)
në kujtesën e lodhun të mbramjes.

SEI RICORDO D'ESTATE

Sei ricordo d'estate
nella casa sorpresa quieta
presso aromatiche sere,
quando il rondone rade
il canale, e cade
strano nella frescura un suono
da sonagliere randagie
di cavalle in sudore.

Come un allegoria (1932-1935)

JE KUJTIM VERET

Je kujtim veret
në shtëpinë e zanë befasisht në heshtje
buzë mbramjeve të erakandshme
kur dallëndyshja rrafsh
me kanalin flatron dhe, pikon
i çuditshëm në fresk një tingull
zilesh endacake
pelash të ndjersuna.

Si një alegori (1932-1935)



A RINA

Nell'aria di settembre (aria
d'innocenza sul chiareggiato
colle) sopra le zolle
ruvide mi sono care
le case a colori grezzi
del tuo paese natale.

Scherzano battendo l'ale
candide sui tetti a fiore
giunti, le colombelle
nuove.

Mentre commuove
dei voli l'aria il giro
tondo, nel cielo ai tocchi
festevoli delle campane
è il lindore dei tuoi virginei
occhi.

Ballo a Fontanigorda (1935-1937)

RINËS

Në ajrin e shtatorit (ajri
i pafajsisë mbi kodrën
e zbardhueme) mbi plisat
e ashpër, të shtrenjta janë për mue
shtëpitë me ngjyra rishtare
të vendlindjes sate.


Lodrojnë e rrahin flatrat
e bardha mbi çatitë buzë
më buzë, pëllumbeshat
e reja.

Ndërkaq përsillet
ajri i fluturimeve roza-rozina,
e në qiell në rrahjen
e galdueshme të kumbonëve
asht dlihtësia e syve të
tu virgjinorë.

Vallëzim në Fontanigordë (1935-1937)

ALBANIA	L'ASCENSORE	ASHENSORI
Quanti gabbiani chiari – bianchi, neri – a Bari! Sul mare che pullulava di polpi neri, urlava (lungo la palizzata freddissima e soleggiata) il cuore sbigottito in un silenzio inaudito. Mio padre era finito e solo (a letto) a Bari. E s'io non muovevo un dito per lui, gli autobus (rari sul lungomare) umani avevano di quei gabbiani gli squittii rotti - a Bari. Assaporava molluschi la guardia di finanza: guardava con gli occhi lustri il collo di una ragazza. Ma io ero da me via, e di passaggio, a Bari: piangevo in quell'albania di gabbiani – di ali.	Quando andrò in paradiso non voglio che una campana lunga sappia di tegola all'alba – d'acqua piovana. Quando mi sarò deciso d'andarci, in paradiso ci andrò con l'ascensore di Castelletto, nelle ore notturne, rubando un poco di tempo al mio riposo. Ci andrò rubando (forse di bocca) dei pezzettini di pane ai miei due bambini. Ma là sentirò alitare la luce nera del mare fra le mie ciglia, e ... forse (forse) sul belvedere Dove si sta in vestaglia, chissà che fra la ragazzaglia aizzata (fra le leggiadre giovani in libera uscita con cipria e odor di vita viva) non riconosca sotto un fanale mia madre. Con lei mi metterò a guardare le candide luci sul mare. Staremo alla ringhiera di ferro – saremo soli e fidanzati, come Mai in tanti anni siam stati. E quando le si farà a puntini, al brivido della ringhiera, la pelle lungo le braccia, allora con la sua diaccia spalla se n'andrà lontana: la voce le si farà di cera nel buio che la assottiglia, dicendo «Giorgio, oh mio Giorgio caro: tu hai una famiglia.» E io dovrò ridiscendere, forse tornare a Roma. Dovrò tornare a attendere (forse) che una paloma blanca da una canzone per radio, sulla mia stanca spalla si posi. E infine (alfine) dovrò riporre la penna, chiuder la càntera: «È festa», dire a Rina e al maschio, e alla bambina. E il cuore lo avrò di cenere udendo quella campana, udendo sapor di tegole, l'inverno dell'acqua piovana. * Ma no! Se mi sarò deciso un giorno, pel paradiso io prenderò l'ascensore di Castelletto, nelle ore notturne, rubando un poco di tempo al mio riposo.	Kur të shkoj në parriz Nuk due veçse një kumbonë të rrahin me amë tjegullash në mëngjes – ujit të shiut. Kur ta kem vendosë me shkue, në parriz do të shkoj me ashensorin në Castelletto, në orët e natës, tue i përvjedh pak kohë pushimit tim Do të shkoj tue i hjekë (ndoshta nga goja), kafshata buket dy fëmijëve të mi. Por atje do të ndjej frymën e dritës së zezë të detit Ndër qerpikët e mi, dhe ... mbase (mbase) në belveder ku qëndron veshun në rëshë kushedi, ndoshta ndër të rinjtë e nxitun (ndër të rejat fisnike në dalje të lirë jashtë lye e zbukurue me aromë jete të gjallë) ndoshta dalloj nën një dritë tem amë. Me të do të vëzhgoj dritat e dlira në det. Do të rrijmë te parmaku hekurit – vetëm do të jemi dhe të fejuem, sikur kurr nuk kemi qenë ndonjëherë. Dhe kur t'i ngrihet puçrrizë nga drithma e parmakut, lëkura e krahëve, atëherë me shpatullën e saj të akullt do të shkojë larg: zani do t'i bahet si dyllit në terrin që ia hollon, tue thanë: «Giorgio, oh mio Giorgio caro: ti ke familje.» Ka me m'u dashtë me zdrypë, ndoshta me u kthye në Romë. Mbase do të pres rishtas (mbase) që një pëllumb i shkruem nga një kangë në radio, të peshojë në shpatullën time të lodhun. Dhe në fund (në fund), do të uli penën, do të mbylli sirtarin: «Asht festë», do t'i them Rinës edhe vajzës, edhe djalit. Dhe zemra do më bahet hi tue ndie atë kumbonë, tue ndi atë amë tjegullash, dimnit ujit të shiut. * Oh, jo! Nëse do të vendosi një ditë, për në parriz do të hypi në ashensorin në Castelletto, në orët e natës, tue i vjedhë pak kohë pushimit tim.
Em atë kishte zanë, madje vetëm, (shtratin) në Bari. E sikur unë të mos luejshe kambët për të, autobusët (të rrallë përgjatë bregdetit) njerëzore kishin, si ato pulbardha, këlthitjet e thyeme – në Bari. Shijonte midhje roja e financës: vështronte me sy maçokut qafën e një vajze. Por unë isha larg vetes dhe kalimtar, në Bari: vajtojshe në atë zbardhullim pulbardhash – flatrash	Ruberò anche una rosa che poi, dolce mia sposa, ti muterò in veleno lasciandoti a pianterreno mite per dirmi: «Ciao, scrivimi qualche volta,» mentre chiusa la porta e allentatosi il freno un brivido il vetro ha scosso. E allora sarò commosso fino a rompermi il cuore: io sentirò crollare sui tegoli le mie più amare lacrime, e dirò «Chi suona, chi suona questa campana d'acqua che lava altr'acqua piovana e non mi perdona?» E mentre, stando a terreno, mite tu dirai: “Ciao, scrivi,” ancora scuotendo il freno un poco i vetri, tra i vivi viva col tuo fazzoletto timida a sospirare io ti vedrò restare sola sopra la terra: O proprio come il giorno stesso che ti lasciai per la guerra. <i>Il Passaggio di Enea (1943-1955)</i>	Do të vjedh edhe një drandofille që mandej, o nusja e ime e mirë kam me ta shndërrue në helm tue të lanë te dera butshëm tue më thanë : «Ciao, më shkruiej ndonjëherë,» ndërsa me derën që mbyllet dhe frenat që lëshohen një e rrëqethun trand xhamin. Atëherë do të mallëngjehem deri sa ta coptoj zemrën: do të rrokullisen mbi tjegulla lotët e mi ma të hidhun, e do të them: «Kush e rrahë, kush e rrahë këtë kumbonë ujit që lanë tjetër ujë shiut dhe nuk më fal?» Dhe ndërsa, tue ndejë përtokë e butë, do më thuesh: «Ciao, shkruiej,» ende tue shkundë frenat pak xhamat, ndër të gjallët e gjallë me shaminë tande tue marrë frymë drojtshëm unë kam me të pa që rrin e vetme mbi tokë : shì ashtu si ditën kur të lashë për me shkue në luftë. <i>Të kaluemit e Eneut (1943-1955)</i>





TË GJESH TË NJERËZISHMEN DHE PËRULËSINË TE ALBERTO GIACOMETTI

Gunnhild Øyehaug mbi një nga skulptorët
më të mëdhenj të shekullit të XX

Ka kaluar një kohë shumë e gjatë që kur zvicerani Alberto Giacometti dhe vëllai i tij, Diego, çuan një karrocë dore me sendet e tyre për në Paris, ku ai filloi një jetë të re si skulptor në një studio, e cila me kalimin e kohës u bë gjithnjë e më e rrëmujshme, e mbushur me gjithnjë e më tepër skulptura (përfytyroj unë) (por kam parë edhe fotografi të saj), ku, për ca kohë, ai u frymëzua veçanërisht nga surrelizmi, por më pas iu kthye skulpturave tradicionale, për neverinë e André Breton, i cili e talli: “Të gjithë e dinë se ç’pamje ka një kokë” – ka kaluar vërtet shumë kohë që kur ai jetoi jetën që solli kaq shumë skulptura – sepse edhe pasi ai flaku shumë prej tyre, vazhdoi të prodhonte të tjera, ca të mëdha, ca tejet të vogla, të gjitha shumë të holla – e që gjithashtu solli kaq shumë tekste dhe libra mbi Giacometti-n dhe skulpturat e tij (ja dhe një tjetër) – ka kaluar një kohë jashtëzakonisht shumë e gjatë nga atëherë e deri te momenti kur unë përulëm përpara diçkaje që më kap syri, ndërkohë që eci përgjatë një korridori të ngushtë në Muzeun e Artit Modern të Luizianës, në kërkim të një dhome ku do të zhvillohet një ngjarje letrare, saqë të krahasosh distancën ndërmjet asaj kohe dhe tani me, për shembull, distancën mes tokës dhe hënës, thjesht nuk është e mjaftueshme, sepse hapësira ndryshon nga koha.

Asgjë nuk është aq e pamëshirshme dhe e pakapërcyeshme sa koha, ndoshta prandaj asnjëra nga këto – as mbërritja e Giacometti-t në Paris, as rraskapitja e tij e përditshme me skulpturat përgjatë gjithë jetës, ecejaket lartë e poshtë studios së tij, zhvillimi i tij artistik, rutina e

tij e përditshme apo pamja nga dritarja – nëse kishte të tillë – ku ndoshta shihet pëllumbat teksa uleshin në ndonjë çati aty pranë, asgjë nga këto nuk kishte rëndësi ndërkohë që unë nxitoj nëpër korridor. Nuk orientohe dot, e mendoj se te një nga dhomat përtej ekspozitës së Giacometti-t po zhvillohet një aktivitet me Sally Rooney-n, por nuk kisha ndërmend të ndaloja, dhe këto lëvizjet e mia përmes korridoreve të Muzeut të Artit Modern të Luizianës do të kishin humbur nëse nuk do të kisha shkruar për to këtu – por le të kthehemi te Giacometti. E kisha parë Giacometti-n më përpara, e bashkë me Yves Klein dhe Anselm Kiefer i përkasin një periudhe të jetës sime që unë e quaj rini, por që është në fakt periudha e shkurtër mes moshës 20 dhe 23 vjeç, kur zbulova, me gjithë intensitetin e rinisë sime, blunë e Klein-it, raftet e librave të Kiefer-it, *Njeriun që ecën* të Giacometti-t, dhe shkrova poezi për të gjithë. Me pak fjalë, ka kaluar një kohë e gjatë nga atëherë.

Isha 43 vjeç, te Muzeut i Artit Modern të Luizianës, dhe kisha hequr dorë nga këto. Aq shumë saqë, vetëm mendimi për Klein-in, Keifer-in ose Giacometti-n, më bezdiste. Ndoshta Giacometti, veçanërisht. Ai ishte diçka e shkuar në jetën time të brendshme. Nuk mund të shihja një skulpturë të Giacometti-t pa një ndjesi të çuditshme ankthi, sikur thjesht më *duhej* të dëgjoja në sfond poezinë e shkëlqyer të poetit norvegjez, Tor Ulven: “Më në fund një njeri shpërfaqet // si aftësia e gurit për të bërtitur”.

Kisha hequr dorë krejtësisht nga të gjithë këto dhe mbi aftësinë e gurit për të bërtitur. Kisha hequr gjithashtu

dorë prej të gjitha teksteve të brendshme në universin e Giacometti-t. Kisha hequr dorë prej të gjithë autorëve të cilët qëndronin dhe mërmërisnin me vete në habi; *Giacometti ...* Kisha hequr dorë nga mendimi se nëse koha është e pamëshirshme dhe e pakapërcyeshme, hapësira nuk është, dhe që ky është sekreti pas gjithë skulpturave, pas artit, që mund të marrë formë, që koha mund të ndalet, që hapësira e merr përsipër dhe e bën kohën të prekshme, oooh, sa bukur, sa prekëse. Jo, kisha hequr dorë prej gjithë kësaj, dhe kishte kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë që nga rinia ime e deri në këtë moment kur po nxitoja përmes korridoreve të Muzeut të Artit Modern të Luizianës duke kërkuar dhomën me aktivitetin letrar.

Por ja çfarë ndodhi më pas: diçka më kapi syri, poshtë në të majtën time. Aty gjendej një skulpturë e vogël brenda diçkaje që ngjasonte me një akuarium, një vitrinë e kapur në mur. Thuajse dëgjoja një lloj fishkëllime ndërkohë që u përkula. Busti qëndronte mbi një bazament të vogël që dukej sikur ishte shkëputur nga një bazë më e madhe, dhe njeriu që qëndronte sipër gjithashtu dukej sikur ishte shkëputur, jo gdhendur, sikur dy gishta e kishin gërmuar, kishin gjetur personin që po fshihej aty, ashtu të pambaruar, e nxorën dhe më pas e lëshuan sapo gishtat e shtrënguan mirë skulpturën. Kështu ai kishte dalë deri te brinjët e kraharorit dhe nuk ishte shkëputur vërtet nga materiali. Nuk kishte fytyrë, më shumë një prani që po fshihej, por mund ta dalloje që ishte aty, brenda kokës së vogël prej bronzit.

U përkula poshtë, ndërkohë që dukej sikur ai po ngrihej sipër, dhe siç e mbaj mend: u takuam në një pikë të çuditshme pa formë, mes lart e poshtë. Tani që ndodhesha aty poshtë, zbulova se kishte edhe më shumë krijime miniaturë. Një koke e vockël e një gruaje me flokë të shkurtër. Koka e ngushtë e një burri të moshuar, e rikrijuar në bronz me detaje të bukura, por shumë të imëta. Një burrë i hollë i drejtë si një gozhdë qëndronte mbi një copë druri, veçse nuk ishte gozhdë, por një person. Ishin të gjithë mbi bazamente drejtkëndore, të bëra nga i njëjti material si vetë ata.

Dhe çfarë ndodhi më pas? Epo, kjo: ndjeva një lëmsh në fyt dhe u mbusha me lot. Ose versionin e tabloidit: LOTËT DERDHE. LOTËT MBLIDHEN PREJ VËSHTRIMIT TË FIGURAVE TË VOGLA QË NGRIHEN NGA I NJËJTI MATERIAL SI VETJA E TYRE, DUKE QËNDRUAR NË NJË VITRINË NË MUR. LOTËT RRJEDHIN NË FESTIVALIN LETRAR. AUTORJA E PREKUR THELLË NGA PAMJA E GJENDJES NJERËZORE! (NJË ANALIZË MË E AFËRT E KËTYRE LOTËVE JO E SHKRUAR ME SHKRONJA TË MËDHA mund të thotë: Ne besojmë se lotët ishin rezultat i A) autorja ndjeu se genia e saj ishte çuditërisht e gjatë (rreth pesë metra) në krahasim me ato skulptura shumë të vogla (asnjë prej të cilave nuk besojmë ishte më shume se 12 cm) dhe t'i shohësh aty brenda shkakton diçka te perspektiva jote dhe ndoshta edhe te kuptimi i jetës, se ekziston njëfarë thelbi që mund të kapet, në skulpturë, dhe që ky thelb është – epo, çfarë është, kur përballesh me faktin se jeta ekziston? Përlësi, ndoshta? Që përmasa e figurave kërkonte përlësi? Apo mund të ishte që lotët u derdhën sepse B) ajo kuptoi diçka specifike se çdo të thoshte të ishte njeri aty dhe atëherë në vitin 2018, kur bota dukej se ishte më absurde nga ç'kishte qenë për një kohë të gjatë, kur pikërisht humaniteti i njerëzve ishte zvogëluar e tkurrur dhe barbarizmi i historisë njerëzore kishte dalë nga vendi i tij i fshehur, dhe pamja e një njeriu të vogël që tërhiqet nga një bazament i vogël i kujtojnë asaj se kush jemi ne, se jemi njerëz.

Por a mund të ishin shkakuar lotët edhe nga C) të kuptuarit, fare i thjeshtë, i asaj çfarë duhet për të portretizuar të njerëzishmen në art, dhe të punosh me një material, t'i japësh formë. Figurat u krijuan nga i njëjti material që ishin vetë. Që themeli ishte kaq i rëndësishëm. Sepse në këtë pikë të historisë, në të njëjtën kohë që barbarizmi njerëzor ishte futur te postet e pushtetit anëmbanë botës, beteja mes së vërtetës dhe trillimit, asaj çfarë është e vërtetë dhe çfarë është false, po jehonte përmes gazetarisë dhe artit. Dhe në këtë pikë, të paktën në historinë e letërsisë norvegjeze, vala e zgjatit e autofiksionit në letërsi, e cila ndiqej nga një valë e verifikimit të fakteve në fikcion, mund të shkaktonte rraskapitje te disa autorë, sidomos te ata që ndiheshin të mbingarkuar kur shihnin figura të vogla që dilnin nga bazamente të mëdha në një vitrinë në mur te Muzeu i Artit Modern të Luizianës, dhe që qëndronin aty duke menduar se nëse askush nuk do ta krahasonte atë, diskutimi mbi lidhjen mes fikcionit dhe faktit me skulpturat e Giacometti-t, dhe në veçanti, e vogla që dukej sikur ishte shkullur nga bazamenti, mund të thuhej se verifikimi i fakteve do të kërkonte një fytyrë të dallueshme, dhe ne nuk do ta donim atë shtresë materiali që fshihte fytyrën.

Verifikimi i fakteve nuk do ta aprovonte as bazamentin, e figura nuk duhet të ishte duke dalë nga asnjë lloj baze e bërë me të njëjtin material, dhe kjo këtu kishte dy bazamente. Por, kjo ishte e tepërt, sikur figura nuk e bëri të qartë mjaftueshëm: ky portretizim i humanitetit që ke përpara teje është i bërë nga një material artistik, dhe nuk është mish

e gjak. Verifikimi i fakteve nuk e do një shtyllë fiksioni, këtë mendoj unë, mendoi autorja që tashmë ishte gati duke u mbështetur te xhami.

Verifikimi i fakteve kërkon që çdo gjë të jetë e vërtetë. Të jem e sinqertë, autores, e cila, sigurisht, isha unë, i kishte ardhur në majë të hundës i gjithë debati ndërkohë që rrinte aty duke parë figurën e vogël, e lodhur deri në palcë – palcë, duhet ta theksojmë, e cila ishte e përbërë nga gjuha, pjesët e shkrimit, struktura e fjalisë, (mes gjërave të tjera, një fjali e parë shumë e gjatë), skeleti i një strukture eseje gjithëpërfshirëse që lidhi momentin marramendës kur “unë” u përkula për të parë më nga afër skulpturën në miniaturë, me distancën e jetës dhe punës, etj., të Giacometti-t.

Sepse është fantastike, apo jo? Që ishte mesa duket kur Giacometti po punonte mbi skulpturën që quhej “Duart që mbajnë boshllëkun”, ndjeu nevojën për të përdorur sërish një model, kështu që u largua nga surrelizmi, sepse a nuk është kjo ajo për të cilën pyesim veten të gjithë, si të punojmë me duart dhe boshllëkun.

M’u kujtua sërish kjo ca kohë më parë kur lexova artikullin mbi imagjinatën të Mary Ruefle: “Është e pamundur për mua të shkruaj për imagjinatën; është sikur t’i kërkosh peshkut të përshkruajë detin”. Dhe m’u kujtua kjo sërish kur lexova diçka që kishte thënë Giacometti, e cila ishte cituar në një artikull te *The Guardian*: “Arti është vetëm një mjet për të parë. Çfarëdo që unë shoh, e gjitha më surprizon dhe më shpëton, e nuk jam fort i sigurt se çfarë shoh”. Dhe unë mendova sërish për këtë kur lexova se Giacometti ishte korrigjuar nga vetë babai i tij, piktori, kur do të pikturonte një natyrë të qetë me dardha. Babai i tij i kishte pikturuar frutat e natyrës së qetë në madhësi normale, por kur Alberto, 18 vjeç, filloi të pikturonte, “dardhat ishin të vogla. Fillova përsëri, por çdo herë, ishin po aq të vogla”. Dhe sado i acaruar të bëhej babai i tij, dhe t’i kërkonte t’i pikturonte sërish, dhe sado që Alberto përpiquej, dardhat ishin gjithmonë shumë, shumë të vogla. Por asnjë nga këto nuk do të zgjasë gjithsesi. Është e diel sot. Distanca nga kjo pikë, kur ulem këtu për të shkruar, te një kohë kur unë nuk ekzistoj më dhe jam fshirë përgjithmonë, është e pambarimtë. Familja ime është jashtë dhe unë jam ulur në zyrën time duke shkruar, ndërkohë që era tund bredhin dhe thuprat në anën tjetër të rrugës, në ishullin e vogël të natyrës që është lënë këtu në mes të tokës së shtëpisë-tarracë, dhe po kaq shpesh tufa të vogla flokësh bore drejtohen horizontalisht poshtë rrugës, ndërkohë që përpiqem të kujtoj atë moment në Muzeun e Artit Modern të Luizianës, kur po kërkoja diçka tjetër, dhe rrugës zbulova Giacometti-n, sërish.

Përktheu E.H.



TREGIMI I DJALIT TË PRAPË

Nga

Mark Twain



Na ishte njëherë një djalë i prapë i cili quhej Xhim – megjithëse, nëse do e vinit re, do të shihnit që thua jse të gjithë djemtë prapanikë quhen Xhejms në librat e të dielës. Ishte e çuditshme, po kaq sa e vërtetë që ky djalë quhej Xhim. Ai nuk e kishte mamanë të sëmurë – një nënë e sëmurë e cila ishte e devotshme dhe e lodhur, dhe do të ishte e lumtur të shtrihej nën tokë dhe të pushonte, por prej dashurisë së madhe lindi të birin, dhe ndjeu një ankth se bota do të ishte e ashpër dhe e ftohtë ndaj tij kur ajo të mos qe më. Shumë prej djemve prapanikë në librat e së dielës quhen Xhejms dhe kanë mamatë e sëmura të cilat iu mësojnë të thonë, “Tani po pushoj”, e të tjera; dhe iu këndojnë me ëmbëlsi, me zë të adhureshëm; dhe më pas iu japin puthjen e natës së mirë, gjunjzohen krah shtratit dhe i përkëdhelin. Por me këtë shokun ishte ndryshe. Ai quhej Xhim dhe gjithçka shkonte mirë me të ëmën – nuk kishte as lodhje e as gjëra të ngjashme. Ajo ishte shumë e fortë dhe aspak e kundërta; mbi të gjitha nuk bëhej nervoze për shkak të Xhimit. Thoshte se nëse ai do të këputte qafën diku, nuk se do t’i bëhej vonë. E vinte në gjumë me të rrahura, dhe nuk i jepte kurrë puthjen e natës së mirë; përkundrazi, i shkulte veshin përpara se të linte dhomën.

Njëherë, ky djalë mistrec vodhi çelësin e depos dhe rrëshqiti poshtë si ngjalë për t’i dhënë vetes pak reçel, më pas mbushi vazot me katran, në mënyrë që e ëma të mos e vërente ndryshimin; për asnjë çast nuk pati shenjë pendese, madje as që i pëshpëriti vetes “A është e drejtë kjo që po bëj? A nuk është mëkat një gjë e tillë? Ku shkojnë djemtë e prapë që hanë vazot me reçel ëmbëltor?” dhe as që gjunjej për të premtuar se kjo do të qe hera e fundit dhe se nuk do ta përsëriste më; dhe të ngrihej i qeshur, me zemër të pastër; e të shkonte t’i rrëfente të ëmës gjithë ç’kish bërë; të përgjerohej për falje; të merrte bekimin e saj me lotët e krenarisë dhe mirënjohjes që shkonin lumë poshtë syve të saj. Jo, kjo ndodh thuhajse me çdo djalosh mistrec në të gjithë librat, ndërsa me Xhimin ndodh çuditërisht e kundërta. Ai ha reçelin e thotë në mënyrën e tij mëkatore, të poshtër, që ishte kaq i parezistueshëm. Më pas e mbush me katran dhe thotë se dhe kjo është e parezistueshme, dhe qesh, dhe vështrojnë “sesi plakaruqja e merr dhe e nuhat” kur zbulon proçkën; në të vërtetë ajo e zbuloi, ai mohon të dijë gjë mbi ç’po ndodh, ajo e rreh, ai nis qan me ngashërim. Ky djalë është plot të panjohura – gjithçka del të jetë ndryshe me të në krahasim me atë që i ndodh të prapit Xhejms në libra.

Njëherë hipi mbi pemën e mollës së Fermës Akorn për të vjedhur, dhe dega nuk u këput, dhe ai nuk ra të thyente krahun, e as nuk u sulmua nga qeni i fermerit, as u shtri në shtrat për javë të tëra ku do të shërohej si më parë. Oh, jo! Ai vodhi aq mollë sa mundi dhe zbriti shëndoshë e mirë; dhe ishte gati nëse qeni do të sulej drejt tij për ta shqyer, pasi në dorë mbante shtrënguar një tullë. Ishte kaq e çuditshme – asgjë e ngjashme nuk ndodh nëpër ata librat e vegjël me kopertinë prej mermeri dhe me foto të burrave palltogjatë, meslidhur e me kapele, dhe pantallonat të shkurtra mbi kyçe; e gratë me palët e fustaneve nën krahë, pa tutelë. Asgjë si këto nuk ndodh në librat e së dielës.

Njëherë vodhi thikën e xhepit të mësuesit, dhe kur nisi të ketë frikë se do e zbulonin apo do ta rrihnin, e vendosi fshehurazi nën kapën e Xhorxh Uillsonit – djalit të të giorës vejushës Uillson, djalit shembullor, më të mirit të fshatit, i cili i përunje gjithmonë të ëmës dhe që nuk thoshte kurrë një të pavërtetë, që mësonte kaq shumë dhe e dashuronte shkollën e së dielës. Kur thika ra prej kapës, i gjori Xhorxh vari kokën dhe u skuq si ta kishte pushtuar faji, dhe mësuesi ngriti menjëherë akuzën e fajësisë ndaj tij duke lëshuar mbi shpatullat e djaloshit të gjithë peshën e drejtësisë, një drejtësi kokëbardhë që nuk u shfaq mes tyre, dhe as që nuk u dëgjua të thoshte, “Kursejeni këtë djalosh fisnik – këtu fshihet një dorë tjetër! Po kaloja kah dera e shkollës gjatë pushimit të drekës, dhe pa e vënë re as vetë, vëreja krimin të kryhej!” Më pas Xhimi nuk u rrah, dhe drejtësia e nderuar nuk lexoi asnjë predikim për lotës dhe mori Xhorxhin për dore duke i thënë se një djalosh kaq i mirë meritonte të lartësohej, më pas i tha të ndanin shtëpinë së bashku, të fshinte zyrën, të ndizte zjarrin, të drejtonte punët, të priste drutë, të studionte drejtësi, të ndihmonte të shoqen me punët e shtëpisë, të kishte gjithë kohën e mundshme për të luajtur, të paguhej katër kacidhe në muaj dhe të ishte i lumtur. Jo; mund të ndodhte kështu në libra, por nuk mund të ndodhte kështu me Xhimin. Asnjë plakush kokëthinjur dhe i drejtë nuk ndërhyu në këtë çështje, kështu që djali i përsosur Xhorxh u dënua me rrahje dhe Xhimi u gëzua kaq shumë sepse, ti e di, Xhimi i urrente djemtë e moralshëm. Xhimi tha se “nuk duronte dot qengjin që pi dy nëna”. E tillë ishte gjuha e prapë e këtij djali mistrec të lënë pas dore.


Por gjëja më e çuditshme që i ka ndodhur ndonjëherë Xhimit, ishte kur shkoi për të lundruar një të diel, dhe nuk u mbyt, e kur një herë tjetër shkoi për të peshkuar dhe e zuri stuhia, nuk u godit nga asnjë rrufe. Pse, mund të shohësh dhe të shohësh në cilindo libër që lexohet të dielave prej tani e deri në Krishtlindjen e ardhshme dhe nuk ke për të hasur në një gjë të tillë. Oh, jo; do të zbulosh se të gjithë djemtë e prapë të cilët shkojnë për lundrim do të mbyten me patjetër; dhe të gjithë djemtë që i kap stuhia ndërkohë që peshkojnë të dielave, fatkeqësisht i godet rrufeja. Varkat me djem të prapë gjithmonë përmbysen të dielave, dhe ka gjithmonë stuhi kur po këta djem të prapë dalin për të peshkuar të shtunave. Sesi Xhimi ynë iu shpëtonte këtyre ndodhive, mbetet ende mister për mua.

Po ky Xhim kaloi një jetë të magjepsur – ndoshta kështu duhet të ndodhte. Asgjë nuk mund ta lëndonte. Madje i dha elefantit të fermës një thes plot duhan dhe elefanti nuk e ngriti feçkën ta godiste njëherë. Erdhi rrotull dollapit mbushur me aromën e mentës, dhe përsëri nuk piu acid nitrik në vend të ujit. Mori fshehur armën e të atit dhe shkoi për gjah një të shtunë, pa mundur të qëllojë tre apo katër nga gishtërinjtë e tij. E gjuajti të motrën me sa kishte fuqi mu në mes të barkut në inat e sipër, dhe ajo nuk u mbështoll mes dhimbshesh gjatë ditëve të gjata të verës, apo të vdiste nën fjalët e ëmbla të pendesës, që ai dhimbshëm prej buzëve të tij, me zemrën e copëtuar në duar. Jo, ajo ia hodhi paq. Ai rendi dhe shkoi prapa diellit, dhe kur u kthye nuk se ishte mërzuar prej vetmisë, as të dashurit nuk i gjeti të preheshin të qetë në varrezat e kishës, as shtëpia e djalërisë nuk ishte shkatërruar prej kohës dhe pluhurit të harresës. Ah, jo! U kthye po aq i dehur sa marinarët dhe ndalesa e parë ishte pranë shtëpisë.

U rrit dhe u martua, krijoi një familje të madhe, dhe një mbrëmje i kaliti të gjithë në sëpatë, u pasurua me të gjitha mënyrat e mashtrimit dhe poshtërsive; dhe tani është ligësia më e madhe në fshatin e tij të lindjes, dhe është botërisht i respektuar, dhe i përket Legjislacionit.

Pra tani e sheh që nuk pati kurrë një djalë të prapë quajtur Xhejms në librat e të dielës, që kishin kesi fati sa mëkatari ynë Xhim me jetën e tij magjepsëse.

Përktheu Antonio Çikollari



EPICTETUS

Arti i të jetuarit

*Manuali klasik mbi virtytin,
lumturinë dhe dobishmërinë*

Minerva